Pejgamberi im

INFORMACIONE THEMELORE MBI ISLAMIN

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË

Pejgamberi im

Editor:
Prof. dr. Mehmet Emin Özafşar - Prof. dr. Recai Doğan

Drejtor publikimi:
Dr. Fatih Kurt

Koordinimi:
Lokman Arslan

Projekti:
Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë - Kryesia e Zyrës së Arsimit Fetar

Autorët e Kapitujve:
Kapitulli 1, 2, 3: Prof. dr. Nahide Bozkurt
Kapitulli 4: Prof. dr. Nahide Bozkurt – Dr. Remziye Yılmaz
Kapitulli 5-6: Dr. Remziye Yılmaz

Përktheu:
Florida Kulla

Redaktor gjuhësor:
Fatjon Cuka

Faqosës
Erzen Pashaj

Përgatiti për botim:
Uğur Altuntop

Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë: 1414
Libra profesionalë: 155

Vendim i Komisionit të Vlerësimit të Veprave: 02.11.2017/68

2019.06.Y.0003.1414
ISBN 978-975-19-6935-4
Certifikimi: 12930
Botimi i dytë, Ankara 2019

Botimi:
Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.
+90 312 397 16 17

© KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Kontakt:
Kontakt me Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve
Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı
Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A
06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE
Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88
E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

pasqyra e lëndës

KAPITULLI 1

PERIUDHA PARAPROFETIKE

1. Rrethi shoqëror ku lindi Pejgamberi 7
2. Pejgamberi ynë dhe familja e tij 12
3. Periudha e rinisë dhe marrëdhëniet sociale 15
4. Martesa me Hz. Hatixhenë dhe fëmijët 18
5. Hz. Pejgamberi para vahjit sipas Kur'anit të Madhërueshëm 19

KAPITULLI 2

PROFETËSIA: PERIUDHA E MEKËS

1. Vitet e para të profetësisë..... 27
2. Solidariteti i bashkësive të para islame dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre .. 32
3. Kundërshtimet që pati Hz. Pejgamberi: reagimet e tij dhe përgjigjet e Kur'anit 32
4. Torturat e ushtruara ndaj muslimanëve, presionet shoqërore dhe emigrimi në Etiopi 36
5. Udhëtimi i Natës (Isra) 41
6. Takimi me medinasit dhe Besëlidhjet e Akabesë 42
7. Hixhreti në Medine 43

KAPITULLI 3

PROFETËSIA: PERIUDHA E MEDINES

1. Veprimtaritë e para të Pejgamberit në Medine 55
2. Marrëdhëniet me idhujtarët 58
3. Marrëdhëniet me hebrenjtë 67
4. Marrëdhëniet me të krishterët 70
5. Çlirimi i Mekës 72
6. Delegatët e thirrjes universale 75
7. Haxhi i Lamtumirës, Hutbeja e Lamtumirës dhe mesazhet universale 76
8. Vdekja e Hz. Pejgamberit 78

KAPITULLI 4

PERSONALITETI I HZ. MUHAMMEDIT DHE TË QENËT E TIJ SHEMBULL

1. Hz. Muhammedi në Kur'an 85
2. Hz. Pejgamberi si shembull për të kuptuar Islamin 89
3. Morali shembullor i Hz. Pejgamberit 95

KAPITULLI 5

SJELLJE SHEMBULLORE NGA HZ. PEJGAMBERI

1. Hz. Pejgamberi si bashkëshort 109
2. Hz. Pejgamberi si baba 110
3. Hz. Pejgamberi si gjysh 112
4. Hz. Pejgamberi si fqinj 113
5. Hz. Pejgamberi si i afërm 114
6. Hz. Pejgamberi si shok 115

KAPITULLI 6

HZ. PEJGAMBERI SI ARSIMTAR DHE EDUKUES

1. Dërgimi i tij si mësues..... 123
2. Rëndësia që i kushtonte shkrimit dhe leximit 124
3. Rëndësia që i kushtonte arsimimit të femrave 126
4. Parimet e arsimimit dhe edukimit 127

ÇELËSI I PËRGJIGJEVE..... 132

LITERATURA 133

Parathënie

Allahu, zotëruesi i mëshirës dhe i dhembshurisë, e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, e ka pajisur atë me aftësi të larta, e ka përcaktuar si krijesën, ndaj së cilës drejtohet thirrja hyjnore, e ka nderuar atë dhe i ka ngarkuar përgjegjësi atij. Në jetën e kësaj bote nuk e ka lënë të vetëm, e ka nxjerrë nga errësira e mosbesimit dhe, për të bërë të mundur që ai të arrijë në një moral të bukur e të ndritshëm, ka dërguar pejgamberë dhe libra, si ndihmë dhe mirësi hyjnore.

Feja, e cila ka ekzistuar bashkë me njeriun e parë, është një nevojë ekzistenciale për njeriun. Ajo është një tërësi këshillash për jetën dhe na mëson kuptimin përfundimtar të saj. Feja bën të mundur krijimin e ekuilibrit ndërmjet botës dhe ahiretit, ndërmjet mendjes dhe shpirtit; fitimin e harmonisë dhe të paqes së brendshme. Ajo sjell dashuri dhe drejtësi, i shndërron detyrat tona individuale dhe shoqërore në një përgjegjësi në cilësinë e adhurimit.

Njeriu, i cili mundohet të kuptojë veten, gjithësinë dhe Krijuesin e tij, që e do Atë dhe është lidhur me Të, duke ecur në rrugën e përfaqësuesve të mëshirës dhe të librave hyjnorë, të cilët i ka dërguar Krijuesi, e ka orientuar atë në kuptimin e robërimit dhe së vërtetës. Në këtë aspekt, është e rëndësishme që njeriu të përballet me informacion të drejtë sa i përket fesë.

Meqë feja ka si synim parësor njeriun, është po ashtu mjaft i rëndësishëm rigjenerimi në mënyrë të përhershme nëpërmjet informacioneve fetare, në mënyrë që jeta të ndriçojë, mesazhet e ndritura të Islamit të freskohen në mendje dhe në zemra, si dhe të krijohet një lidhje dinamike mes dijes e jetës. Në këtë kuadër, Kryesia jonë, e cila ka përcaktuar si objektiv ndriçimin e popullit tonë mbi nevojën për informacion fetar, larg besëtytnive, si dhe përballimin e kësaj nevoje me informacione të sakta fetare sa u përket çështjeve të besimit, adhurimit, sijerit dhe moralit, duke marrë parasysh edhe të dhënat bashkëkohore e shkencore, ka planifikuar të botojë një seri librash të emërtuar "Informacione themelore mbi Islamin". Libri që keni në dorë, me titullin "Pejgamberi im", është vepra e tretë e kësaj serie dhe është përgatitur sipas programit të mësimit *Informacione themelore fetare,* mësim i cili jepet në kurset e varura nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë.

Në vepër janë trajtuar periudha paraprofetike e Pejgamberit tonë, profetësia, personaliteti dhe morali shembullor i tij, rëndësia që i kushtonte dijes, mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Dëshira jonë më e madhe është që ky tekst të jetë i dobishëm për lexuesit.

Vullneti nga ne, suksesi nga Allahu.

Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë

pejgamberi im

KAPITULLI

1

Periudha paraprofetike

1. Rrethi shoqëror ku lindi Pejgamberi
2. Pejgamberi ynë dhe familja e tij
3. Periudha e rinisë dhe marrëdhëniet sociale
4. Martesa me Hz. Hatixhenë dhe fëmijët
5. Hz. Pejgamberi para vahjit sipas Kur'anit të Madhërueshëm

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Ky kapitull jep të dhëna të përgjithshme në lidhje me jetesën sociale, kulturore dhe fetare në Arabinë paraislame dhe mbi jetën e Hz. Muhammedit përpara se të bëhej Pejgamber.

Pejgamberi Hz. Muhammed (s.a.s.) lindi në Mekë, në vitin 571. Fëmijërinë dhe rininë i kaloi në Mekë. Edhe pas profetësisë, për rreth trembëdhjetë vjet qëndroi në Mekë, ndërsa më pas migroi në Medine, ku jetoi për dhjetë vjet.

Në këtë kapitull trajtohet jeta e Pejgamberit tonë të dashur në Mekë, në kontekst të disa ngjarjeve të rëndësishme. Po ashtu, trajtohen ngjarje, të cilat thuajse njihen nga të gjithë, të tilla si: Gjykimi në Mekë dhe pjesëmarrja në Këshillin e Hilfu'l-Fudul (Uniteti i të Virtytshmëve). Në vijim tregohet edhe se si paraqitet Hz. Pejgamberi në Kur'anin e Madhërueshëm

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të përfundoni këtë kapitull:

1. Do të zotëroni dije të mjaftueshme në lidhje me kushtet sociale, situatën kulturore dhe mbi jetesën fetare të mjedisit ku Hz. Muhammedi lindi dhe jetoi para profetësisë.
2. Do të mësoni mbi periudhën e rinisë së Hz. Muhammedit në kontekst të udhëtimeve tregtare, pjesëmarrjes së tij në Hilfu'l-Fudul (Unitetin e të Virtytshmëve), të gjykimit të Qabesë dhe të marrëdhënieve të tij tregtare.
3. Do të informoheni mbi martesën me Hz. Hatixhenë, bashkëshorten që zë një vend të rëndësishëm në jetën e Pejgamberit tonë.
4. Do të njihni fëmijët e Pejgamberit tonë.
5. Do të vini re se si është paraqitur në Kur'anin e Madhërueshëm Pejgamberi ynë, përpara se të merrte vahjin.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Mendoni vazhdimisht nëse keni arritur apo jo synimet e përmendura në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni temat që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Mos u mjaftoni vetëm me këtë libër për të mësuar. Në fund të librit paraqitet një listë e pasur me literaturë. Analizoni burimet që mund të arrini nga kjo listë.
3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe bartini ato në mjediset mësimore.

1 Mjedisi ku lindi Pejgamberi ynë

Le të mendojmë

Çfarë dini në lidhje me mjedisin ku lindi Pejgamberi ynë? Mendoni dhe mbani shënim.

Para Islamit, arabët jetonin të organizuar në formën e fiseve, të cilat formoheshin nga personat që vinin prej të njëjtit fis dhe ku individët ishin të lidhur me njëri-tjetrin me anë të gjakut e farefisnisë. Njësinë më të vogël të fisit e përbënte familja.

Sipas zakoneve të asaj kohe, një mashkull mund të martohej me aq femra sa të dëshironte. Martesa realizohej në forma të ndryshme. Përveç martesës me nikah (celebrim), që dihej dhe pranohej gjerësisht, ekzistonin edhe forma të tjera të nikahut, si nikahu me kohë të parashikuar (nikahu mut'a), nikahu (kurorëzimi) në formën e këmbimit të ndërsjellë të bashkëshorteve (nikahu bedel), nikahu i bazuar në këmbimin e vajzave për të mos dhënë prikë dhe mehir (nikahu shigar).

Në përgjithësi, martesa e vajzave në moshë të vogël ishte pjesë e traditës. Ndërsa femrat pranoheshin në familje vetëm pasi të kishin lindur fëmijë. Për këtë arsye, nëse një femër vdiste pa lindur fëmijë, nuk bëheshin ngushëllime në emër të saj ndaj bashkëshortit. Nëse femra pa fëmijë ndëshkohej me dënimin e pagesës së dijetit (kundërshpërblimit të jetës), këtë dijet nuk e paguante bashkëshorti i saj, por bashkësia familjare në të cilën bënte pjesë familja e saj.

Divorci ishte shumë i përhapur dhe, sa i përket kësaj çështjeje, kompetenca e vetme i përkiste mashkullit. Mirëpo disa femra mund të kërkonin që e drejta e divorcit të mbetej tek ata. Gruaja e divorcuar ishte e detyruar të priste një vit për t'u rimartuar. Ndërkohë, kur lindje djalë ishte diçka që lëvdohej, ndërsa vajzat, siç shprehet edhe në Kur'an, nuk kishin shumë vlerë dhe herë pas here varroseshin të gjalla *(Tekuir, 81/8-9)*.

Nga ana tjetër, në shumë raste vriteshin edhe fëmijët, për shkak të varfërisë. Kjo situatë shprehet me ajetin: "Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë!" *(Isra, 17/31)*

Tek arabët, njëra prej çështjeve të rëndësishme para Islamit në lidhje me familjen ishte edhe çështja e "adoptimit". Fëmija i adoptuar kishte të njëjtat të drejta me fëmijët e adoptuesit.

Arabët para Islamit e vijonin jetesën si beduinë dhe qytetarë. Beduinët jetonin në shkretëtirë, vraponin pas ujit, kullotave dhe ushqimit. Ndërsa qytetarët bënin një jetë sistematike në fshatra dhe në qytete, e përballonin jetesën me bujqësi, tregti dhe me zejtari. Qoftë beduin apo qytetar, themeli i strukturës sociale bazohej në jetesën "kabile" (formim fisnor), që formohej nga jetesa në shkretëtirë.

Fisi dhe formimi fisnor kuptimësohej më shumë me anë të lidhjeve farefisnore të ardhura nga fisi i mashkullit, por nuk ishte plotësisht i mbyllur edhe nga jashtë. Mund të krijohej lidhje farefisnore edhe nëpërmjet hilfit (marrëveshjes, aleancës), xhivarit (garancisë për mbrojtje) dhe velasë (marrjes nën mbrojtje). Nëse dikush braktiste fisin ose dëbohej nga fisi i tij, pasi hynte nën mbrojtjen e një pjesëtari të një fisi tjetër, bëhej anëtar i atij fisi. Një person i tillë quhej halif (që kishte një marrëveshje, aleat). Ndërsa personi që kishte fituar garancinë zyrtare të mbrojtjes quhej xhar. Nëse robit të shtënë në dorë si

rezultat i luftës ose bastisjes, apo skllavit të blerë i falej liria , mes tyre formohej lidhja e quajtur vela; robi i liruar bëhej mevlaja e fisit që i kishte falur lirinë. Në shumë aspekte, personat e konsideruar halif, xhar dhe mevla trajtoheshin si anëtarë esencialë të fisit, bazuar në lidhjen farefisnore dhe të gjakut.

Ngaqë fisi ishte një strukturë që përfshinte edhe farefisnitë e largëta, ai përbënte një unitet që bartte disa veçori në aspekt të identitetit. Ky unitet formohej nga grupe të përmendura me emra të ndryshëm, sipas nivelit të farefisnisë. Për shembull, fisi Hashim, fisi Zuhre, fisi Muttalib. Në mjaft aspekte, jeta fisnore kishte rol përcaktues në lidhje me rrjedhën e jetës sociale. Për shembull, pretendimet e epërsisë që lindnin mes fiseve u bënë shkak për armiqësi të vazhdueshme dhe luftëra. Edhe problemi i përballimit të jetesës, që ishte një problem i rëndësishëm social, përbënte një faktor të rëndësishëm në formimin e këtyre luftërave.

Thelbi i strukturës së fisit ishte "asabijeti (mbështetja ndërfisnore)". Koncepti "asabijet" nënkupton të qenit e personit gjithmonë i gatshëm për të mbrojtur të afërmit nga ana e babait, ose në përgjithësi të fisit, qoftë nëse ky person kishte ose jo të drejtë në një çështje.

Solidariteti fisnor shfaqet si një detyrim për të vijuar jetesën në kushtet e shkretëtirës. Kur një i huaj vriste dikë nga fisi, kalohej në veprim dhe kjo pranohej si një çështje nderi. Megjithëse në disa situata pranohej dijeti (shpagimi i gjakut), në përgjithësi kërkohej gjak në këmbim të gjakut dhe herë pas here gjakmarrja vijonte për vite të tëra. Të gjithë ata që konsideroheshin si pjesëtarë të fisit ishin të detyruar të mbronin nderin dhe interesat e ashiretit ku ishin të lidhur individualisht dhe shoqërisht, të kryenin detyrën që u përkiste dhe të mbronin bashkëfisnorin ndaj atyre që e sulmonin. E shprehur në mënyrë të përmbledhur, pjesëtarët e të njëjtit fis dhe të afërmit, qoftë nëse personi ishte mizor ose i shtypur, e kishin për detyrë të solidarizoheshin.

Fiset zgjidhnin disa persona si kryetarë, duke u bazuar te disa veçori të tyre personale ose te pasuria që zotëronin.

Para Islamit, për shkak të jetesës sociale, arabët ndaheshin në tri kategori: shtresa që gëzonte liri të plotë, robërit/skllevërit dhe mevlatë.

Personat që zotëronin liri të plotë ishin individë me të drejta të barabarta të fisit. Ndër këta, megjithëse të pasurit, falltarët, poetët, personat që kishin marrë emër për guximin e treguar në luftëra, pranoheshin si më të epërt se të tjerët, në aspektin e shtegtimit bashkërisht, në pjesëmarrjen nëpër luftëra, në jetesën e përbashkët dhe me kushte të njëjta, nuk kishin dallim nga njëri-tjetri.

Robërit dhe skllevërit ishin klasa e privuar nga ligji dhe nderi i personave që gëzonin liri të plotë. Këta ishin ose robër të shtënë në dorë si rezultat i luftës, ose persona të blerë. Xharije ishte emri i dhënë ndaj robëreshave. Skllevërit dhe robëreshat përdoreshin në shërbime të fushave të ndryshme.

Para Islamit, skllevërit dhe robëreshat bliheshin si pasuri dhe sende, kalonin nga dikush te një tjetër me anë të trashëgimisë, ose dhuroheshin. Pronari mund të sillej ashtu siç dëshironte me skllavin a robëreshën e tij dhe nuk bëhej përgjegjës për këtë. Shpagimi i krimeve që kryenin skllevërit dhe robëreshat ishte sa gjysma e krimeve të kryera nga personat me liri të plotë. Edhe fëmijët që lindnin nga robëreshat konsideroheshin si skllevër. Por, nëse baballarët e tyre dëshironin, mund t'i pranonin si pasardhës të tyre.

Mevalinjtë (shumësi i konceptit mevla, që u shpjegua më parë) ishte një klasë e mesme ndërmjet skllevërve dhe të lirëve. Ata ishin skllevër, të cilëve u ishte dhuruar liria. Nëse ndonjërit prej skllevërve i zoti i falte lirinë, ai bëhej mevlaja i atij që e lironte, konsiderohej si pjesëtar i fisit të tij dhe fitonte cilësinë e të afërmit. Mevalinjtë nuk mund të bliheshin dhe të shiteshin si skllevërit. Por, edhe ata privoheshin nga disa të drejta: për shembull, një mevla nuk mund të martohej me një vajzë ose grua të lirë.

Është radha juaj

Cilat janë dallimet dhe ngjasimet ndërmjet rrethit shoqëror ku lindi Pejgamberi ynë dhe rrethit shoqëror ku jetojmë ne? Diskutoni!

Jeta kulturore

Para Islamit, në Gadishullin Arabik jeta kulturore nuk shquhej për ndonjë cilësi të pasur. Lëvizjet dhe zhvillimet kulturore në periudhën para Islamit përbëheshin nga dijet e zhvilluara prej eksperiencës, traditave dhe zakoneve, që lindnin si rrjedhojë e domosdoshmërive të jetës nomade. Arabët e zonës së Hixhazit e kishin mësuar shkrimin pak kohë përpara shfaqjes së fesë Islame, nga nebatitët, fqinjët të cilët i njohën kur shkonin në veri për qëllime tregtie. Ky shkrim, që sot njihet si shkrimi arab, u shfaq si rezultat i evoluimit të shkrimit nebatit, duke kaluar nga etapa të ndryshme.

Shfaqja në periudha të vona e shkrimit tek arabët para Islamit dhe mospërdorimi i tij në formë të përhapur, nuk është bërë shkak për privimin e tyre nga disa zhvillime kulturore. Në veçanti, mund të thuhet se poezia dhe letërsia ishin mjaft të zhvilluara. Poezitë, në të cilat trajtoheshin mjaft aspekte të jetës, më shumë transmetoheshin gojarisht. Të recitoje poezi ishte një veprimtari shumë e rëndësishme. Madje, si rezultat i konkurseve poetike të organizuara në panairet fetare ose tregtare, janë dalluar poetë të njohur, si të zotët e Mual'lakat-i Seb'a (shtatë poezive të varura).

Nga këto poezi mund të konstatohet se ç'lloj të dhënash, zakonesh dhe traditash kishin arabët në fusha të ndryshme në periudhat paraislame. Tematikat e poezive në përgjithësi përbëheshin nga elemente si lëvdimi, keqësimi, heroizmi dhe dashuria. Pozita e poetëve në shoqëri ishte e lartë.

Arabët janë angazhuar së afërmi edhe me historinë. Vartësia ndaj historisë është një ndër veçoritë karakterizuese të tyre. Në këtë aspekt, ndër të dhënat historike që i ruanin të gjalla në mendje dhe në kujtesë, përgjithësisht i kushtonin rëndësi gjenealogjisë së njerëzve. Para Islamit, historia arabe u zhvillua në dy aspekte. Njëri prej këtyre është aspekti që lidhet me "gjenealogjinë, aspekt i cili u sipërpërmend. Ndërsa tjetri është "ejjamu'l-arab" (ditët arabe), pra aspekti që lidhet me ato të dhëna, të cilat kanë si tematikë luftërat e bëra për shkaqe të ndryshëm ndërmjet fiseve arabe. Kjo vetëdije historike është mbrojtur duke u përcjellë gojarisht nga njëri brez në tjetrin. Në veçanti, në zonat e Hixhazit dhe të Jemenit ekzistonte një akumulim i pasur i historisë. Njerëzit, të cilët u përkisnin feve dhe kulturave të ndryshme, vinin në Arabi për qëllime tregtare, udhëtimi etj. Në këtë mënyrë, arabët mësonin të dhëna në lidhje edhe me historinë e popujve të tjerë.

A e dini?

Arabët, shkencën e astrologjisë (shkenca yjore), e cila ishte mjaft e dobishme në shkretëtirat e pafund, me shumë mundësi e kanë marrë nga keldanitët dhe babilitët. Dihet se arabët i kanë kushtuar rëndësi lëvizjes së yjeve dhe rrotullimit të tyre. Ata njihnin shumicën e yjeve në qiell. Astrologjia për ta ishte më shumë një njësi për përcaktimin e kohës. Kështu, ata i organizonin udhëtimet sipas pozicioneve dhe lëvizjeve të yjeve. Duke përllogaritur lëvizjet e Diellit dhe të Hënës përcaktonin stinët dhe ditët.

Tek arabët para Islamit, parashikimi i fatit dhe magjia kishin një rol të rëndësishëm. Arabët ushqenin respekt të madh sidomos ndaj falltarëve. Ata i shihnin si doktorët e sëmundjeve shpirtërore. Ata rendnin pas falltarëve në çastet e tyre të vështira dhe kërkonin ndihmë prej tyre. Në të njëjtën mënyrë besonin edhe te forca e magjistarëve, aq sa kishin konceptin sikur një magjistar zotëronte aftësi sa të ndante një person nga bashkëshortja e tij, të tregonte ndryshe diçka në sytë e njeriut dhe të kallte frikë ose drithërimë në zemrat e njerëzve.

Le të mendojmë

Cilat janë arsyet që ende në ditët e sotme, në disa shoqëri ekziston falli, parashikimi i fatit dhe magjia? Ç'mund të bëhet në drejtim të shmangies nga këto lloj sjelljesh negative?

Jeta fetare

Para se të vinte Islami, tek arabët në përgjithësi ekzistonte tendenca dhe prirja e idhujtarisë. Në të vërtetë, populli i Gadishullit Arab ka besuar te Hz. Ibrahimi dhe te feja që ai solli, te çështja e pranimit si vend të shenjtë të Qabesë, që u ndërtua në Mekë nga Hz. Ibrahimi dhe djali i tij, Hz. Ismaili, si dhe te miratimi i njëjësisë së Allahut. Mirëpo, me kalimin e kohës arabët u larguan nga besimi i teuhidit, filluan të adhuronin idhujt dhe kjo situatë vijoi deri në ardhjen e Islamit. Pasi harruan fenë e Hz. Ibrahimit dhe djalit të tij, Hz. Ismailit, megjithëse filluan të adhurojnë idhujt, ata besonin edhe në një Zot, që ishte krijuesi dhe mbrojtësi i universit. Sipas tyre, Zoti ishte jashtë universit dhe të gjitha krijesat i binden Atij, çdo gjë është nën urdhrin e Tij. Në Kur'anin Famëlartë vërtetohet fakti se në periudhat paraislame arabët besonin në Allah.

"Thuaj: 'Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?' Ata do të thonë: 'Allahu'..."' *(Junus, 10/31)*

"Thuaj: 'E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini? Ata do të thonë: 'Të Allahut!' E ti thuaju: 'Vallë, a nuk po ia vini veshin?' Thuaj: 'Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?' Ata do të thonë: 'Allahu!' E ti thuaju: 'Vallë, a nuk keni frikë ju?"'*(Mu'minun, 23/84-87)*

Sipas tyre, idhujt ishin në pozitën e ndërmjetësit që të çonte tek Allahu. Kur e shohim çështjen nga ky aspekt, besimi i arabëve përpara Islamit përkufizohet si "Idhujtari". Idhujtaria nënkupton besimin, në të cilin bashkë me Allahun pranohen si zot qenie të tjera, kërkohet ndihmë nga ata, drejtohet dua dhe ofrohen kurbane ndaj tyre, pranohen si ortakë në orientimin drejt Allahut dhe shprehjes së adhurimit ndaj Tij.

Në Kur'an kjo situatë përkufizohet kështu: "Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim." *(Jusuf, 12/106)*

Flitet për ekzistencën e 360 idhujve në Qabe, e cila përbënte qendrën e jetesës fetare në Mekë. Më i madhi dhe më i rëndësishmi prej këtyre ishte idhulli i quajtur Hubel. Ndërsa ndër idhujt më të njohur ishin: "Lati", idhulli i fisit Thakif, që banonte në Taif, "Menati", idhulli i fiseve Eus dhe Hazrexh në Medine dhe "Uzza", idhulli i fiseve Kurejsh dhe Kinane. Në Kur'an citohen edhe emrat e këtyre idhujve: "A e keni parë Latën dhe Uzzën? Po Menatën, të tretën, të fundit?" *(Nexhm, 53/19-20)*

Qabeja u ndërtua në luginën e Mekës nga Hz. Ibrahimi, bashkë me bashkëshorten e tij, Haxherin dhe djalin, Ismailin.

"Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt. Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim)..." *(Al-u Imran, 3/96-97)*

Hz. Ibrahimi iu përgjërua kështu Zotit, kur realizoi ndërtimin e Qabesë: "O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë." *(Ibrahim, 14/37)*

Allahu i Lartmadhëruar e pranoi duanë e tij dhe, për të realizuar kërkesën e tij, i drejtohet Hz. Ibrahimit duke i thënë: "Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë më këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta." *(Haxh, 22/27)*

Kështu filloi edhe adhurimi i haxhit, i cili nënkupton vizitën e Qabesë. Pas kësaj, Qabeja, si Bejtullah (shtëpi e Allahut), filloi të bëhet tavaf prej vizitorëve që vinin nga vende

të ndryshme të gadishullit. Kjo vizitë e haxhit kryhej në muajt Dhilkade, Dhilhixh-xhe, Muharrem dhe Rexheb, në të cilat ishte e ndaluar të luftohej.

Nga çdo zonë e Gadishullit Arabik u institucionalizuan disa detyra, të tilla si: lehtësimi i vizitave të haxhinjve, organizimi, ofrimi i ushqimit dhe strehimit.

Le të mësojmë

Disa nga detyrat më të rëndësishme në lidhje me Qabenë janë:

Hixhabe-Sidane: Është detyra e mbrojtjes së Qabesë. Çelësat e Qabesë i mban personi që kryen këtë detyrë. Ky nëpunës hap Qabenë, e mbyll dhe e përgatit atë për vizitorët. Kjo detyrë konsiderohet si më e shenjta e detyrave fetare.

Sikaje: Është detyra e sigurimit të ujit të pijshëm për ata që vizitojnë Qabenë.

Rifade: Është detyra e sigurimit të ushqimeve ndaj vizitorëve të Qabesë dhe në veçanti të haxhinjve të varfër.

Dihet se arabët përpara Islamit, siç e shpreh edhe Kur'ani, nuk besonin në kritere si ringjallja pas vdekjes, gjykimi, dhënia e shpërblimit dhe e dënimit në ahiret.

"Ata thoshin: 'S'ka tjetër, përveç jetës në këtë botë dhe ne kurrsesi nuk do të ringjallemi"'. *(En'am, 6/29)*

"Ata thoshin: 'Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron'..."' *(Xhathije, 45/24)*

"Ata pyesnin: 'Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi eshtra e dhe, vërtet do të ringjallemi?! Kjo na është premtuar neve dhe të parëve tanë, por këto janë vetëm përralla të popujve të lashtë."' *(Mu'minun, 23/82-83)*

Është radha juaj

Ç'marrëdhënie mendoni se ka ndërmjet mjedisit fetar ku lindi Hz. Pejgamberi dhe dërgimit të tij si Pejgamber?

2 Pejgamberi ynë dhe familja e tij

Lindja

Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.), i përket krahut Hashim të fisit Kurejsh në Mekë. Babai i tij ishte Abdullahu, ndërsa gjyshi i tij Abdulmuttalibi. Emri i vërtetë i babait të Abdulmuttalibit, pra gjyshit të madh të Hz. Muhammedit, është Amr. Në kohën e tij, Hashimit i ishte ngarkuar në Mekë detyra e ofrimit të ujit (sikaje) dhe ushqimit (rifade) ndaj haxhinjve që vizitonin Qabenë. Në të njëjtën kohë, edhe pse jo shpesh, ai shkonte në udhëtime tregtare. Në njërin prej udhëtimeve tregtare që Hashimi bëri drejt Sirisë, u martua me Selma binti Amrin nga fisi Nexh-xhar në Jethrib (Medine) dhe nga kjo martesë lindi Abdulmuttalibi, gjyshi i Hz. Pejgamberit tonë (s.a.s.). Po ashtu, në njërin prej udhëtimeve tregtare që bëri në Siri, ndërroi jetë në Gazë. Pas vdekjes së Hashimit, vëllai Muttalibi e solli nipin që po qëndronte në Medine pranë së ëmës, Shejben, në Mekë. Mekasit, të cilët e pandehën Shejben si skllavin e Muttalibit, i dhanë atij emrin Abdulmuttalib, pra "robi i Muttalibit". Pas kësaj, Shejbe filloi të përmendej me emrin Abdulmuttalib. Abdulmuttalibi ishte kryetari i fisit Hashim.

Abdulmuttalibi ishte personi që rigjeti vendin e pusit Zemzem në afërsi të Qabesë dhe e gërmoi atë. Ndërsa po e gërmonte pusin Zemzem me djalin e tij të vetëm, Harithin, krerët e fisit Kurejsh filluan ta shqetësonin. Nga historianët transmetohet të ketë thënë se: "Nëse do të ketë dhjetë djem dhe do të vinin në pozitën e mbrojtjes së tij ndaj armiqve, premton se njërin prej këtyre do ta flijojë për Zotin në Qabe." Bëhet e ditur se Allahu e plotësoi këtë dëshirë të tij, se i dha atij 10 fëmijë, se pas kësaj Abdulmuttalibi, për të mbajtur fjalën e dhënë, ka hedhur short sipas kushteve të asaj dite, për të përcaktuar se cilin djalë do të bënte kurban dhe se ky short bie mbi Abdullahun, babanë e Pejgamberit. Mirëpo, sërish sipas traditës ekzistuese, shpëtimi i Abdullahut ishte i mundur me bërjen kurban të deveve. Çdo short që u hodh mes Abdullahut dhe deveve, binte mbi Abdullahun. Aq sa kur numri i deveve që do të bëheshin kurban arriti në 100, shorti përfundoi duke rënë mbi devetë. Kështu, thuhet se në vend të Abdullahut, u bënë kurban 100 deve.

Abdulmuttalibi ishte një person që kryente detyrën e sikajes (dhënies së ujit) dhe të rifades (dhënies së ushqimit). Gjatë ngjarjes së elefantit, që trajtohet në suren Fil në Kur'an, personi që kreu bisedime me Ebrehenë, sovranin e Jemenit, i cili erdhi me qëllim që të shembte Qabenë, ishte sërish Abdulmuttalibi.

Edhe djali i Abdulmuttalibit dhe babai i Hz. Pejgamberit, Abdullahu, ashtu si pjesëtarët e tjerë të familjes, ishte një person që kishte marrëdhënie tregtare me Sirinë. Abdullahu u martua me vajzën e Vehbit, pjesëtar të fisit Zuhre, Aminenë. Disa muaj pas martesës bëri njërin prej udhëtimeve tregtare në Gazë, ndërsa kthehej në Medine. Kur ishte ende

në moshë të re dhe pranë dajallarëve të tij, u sëmur dhe ndërroi jetë. Muhammedi (s.a.s.) lindi në Mekë, më 20 prill 571, pak kohë pas vdekjes së të atit. Viti që lindi ai është viti kur Ebrehe erdhi në Mekë për të shembur Qabenë dhe kur u përpoq të luftonte ndaj Mekës.

Është radha juaj

Ç'informacione ka aktualisht populli ynë në lidhje me lindjen e Pejgamberit? Ç'mendoni mbi këtë çështje?

Vitet e fëmijërisë

Meqenëse Pejgamberi ynë lindi pas vdekjes së babait, ai filloi të rritej nën mbrojtjen e gjyshit, Abdulmuttalibit. Krerët e Mekës i jepnin fëmijët e tyre te një nënë qumështi nga fiset beduine, me qëllim që të rriteshin në klimën e shëndetshme të pllajës, gjë që ishte shndërruar në traditë. Kjo traditë u realizua edhe për Hz. Muhammedin, i cili ishte në moshë të vogël kur iu dha një gruaje me emrin Halime, pjesëtare e krahut Sa'd b. Bekir nga fisi Hevazin, fis ky që jetonte në afërsi të Taifit.

Shtëpia ku lindi Pejgamberi ynë

Gjatë kohës kur Hz. Pejgamberi (s.a.s.) vinte në Mekë bashkë me nënën e qumështit për të vizituar gjyshin dhe të ëmën e tij, ndiente vazhdimisht shqetësime për shkak të ndryshimit të klimës. Po ashtu, duke qenë se Amineja, e ëma, vinte re që klima e pllajës po i përshtatej fëmijës, qëndrimi i tij atje u bë paksa i gjatë. Deri në moshën 4-5-vjeçare Muhammedi (s.a.s.) qëndroi pranë nënës së qumështit dhe kaloi një fëmijëri të lumtur me vëllezërit e motrat e tij prej nënës së qumështit. Më pas u dërgua pranë nënës së tij biologjike në Mekë. Kur ishte në moshën 6-vjeçare, nëna e tij, Amineja, bashkë me robëreshën e saj, Ummu Ejmenin, vajtën në Medine. Qëllimi i këtij udhëtimi për Aminenë ishte të vizitonte varrin e Abdullahut, bashkëshortit të saj, që ndërroi jetë pak kohë para lindjes së Hz. Muhammedit dhe të takohej me të afërmit e saj. Për rreth një muaj qëndruan në Medine. Gjatë kthimit, në vendin e quajtur Ebua, që gjendej në një distancë prej 190 kilometra nga Medina, Amineja u sëmur dhe ndërroi jetë. Hz. Muhammedi (s.a.s.), i cili ishte ende 6 vjeç, u pikëllua shumë për vdekjen e pap-

ritur të nënës së tij. Pjesën e mbetur të udhëtimit drejt Mekës e bëri me robëreshën Ummu Ejmenin.

Ummu Ejmeni ia dorëzoi jetimin Muhammed gjyshit të tij, Abdulmuttalibit. Përkujdesjen për Hz. Pejgamberin, i cili në moshën 8-vjeçare humbi edhe gjyshin e tij, e mori përsipër Ebu Talibi. Ebu Talibi e donte shumë nipin dhe angazhohej në mënyrë të veçantë me të. Ebu Talibi merrej me tregti dhe nipi i tij e ndihmonte në punët e tregtisë, madje qëndroi bashkë me të në disa udhëtime që bëri për qëllime tregtie.

Të studiojmë - Të mësojmë

Studioni dhe mësoni mbi disa veprime shembullore të Pejgamberit në vitet e fëmijërisë. Shkruani ndjenjat dhe mendimet që krijojnë te ju veprimet shembullore që keni gjetur!

3 Periudha e rinisë dhe marrëdhëniet shoqërore

Respekti shoqëror ndaj Hz. Pejgamberit

Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.), gëzonte një personalitet të respektueshëm në shoqëri. Në moshën njëzetvjeçare, bashkë me xhaxhallarët e tij, mori pjesë në mbledhjen Hilful-Fudul, si përfaqësues i fisit Hashim, gjë që aludon se ai kishte një rol të rëndësishëm në rrethin brenda të cilit gjendej. Është veçanërisht domethënës pranimi i pjesëmarrjes në këtë marrëveshje pas ftesës së xhaxhait të tij, Zubejrit dhe shprehja nga ana e tij se nuk do të vepronte në kundërshti me këtë marrëveshje, edhe nëse do t'i jepeshin deve të kuqe. Spikat shumë fakti që, edhe pasi u bë Pejgamber, ka bërë të ditur që, nëse do të ftohej sërish në një marrëveshje të ngjashme, edhe tek ajo do të merrte pjesë. Ai, para së gjithash ishte një person që bartte cilësimin "Emin" (pra i besueshëm). Nofka e tij "Emin" kishte kuptimin e një personi të besueshëm dhe i cili ngjallte siguri e besim.

Kur zbriti ajeti: "Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm!" *(Shuara, 26/214)*, u ngjit në kodrën Safa dhe pyeti: "Nëse unë ju them se pas kësaj kodre gjendet një ushtri armike, e cila dëshiron të pushtojë qytetin tuaj dhe se kjo ushtri ka ngritur garnizonin atje, a do të më besoni?", mori këtë përgjigje: "Ti kurrë nuk ke gënjyer, do t'i besojmë çdo gjëje që do të thuash ti." *(Ibn Sa'd, et-Tabakat, II, 200)*.

Pika ku bashkohen besimtarët dhe jobesimtarët, është fakti që ai ishte një person i drejtë dhe i besueshëm. Ai ishte njëri prej personaliteteve më të besueshme të shoqërisë ku jetonte. Meqenëse kjo veçori e tij dihej dhe njihej nga të gjithë, personat që niseshin për një udhëtim të largët, ia linin atij amanet sendet me vlerë. Edhe personat që dëshironin të kishin fitime të mira në tregti i drejtoheshin atij. Duke qenë se ishte shumë i drejtë, ai nuk i prekte të ardhurat e karvanit dhe ia bënte të ditur në formën më të bukur të zotit të karvanit fitimin e korrur.

Ai, me moralin e lartë që kishte, tërhoqi vëmendjen e shoqërisë ku jetonte dhe u tregua si shembull ndaj të gjithëve mes tyre. Morali i tij i lartë dhe i bukur parandaloi një luftë të përgjakshme, e cila për pak do të shpërthente për shkak të vendosjes së Haxheru'l-Esuedit (Guri i zi) në vendin e tij. Të gjithë ishin gëzuar, pasi ishte "Muhammedu'l-Emini" ai që hyri për herë të parë në Haremu'sh-Sherif. Për shkak të personalitetit të tij të pastër dhe të besueshëm, kishin shpallur se do ta pranonin vendimin e tij, përpara se ai ta merrte atë. Së fundmi, ai arriti të kishte sukses me gjykimin që bëri dhe kështu iu shtua më shumë respekti.

Është radha juaj

Cilat veçori personale dhe morale të Pejgamberit kanë ndikuar në shtimin e respektit ndaj tij në vitet e rinisë?

Udhëtimet e tij

Udhëtimi i parë që bëri Pejgamberi ynë ishte vajtja nga Meka në Medine, në moshën 6-vjeçare, bashkë me të ëmën. Në Medine patën vajtur që të vizitonin të afërmit dhe varrin e të atit. Mirëpo në kthim e humbi nënën në vendin e quajtur Ebua dhe u kthye në Medine me robëreshën Ummu Ejmen. Më pas, kur Hz. Pejgamberi bëri hixhret nga Meka në Medine, kujtoi shtëpinë ku pati ardhur bashkë me të ëmën e ku qëndroi si mysafir dhe u tha shokëve të tij: "Ja, nëna ime më solli në këtë shtëpi. Këtu gjendet varri i babait tim, Abdullahut. Unë mësova të notoj mjaft mirë në hauzin e dajës tim, Adij b. Nexh-xharit."

Një udhëtim tjetër i tij është ai për në Damask, në të cilin mori pjesë bashkë me xhaxhanë, Ebu Talibin. Në këtë udhëtim, të cilin e ndërmori në moshën nëntë ose dymbëdhjetëvjeçare, vajti në Busra, në qytetin që gjendej në Siri, bashkë me xhaxhanë e tij.

Po ashtu, dihet se në vitet e rinisë ka vajtur në Bahrejn, Etiopi, Jemen dhe për të dytën herë në Busra të Sirisë, për qëllime tregtie. Në këtë periudhë mund të ketë realizuar edhe një udhëtim në rrugë detare për në Etiopi.

Hz. Pejgamberi ka kryer udhëtime tregtare në emër të Hz. Hatixhesë. Këto udhëtime janë bërë në anët e Jemenit dhe të Sirisë. Ka vajtur deri në Xhurash, vend që gjendej në anën e Jemenit dhe ka marrë pjesë në panairin Hubashe, i cili gjendej mbi rrugën Hixhaz-Jemen.

Pjesëmarrja e tij në Hilfu'l-Fudul (Unitetin e të Virtytshmëve)

Hz. Pejgamberi mori pjesë në formimin "Hilful-Fudul", që mund të quhet edhe si "Uniteti i të Virtytshmëve", i themeluar nën kryesinë e xhaxhait të tij, Zubejrit, por që më pas e humbi funksionin. Qëllimi i Hilful-Fudulit ishte të kishin si parësore parimet e drejtësisë kundrejt veprimeve mizore të fiseve më të pasura dhe të fuqishme, si dhe t'i mbështesnin ata.

Në një ceremoni të organizuar në shtëpinë e Abdullah b. Xhud'anit, një grup mjaft i madh në numër, i përbërë nga mekas të rinj dhe të moshuar, u betuan si në vijim:

"Betohemi në Allah se të gjithë do të jemi një dhe bashkë përballë mizorit që ushtron padrejtësi. Deri kur mizori t'i kthejë atij të drejtën që i ka marrë, do të jemi si një dorë e vetme. Ky unitet dhe bashkim do të vazhdojë deri kur deti të bluajë një copë leshi dhe ta zhdukë atë, për sa kohë që malet Hira dhe Sebir të jenë të ngulur mbi tokë dhe deri kur gjendja ekonomike e atij që ka pësuar mizori të arrijë në barazi." *(Muhammed Hamidullah, Pejgamberi islam, I, 57)*.
Pejgamberi ynë, i cili në moshën 20-vjeçare vendosi të shprehë përpjekjet e tij ndaj padrejtësisë dhe mizorisë dhe që mori pjesë në këtë bashkësi, në jetën e mëpastajme do të fliste gjithmonë me lëvdim për këtë ngjarje.

Është radha juaj

Cilat janë kriteret që mundësuan pjesëmarrjen e Pejgamberit në Unitetin e të Virtytshmëve?

Periudha e rinisë dhe marrëdhëniet shoqërore"

Një ngjarje tjetër e rëndësishme në jetën e Hz. Pejgamberit para profetësisë është gjykimi i tij, kur ishte në moshën 35-vjeçare, mbi kontradiktën që lindi gjatë vendosjes në vend të Gurit të Zi (Haxheru'l-Esued), ku tregoi aftësitë e tij për të bërë kompromis.


Haxheru'l-Esued

Qabeja ishte dëmtuar si rezultat i përmbytjeve që përfshinë Mekën dhe ishte gati të shembej. Fiset e Kurejshit u mblodhën dhe vendosën ta riparojnë atë. U ndanë të gjitha pjesët që do të merrte përsipër secili fis dhe filloi riparimi i ndërtesës. Mirëpo gjatë riparimit të Qabesë, kur erdhi radha te vendosja e Gurit të Zi (Haxheru'l-Esued), që konsiderohet se u vendos nga Hz. Ibrahimi për të përcaktuar pikën e fillimit të tavafit, lindën probleme. Çdo fis dëshironte ta merrte vetë nderin e vendosjes së këtij guri në vendin e tij. Problemi u rrit dhe u shndërrua në kontradiktë, aq sa ndërtimi i Qabesë u ndërpre për 4-5 ditë. Ndërkohë, u pranua propozimi që solli më i moshuari i kurejshitëve, Ebu Umejje b. Mugire. Sipas këtij sugjerimi, u vendos që të përcaktohet si gjykues personi i parë që do të hynte nga porta e Haremu'sh-Sherifit. Personi që hyri nga porta ishte Hz. Muhammedi. Të qenit e tij një person i besueshëm, mundësoi që ai të pranohet si gjykues. Pasi iu përcoll situata, Hz. Muhammedi hoqi pelerinën, e shtroi për tokë dhe vendosi Gurin e Zi mbi të. Një përfaqësues për çdo fis e kapi pelerinën nga cepat, e ngritën

gurin dhe e vendosën në vend të gjithë së bashku. Kurejshitët mbetën më se të kënaqur nga rezultati. Kështu, një problem i rëndësishëm u zgjidh nga ana e tij në një mënyrë që i kënaqi të gjithë.

Është radha juaj

Cilën veçori të Pejgamberit tonë ka treguar gjykimi i Qabesë?

Angazhimi i tij me tregti

Pejgamberi ynë, i cili kishte fituar përvojë në fushën e tregtisë krahas xhaxhait të tij, Ebu Talibit, e vijoi angazhimin me tregti edhe në vitet e rinisë. Në këtë kontekst, ai ka dërguar në Siri karvanin e Hz. Hatixhesë në këmbim të pagesës.

Hz. Hatixheja ishte vajza e Hu'uejlid b. Esedit, nga krahu Esed i fisit Kurejsh. Hz. Hatixheja, e cila humbi dy bashkëshortët e parë, bënte tregti në emër të saj dhe dërgonte karvanë në Siri e në Jemen. Pas sugjerimit të xhaxhait të tij, Ebu Talibit, kur ishte rreth 25 vjeç, Hz. Muhammedi kërkoi punë nga Hz. Hatixheja. Hz. Hatixheja, ngaqë kishte dëgjuar për cilësitë e tij, siç ishin drejtësia, besueshmëria dhe morali i lartë, e punësoi me kënaqësi dhe kërkoi nga ai që ta përfaqësonte në një karvan, i cili do të shkonte për në Siri. Hz. Hatixheja i dha me vete edhe robëreshën Mejsere. Muhammedi (s.a.s.) vajti në Siri, shiti mallrat që çoi nga Meka, bleu mallrat e kërkuar dhe u kthye pas në Mekë bashkë me Mejserenë. Kthimi i karvanit me fitime të mëdha dhe lëvdatat e shprehura nga Mejsereja për Muhammedin ndikuan shumë mbi Hz. Hatixhenë.

A e dini?

Meqenëse ndërmjet arabëve ekzistonte tradita e dhënies së nofkës, e cila i dedikohej fëmijës së parë të lindur, Muhammedi (s.a.s.), ka marrë nofkën Ebu'l-Kasim (babai i Kasimit).

4 Martesa me Hz. Hatixhenë dhe fëmijët e tij

Hz. Hatixheja i propozoi për martesë Pejgamberit tonë (s.a.s.). Pejgamberi ynë e pranoi propozimin dhe u martuan. Nga kjo martesë ata patën dy djem dhe katër vajza. Emrat e djemve ishin Kasim dhe Abdullah, ndërsa emrat e vajzave ishin Zejnep, Rukijje, Ummu Kulthum dhe Fatima. Djemtë ndërruan jetë kur ishin ende foshnje, ndërsa vajzat, përveç Fatimesë, ndërruan jetë para vdekjes së tij. Edhe pas martesës, për një kohë ai ndoqi punët e tregtisë së Hz. Hatixhesë.

Është radha juaj

Cilët janë faktorët që ndikuan në martesën e Hz. Hatixhesë me Pejgamberin tonë?

5 Hz. Pejgamberi para vahjit sipas Kur'anit

Në ajetet e mëposhtme bëhet e ditur se në ç'gjendje ishte Hz. Pejgamberi para vahjit:

Ajetet: "A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi? A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?" *(Duha, 93/6-8)* janë shprehje që nxjerrin në pah formimin e Hz. Muhammedit dhe jetën e tij deri në ardhjen e vahjit. Në këtë kontekst, ajo që duhet të theksohet në veçanti është se ai nuk e dinte që do të bëhej Pejgamber para vahjit.

Ajetet: "Thuaj: 'Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t'jua kisha lexuar dhe as që do të bënte Ai që ju ta mësoni atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?"*(Junus, 10/16)* dhe "Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi!" *(Shu'ra, 42/52)* shprehin pikërisht këtë situatë.

"Ne të tregojmë ty (Muhammed) historinë më të bukur përmes shpalljes së këtij Kur'ani, ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë." *(Jusuf, 12/3)*

"... Allahu të shpalli ty Librin (Kur'anin) dhe Urtësinë e plotë, si dhe të mësoi atë që nuk e ke ditur. Dhuntia e Allahut për ty është shumë e madhe." *(Nisa, 4/113)*

Ndërsa një kriter tjetër që shpalos Kur'ani është fakti se ai nuk ishte njohës i shkrimit dhe i leximit. "Para këtij, ti (Muhammed) nuk kishe lexuar asnjë libër e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin." *(Ankebut, 29/48)*

Në Kur'an ka mjaft ajete që tregojnë për moralin dhe virtytet e Hz. Pejgamberit. Këto ajete nuk bëjnë dallim ndërmjet periudhës para se ai të ngarkohej me profetësi dhe pas periudhës së profetësisë. Ndërkaq, ka një ajet në Kur'an, ndër ajetet e para të zbritura, që tregon se qëndrimi dhe mënyra e tij e qasjes priten me përgëzim.

"Pa dyshim, ti je me virtyte madhore." *(Kalem, 68/4)* "Kur atyre u vjen ndonjë mrekulli, thonë: 'Ne nuk do të besojmë deri sa të mos na jepet diçka, si ajo që u është dhënë të dërguarve të Allahut.' Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet...'" *(En'am, 6/124)* Këto dy ajete e shpalosin në një mënyrë të qartë moralin, aftësitë, në veçanti jetën e tij para profetësisë, me një domethënie të fuqishme.

"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje..." *(Al-i Imran, 3/159)* Ky ajet tregon se morali i tij i bukur, sjelljet e buta dhe marrëdhëniet e mira janë larg nga qëndrimi dhe morali i keq, nga të qenit shpirtlig.

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, dëshiron që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." *(Teube, 9/128)* Edhe ky ajet tregon dhembshurinë dhe mëshirën që zotëronte Pejgamberi ynë i dashur, rëndësinë që u kushtonte gjërave në dobi të shoqërisë dhe besimtarëve, se ndiente dhimbje nga gjërat që u shkaktonin dhimbje atyre dhe se për shkak të vështirësive që haste, ndiente shqetësim të pamasë.

Është radha juaj

Si përshkruhet Pejgamberi ynë në ajetet e mësipërme, në gjendjen e tij para profetësisë?

Përmbledhja e kapitullit

Përpara Islamit, arabët jetonin në formën e fiseve, të cilat formoheshin nga personat që vinin prej të njëjtit fis dhe ku individët lidheshin me njëri-tjetrin me anë të gjakut e farefisnisë. Njësinë më të vogël të fisit e përbënte familja.

Sipas traditave të asaj periudhe, një burrë mund të martohej me sa gra të dëshironte. Martesa e vajzave në moshë të vogël vinte nga tradita. Ndërsa femrat pranoheshin në familje vetëm pasi të kishin lindur fëmijë.

Divorci ishte i përhapur dhe kompetenca e vetme për divorc i përkiste mashkullit. Mirëpo disa gra mund të kërkonin që e drejta e divorcit të mbetej tek ato.

Ndërkohë, kur lindte një djalë, kjo ishte diçka që lëvdohej, siç e shpreh edhe Kur'ani, ndërsa vajzat konsideroheshin si të pavlera dhe herë pas here varroseshin të gjalla. Në shumë raste fëmijët vriteshin për shkak të varfërisë.

Njëra prej çështjeve të rëndësishme lidhur me familjen tek arabët para Islamit ishte çështja e "adoptimit". Personi që ishte adoptuar kishte të njëjtat të drejta me fëmijët e personit që e kishte adoptuar. Arabët para Islamit ndaheshin në tri klasa dhe grupime: të lirët, skllevërit dhe mevlatë.

Në Arabinë paraislamike jetesa kulturore nuk ishte shumë e pasur. Shfaqja me vonesë e shkrimit tek arabët para Islamit dhe mospërdorimi i tij gjerësisht nuk është bërë shkak që ata të privohen nga disa zhvillime kulturore. Në veçanti mund të thuhet se ishte zhvilluar shumë poezia dhe letërsia.

Para Islamit arabët janë angazhuar konkretisht edhe me historinë. Vartësia ndaj historisë është një ndër veçoritë më të spikatura të arabëve.

Astrologjinë, e cila ishte mjaft funksionale në shkretëtirat e pafund, arabët e përdornin më shumë si njësi kohore.

Tek arabët para Islamit falltarët dhe magjistarët konsideroheshin të rëndësishëm. Përgjithësisht, tek ata ekzistonte idhujtaria.

Në fakt, populli i zonës së Hixhazit, i cili është i rëndësishëm për shkak se aty lindi Islami në Gadishullin Arabik, kishin besuar te Hz. Ibrahimi dhe feja që solli ai sa i përket njëjësisë së Allahut dhe pranimit të faktit se Qabeja, e cila qe ndërtuar nga Hz. Ibrahimi, ishte e shenjtë. Por, me kalimin e kohës arabët u larguan nga besimi në një zot dhe filluan të adhurojnë idhujt, gjë që vijoi deri në ardhjen e Islamit.

Pejgamberi ynë (s.a.s.) vjen nga krahu Hashim i fisit Kurejsh, i cili banonte në Mekë. I ati është Abdullahu, ndërsa gjyshi Abdulmuttalibi.

Meqenëse Hz. Pejgamberi pati lindur pas vdekjes së babait, ai u rrit nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e gjyshit të tij, Abdulmuttalibit. Dhënia e fëmijës te një nënë qumështi nga fiset beduine u realizua edhe për të.

Kur Muhammedi (s.a.s.) ishte në moshën 6-vjeçare, nëna e tij, Amineja, vajti në Medine bashkë me robëreshën e saj, Ummu Ejmenin. Në kthim, Amineja u sëmur dhe ndërroi jetë. Ummu Ejmeni ia dorëzoi atë gjyshit të tij, Abdulmuttalibit. Përkujdesjen e jetimit Muhammed, i cili e humbi edhe gjyshin në moshën 8-vjeçare, e mori përsipër xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Ebu Talibi e donte shumë nipin dhe angazhohej në veçanti me të.

Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.) kishte një personalitet të respektueshëm në shoqëri. Kur ishte njëzet vjeç, bashkë me xhaxhallarët e tij mori pjesë në mbledhjen Hilfu'l-Fudul, gjë që tregon në mënyrë të qartë për rolin e rëndësishëm që kishte ai në shoqërinë, së cilës i përkiste. Pika e përbashkët ku bashkoheshin besimtarët dhe jobesimtarët ishte fakti që ai ishte i drejtë dhe i besueshëm.

Pejgamberi e pranoi kërkesën për martesë që i bëri Hz. Hatixheja dhe u martua me të. Në këtë kohë ai ishte 25 vjeç, ndërsa Hz. Hatixheja rreth 40 vjeçe. Pas martesës ndoqi edhe për një farë kohe çështjet tregtare të Hz. Hatixhesë. Nga kjo martesë lindën dy djem dhe katër vajza.

Në Kur'an ka mjaft ajete që tregojnë moralin dhe virtytshmëritë e tij. Këto ajete nuk bëjnë një dallim ndërmjet periudhës para se ai të ngarkohej me profetësi dhe pas profetësisë.

Të rishikojmë kapitullin

1. Si ishin formuar vlerat familjare në mjedisin ku lindi Pejgamberi ynë?
2. Cilat janë veçoritë që e dallojnë Pejgamberin nga njerëzit e tjerë?
3. Çfarë veprimtarish ka ushtruar Pejgamberi ynë në periudhën e rinisë?
4. Ç'njeri ishte Pejgamberi ynë në jetesën e tij tregtare dhe për çfarë ndryshimesh është bërë shkas kjo në jetën e tij?
5. Cilat veçori të Pejgamberit tregohen në Kur'an?

Pyetje vlerësuese

1. Cila nga të mëposhtmet nuk është vajza e Pejgamberit (s.a.s.)?

A) Fatima
B) Ummu Kulthum
C) Aishe
D) Zejneb

2. Cilit fis i përkiste Hz. Pejgamberi?

A) Fisi Zuhre
B) Fisi Hashim
C) Fisi Muttalib
D) Hazrexh

3. Cili është kuptimi i fjalës "Mual-lakat-i Seb'a"?

A) Një emër qyteti
B) Një shprehje që përdoret për të afërmit e Hz. Muhammedit
C) Shtatë kaside të njohura që u varën në murin e Qabesë, të marra nga poezitë e pëlqyera të poetëve të njohur arabë në periudhën e injorancës
D) Një emër fisi

4. Cila nga detyrat e mëposhtme kishte të bënte me sigurimin e ujit të pijshëm për vizitorët e Qabesë?

A) Hixhabe
B) Sidane
C) Rifade
D) Sikaje

5. Ç'do të thotë "Hilfu'l-Fudul"?

A) Një emër fisi
B) Vendi ku poetët këndonin poezi
C) Uniteti i të Virtytshmëve
D) Një emër panairi

6. Sa i përket çështjes së "Gjykimit të Qabesë", për çfarë u kërkua mendim?

A) Për funksionimin e punëve të Qabesë
B) Për plotësimin e rregullimeve përreth Qabesë
C) Për pritjen e komisioneve tregtare
D) Për vendosjen në vend të Haxheru'l-Esuedit

KAPITULLI 2

pejgamberi im

Profetësia:

Periudha e Mekës

1. Vitet e para të profetësisë

2. Solidariteti i bashkësive të para islame dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre

3. Kundërshtimet që pati Hz. Pejgamberi: reagimet e tij dhe përgjigjet e Kur'anit

4. Torturat e ushtruara ndaj muslimanëve, presionet shoqërore dhe emigrimi në Etiopi

5. Udhëtimi i Natës (Isra)

6. Takimi me medinasit dhe Besëlidhjet e Akabesë

7. Hixhreti në Medine

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Në këtë kapitull trajtohet periudha e parë e profetësisë që Hz. Pejgamberi kaloi në Mekë. Tregohet përvoja e parë e vahjit të marrë nga Hz. Pejgamberi, situata në periudhën kur vahji u ndërpre, rimarrja përsëri e vahjit nga ana e tij, si dhe pranimi i Islamit nga personalitete të rëndësishme, si Hz. Hamzai dhe Hz. Omeri. Kapitulli paraqet një rëndësi të veçantë edhe në kontekstin e parashtrimit të periudhës së hershme, kur u hodhën themelet e profetësisë.

Shoqëria nuk e ka përvetësuar me lehtësi profetësinë e tij. Pengesë për këtë janë bërë zakonet, traditat dhe shprehitë. Si rrjedhojë, ndaj tij ka pasur mjaft kundërshtime në shumë aspekte. Vetë ai dhe personat që i besuan, pësuan tortura nga më të ndryshmet. Pasi trajtohen këto çështje, në këtë kapitull është folur edhe sa i përket Hixhretit, si një rreze drite për njerëzit që patën rënë pre e torturave.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull:

1. Do të zotëroni të dhëna në lidhje me vitet e para të profetësisë së Hz. Pejgamberit.

2. Do të mësoni mbi kundërshtimet që iu drejtuan Hz. Pejgamberit, reagimet e treguara dhe përgjigjet që jep Kur'ani.

3. Do të mësoni torturat që u ushtruan ndaj muslimanëve të parë dhe qëndrimet e muslimanëve kundrejt këtyre torturave.

4. Do të vini re kuptimin e mrekullisë së Udhëtimit të Natës (Isra), e cila e ndryshoi në mënyrë thelbësore botën e ndjenjave të Hz. Pejgamberit dhe të muslimanëve të parë.

5. Përveç të afërmve të Hz. Pejgamberit, do të mësoni edhe mbi bisedimet e para të tij me medinasit dhe marrëveshjet që bëri me ta (Besëlidhjet e Akabesë).

6. Do të merrni të dhëna në lidhje me hixhretin në Medine dhe aktivitetet që u realizuan atje.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Mendoni vazhdimisht nëse i keni arritur apo jo synimet e cituara në fillim të kapitullit. Rilexoni çështjet që lidhen me ato synime, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.

2. Mos u mjaftoni vetëm me këtë vepër për të mësuar, shqyrtoni edhe veprat që mund të gjeni nga bibliografia e cituar në fund të tekstit.

3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe bartini ato në mjedisin mësimor.

1 Vitet e para të profetësisë

Vahji i parë

Mali Hira

Koncepti i vahjit ka kuptimin e frymëzimit dhe futjes së të vërtetës në zemër, të shenjës së ardhur me shpejtësi, si dhe të informimit në një mënyrë shumë të fshehtë, në vend të informimit haptazi. Vahji nënkupton përcjelljen e lajmeve nga Allahu te pejgamberët.

Pejgamberi ynë i dashur, vahjin e parë e mori në muajin Ramazan, në shpellën Hira. Që nga mosha 35-vjeçare, çdo vit në muajin e Ramazanit, ai shkonte në shpellën Hira për të medituar në lidhje me Allahun dhe për të bërë adhurim. Në muajin Ramazan të vitit miladi 610, kur ishte 40 vjeç, u gjend sërish përballë një situate ndryshe në shpellën Hira, ku pati vajtur për adhurim dhe meditim. Ai e tregon kështu këtë situatë të jashtëzakonshme: "Ai më bëri të ditur se ishte një melek me emrin Xhebrail, se ishte dërguar për të më njoftuar që Allahu më kishte zgjedhur mua si Pejgamber. Më mësoi si të marr abdest; kur trupi m'u pastrua plotësisht, kërkoi nga unë që të lexoj. Unë i thashë se nuk dija të lexoja. Më kapi mes dy krahëve, më shtrëngoi me forcë dhe më lëshoi menjëherë; kërkoi sërish që të lexoja. Unë përsëri i thashë se nuk dija të lexoja. Kur i thashë se nuk dija të lexoja, më kapi sërish mes dy krahëve, më shtrëngoi me më shumë forcë dhe më pas tha *(Hamidullah, Pejgamberi islam, I, 80)*:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një pikë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës i mësoi njeriut ato që nuk i dinte..." *(Alak, 96/1-5)*

Le të mendojmë

Si e vlerësoni faktin që vahji i parë, i cili i erdhi Pejgamberit, kishte të bënte me leximin, dijen dhe lapsin?

I gjendur në këtë situatë, Pejgamberi ishte sa i frikësuar, aq edhe i habitur. U kthye në shtëpi duke u dridhur dhe i tha bashkëshortes së tij, Hz. Hatixhesë: "Më mbulo, më mbulo!" Pasi u qetësua pak, i tregoi Hz. Hatixhesë se çfarë i kishte ndodhur.

Hz. Hatixheja e ngushëlloi atë me këto fjalë: "Ti gjithmonë ke qenë bujar dhe dorëlëshuar, ke bërë mirësi; gjithmonë ke ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët. Pa dyshim që Allahu nuk do të të bëjë ty pre të mashtrimeve të shejtanit."

Më pas, Hz. Hatixheja e dërgoi atë te Varaka b. Neufel, djali i xhaxhait të saj, i cili kishte të dhëna në lidhje me Hebraizmin dhe Krishterimin dhe kishte lexuar Teuratin e Inxhilin.

Pasi dëgjoi ç'kishte ndodhur, Varaka i tha Muhammedit (s.a.s.): "Ai që ke parë është Xhebraili (Namusi), të cilin Allahu ia zbriti Musait. Ah sikur në ditët kur të bësh thirrje të isha i ri! Sikur të jem në jetë kur fisi yt të të dëbojë nga vendlindja." *(shih Taberi, Tarih, II, 298-299; Përveç kësaj shih Ibn Sa'd, et-Tabakat, I, 195)*.

Hz. Hatixheja ishte ndër të parat që i besoi Hz. Pejgamberit. Ajo kishte besuar në profetësinë e bashkëshortit të saj, i miratoi çdo gjë që atij i kishte ardhur nga Allahu dhe e ndihmoi atë në çdo punë. Edhe Hz. Aliu, i cili në atë kohë ishte rreth moshës 10-vjeçare, u rendit ndër besimtarët e parë. Edhe Zejd b. Harithe u përfshi në safin e besimtarëve të parë. Zejdi qëndronte në shtëpinë e Hz. Pejgamberit. Atë e kishte zgjedhur Hz. Hatixheja ndër fëmijët skllevër të një tregtari të ardhur nga Siria; edhe bashkëshorti i vetëm i saj, Muhammedi (s.a.s.), e kishte parë atë dhe kishte kërkuar që t'ia dhuronte; më pas e kishte liruar dhe birësoi para profetësisë. Po ashtu, edhe shoku i afërt i Hz. Pejgamberit, Hz. Ebubekri, ishte ndër besimtarët e parë që nuk përfshihej te rrethi i pjesëtarëve të familjes.

Është radha juaj

Sa i përket besimit që Hz. Hatixheja tregoi ndaj Pejgamberit kur erdhi vahji, cila është ideja kryesore në lidhje me komunikimin që duhet të gjendet mes bashkëshortëve në një familje?

Ndërprerja e vahjit

Pasi mori pesë ajetet e para të sures Alak, si vahji i parë, për një farë kohe Hz. Pejgamberi nuk mori vahij. Kjo periudhë quhet Fetret-i Vahj, që ka kuptimin e ndërprerjes së vahjit.

Pranohet se situata e ndërprerjes së vahjit ka zgjatur për rreth 3 vjet. Kjo periudhë ndërprerjeje, pra ndërprerja e vahjit, pati një ndikim negativ mbi Hz. Pejgamberin dhe e dëshpëroi shumë atë. Brenda kësaj kohe ka dalë shpeshherë jashtë Mekës, ka shëtitur në vende të vetmuara, është ngjitur në shkrepa të thepisura dhe është përpëlitur me shpresën që të shihte melekun e vahjit.

Le të mendojmë

Ç'kuptim mund të ketë mosardhja e vahjit për një kohë të gjatë pas ardhjes së vahjit të parë?

Në këtë periudhë kohore, disa persona, duke i thënë se tashmë Allahu e kishte braktisur, kishin filluar të talleshin. Së fundmi, Pejgamberi mori këtë vahij:

"Betohem në shkëlqimin e paradites dhe në natën kur erret e qetësohet, se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhammed)! Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë, e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, aq sa të jesh i kënaqur. A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi? A nuk ishe nevojtar e të bëri që të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!" *(Duha, 93/1-11)*

Me këto ajete, vahji ishte tashmë një realitet i qartë dhe Allahu e kishte zgjedhur atë si Pejgamber. Kështu u vendos qetësia në zemrën e Pejgamberit tonë të dashur dhe mësoi se Allahu nuk ishte zemëruar me të e as e kishte braktisur atë

Përcjellja e vahjit në rrethin e afërt dhe te muslimanët e parë

Pejgamberi ynë ishte ngarkuar me detyrën për t'u përcjellë njerëzve vahjin që merrte nga Allahu, gjë që tregohet në ajetin: "O ti, i mbështjellë (o Muhammed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!" *(Mudeth-thir, 74/1-5)* Këto ishin ajetet e para që e ngarkonin atë me detyrën e shpalljes së Islamit.

Muhammedi (s.a.s.) e filloi detyrën e thirrjes së pari me thirrjen personale. Thirrjen e nisi fillimisht nga pjesëtarët e familjes me të cilët jetonte. Kjo thirrje personale që bëhej në fshehtësi vijoi deri kur erdhi ajeti që urdhëronte thirrjen nga të afërmit: "Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm!" *(Shu'ara, 26/214)*

Një urdhër i tillë në fillim e shtyu që të mbyllej në vetvete, sepse ishte i ndërgjegjshëm për vështirësitë që do të haste. Më në fund organizoi disa dreka me të afërmit. Në njërën prej këtyre drekave tha se Allahu e kishte ngarkuar atë me një detyrë të rëndë dhe sqaroi edhe se ç'ishte kjo punë. Madje, xhaxhai i tij, Ebu Lehebi, i cili gjendej atje, në një rast reagoi rëndë dhe mbajti një qëndrim përçmues, duke u tallur e duke thënë: "Për këtë na ftove këtu?"

Është radha juaj

Me kë i ndani fillimisht idetë tuaja mbi një çështje shumë të rëndësishme? Përse?

Përhapja e fesë

Pejgamberi ynë ishte ngarkuar me detyrë që tashmë të mos bënte thirrje fshehurazi, por në mënyrë të hapur dhe ta përhapte vahjin në të gjithë shoqërinë. Pas kësaj u ngjit në kodrën Safa, në afërsi të Qabesë, për të thirrur në Islam kurejshitët, si vendësit e Mekës dhe iu drejtua banorëve të qytetit. Banorët e qytetit e dëgjuan thirrjen, të cilin Hz. Pejgamberi e nisi duke thënë: "Nëse unë ju them se pas kësaj kodre ka ardhur një ushtri armike, e cila dëshiron të pushtojë qytetin dhe se kjo ushtri ka ngritur garnizonin atje, a do të më besoni?" Përgjigjja që mori ishte: "Deri tani ti nuk ke gënjyer kurrë, besojmë në çdo gjë që thua ti."

Pas kësaj, ai vazhdoi: "Atëherë betohem në Allah se, ashtu siç shtriheni për gjumë, ashtu do të vdisni një ditë dhe më pas, ashtu siç zgjoheni nga gjumi, do të ringjalleni dhe do të gjykoheni për bëmat tuaja. Dijeni mirë se ka një xhennet dhe xhehennem të përjetshëm. Pas vdekjes, të mirët do të shkojnë në xhennet, ndërsa të këqijtë në xhehennem. Jam i ngarkuar me detyrë që t'ju frikësoj ju me dënimin e ditës së kiametit që kemi para nesh. Ata që besojnë në njëjësinë e Allahut dhe në faktin se unë jam Pejgamber, do ta shpëtojnë veten nga dënimi, ndërsa ata që nuk besojnë do të marrin dënim të ashpër". Në vijim, i ftoi ata të besojnë në njëjësinë e Allahut dhe të njohin atë si të dërguar të Allahut *(shih Ibnu'l-Esir, el-Kamil, II, 60-61)*.

Gjatë këtij procesi, Pejgamberi ynë bëri përpjekje që vahjin e marrë nga Allahu ta përhapte në të gjithë shoqërinë, madje punoi intensivisht për këtë. Bëri thirrje që të rregullonte besimin në Allah, besim ky i cili ishte degjeneruar tek arabët; bëri thirrje të besojnë në Allah dhe të largohen nga shirku e idhujtaria, të jenë të respektueshëm ndaj Tij, të bëjnë adhurim ndaj Tij dhe të zbukurohen me moral të bukur.

Është radha juaj

Me cilat vështirësi mendoni se është përballur Pejgamberi gjatë përhapjes së shpalljes hyjnore? Përse?

Pranimi i Islamit nga Hz. Hamzai dhe Hz. Omeri

Pasi Hz. Pejgamberi filloi të bëjë thirrje haptazi ndaj Islamit, idhujtarët kurejshitë nisën të kundërshtonin në çdo lloj mënyre. Kjo situatë tregonte se për muslimanët kishin filluar ditë të vështira. Në një periudhë kaq të vështirë, pranimi i Islamit nga Hamza b. Abdulmuttalibi dhe Omer b. Hattabi, të cilët njiheshin për trimëritë e tyre, solli një pikëkthese, e cila u dha guxim muslimanëve.

Hz. Hamzai, xhaxhai i Hz. Pejgamberit, ishte disa vjet më i madh se ai. Hz. Hamzai u zemërua me Ebu Xhehilin që torturonte nipin e tij dhe u bë musliman duke mos e lënë kështu nipin vetëm. Pranimi i Islamit nga Hz. Hamzai i dha forcë Hz. Pejgamberit dhe atyre që i besonin atij. Ngaqë idhujtarët kishin frikë prej tij, filluan të shmangen disi e të refuzojnë ushtrimin e dhunës ndaj muslimanëve.

Omer b. Hattabi ishte nga fisi Adij i Kurejshit. Edhe ai njihej me trimërinë, ashtu si Hz. Hamzai. Në periudhën e parë ishte një ndër kundërshtarët e rëndësishëm të Islamit. Një ditë mori shpatën me vete dhe u nis të vriste Hz. Pejgamberin, i cili në atë kohë vijonte detyrën e thirrjes në Daru'l-Erkam. Në rrugë takoi Nuajm b. Abdullahun. Kur Nuajmi e pyeti se ku po shkonte, Omeri i tha: "Po shkoj të vras këtë Muhammedin, i cili nxori një fe të re, prishi rregullin e Kurejshit, prishi ëndrrat dhe shau zotat e tyre." Nuajmi i tha: "O Omer! Ti po mashtron veten. Mos mendon se ti do të vrasësh Muhammedin dhe fisi Abdu Menaf do të të lërë rehat?! Ti, së pari kthehu nga familja jote dhe rregullo gjendjen e tyre." Në vijim i tha se motra e tij, Fatima dhe bashkëshorti i saj ishin bërë muslimanë. Omeri u zemërua dhe u nis menjëherë drejt shtëpisë së motrës së tij. Në këtë kohë, Habbab b. Ereti po u mësonte atyre Kur'an. Omeri hyri brenda i zemëruar dhe filloi të rrahë motrën e bashkëshortin e saj, ndërsa Habbabi u fsheh në një qoshe. Ndërkohë, motra e tij, Fatima, i tha Omerit se ishin bërë muslimanë dhe se nuk do të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Pas kësaj, Omeri kërkoi që t'i tregonin ç'kishin lexuar. I sollën letra, ku ishte e shkruar sureja Taha. I pëlqyen ato që lexoi. Në atë çast Habbab b. Ereti doli nga vendi ku ishte fshehur. Omeri i tha se dëshironte të shkonte në vendin ku gjendej Hz. Muhammedi dhe u nis drejt Daru'l-Erkamit. Ata që ishin brenda, pasi panë se Hz. Omeri kishte shpatë me vete, fillimisht hezituan t'ia hapnin derën. Mirëpo Hz. Hamzai tha: "Nëse ka ardhur me qëllim të mirë, këtë mirësi nuk e privojmë nga ai, nëse ka ardhur me qëllim të keq, e vrasim atë me shpatën e tij." E hapën portën. E pyetën se me ç'qëllim kishte ardhur. Kur tha se kishte ardhur për të besuar, Pejgamberi ynë shprehu tekbirin. Pranimi i Islamit nga Hz. Omeri u bë burim morali për muslimanët, por edhe krijoi një forcë të rëndësishme.

Është radha juaj

Përse është i rëndësishëm për muslimanët pranimi i Islamit prej Hz. Hamzait dhe Hz. Omerit?

2 Solidariteti i bashkësisë së parë islame dhe marrëdhëniet mes tyre

Në fillim Hz. Pejgamberi u kërkoi atyre që i besonin të ishin të kujdesshëm dhe të matur, të mos flisnin hapur për Islamin dhe të vepronin në mënyrë të fshehtë. Për këtë arsye, kur dëshironin të bënin adhurim, shkonin në vende të vetmuara dhe vendosnin vëzhgues që të ruheshin.

Pasi i Dërguari i Allahut filloi të bëjë thirrje të hapur, idhujtarët e panë atë si një rrezik serioz dhe e shtuan armiqësinë ndaj tij. Filluan të provojnë çdo rrugë që të pengojnë ftesën e tij: u tallën me të dhe me muslimanët; torturuan shumë prej tyre, disa madje edhe i vranë. Në veçanti skllevërit dhe muslimanët pa mbrojtje u gjendën nën presione të hapura, dhunë dhe torturë.

Muslimanët e parë jetuan nën kushte të vështira, por mundoheshin ta vijonin jetën e tyre në një solidaritet të ndërsjellë. Besimtarët që gëzonin të mira të mjaftueshme materiale paguanin për shumë skllevër e robëresha muslimane dhe u falnin lirinë atyre.

3 Kundërshtimet ndaj Hz. Pejgamberit, reagimet e treguara dhe përgjigja e Kur'anit

Pretendimet se Muhammedi (s.a.s.) ishte i çmendur, falltar, magjistar dhe poet

Pejgamberi i fundit i njerëzimit, Muhammed Mustafai, prej çastit kur filloi të përcjellë vahjin që merrte nga Allahu, hasi në mjaft akuza e shpifje. Në krye të kritikave dhe shpifjeve që i drejtonin mohuesit ishte cilësimi i tij si i çmendur. Kur'ani i refuzon me ashpërsi këto akuza dhe tërheq vëmendjen me këto ajete:

"Ata (idhujtarët) thonë: 'O ti që të është shpallur Kështilla (Kur'ani), ti je vërtet i marrë! Përse nuk na sjell melekët, nëse ajo që thua është e vërtetë?' Ne i dërgojmë melekët vetëm me shpallje dhe dënim e atëherë (të dënuarve) nuk u jepet afat për të pritur." *(Hixhr, 15, 6-8)*

"Apo thonë: 'Ai është i çmendur!' Jo, ai u sjell të Vërtetën atyre, por shumica prej tyre e urrejnë të Vërtetën." *(Mu'minun, 23/70)*

"Sepse, kur u thuhej atyre: 'Nuk ka zot tjetër (të vërtetë) veç Allahut!', ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin: 'Vallë, a t'i braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë?' Nuk është ashtu (siç thonë ata), por ai (Muhammedi s.a.s.) ka sjellë të vërtetën dhe ka pohuar atë që thoshin të dërguarit e mëparshëm." *(Saffat, 37/35-37)*

"Por Zoti i tij e zgjodhi dhe e futi me ata që bëjnë punë të drejta. Kur dëgjojnë Kur'anin, mohuesit janë gati të të shqyejnë me shikimet e tyre dhe thonë: 'Ai është vërtet i marrë!' Por Kur'ani është vetëm këshillë për botët." *(Kalem, 68/50-52)*

"Nun. Betohem për penën dhe për atë që shkruajnë se ti (o Muhammed), falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë. Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer, se ti je me virtyte madhore. Së shpejti ti do ta shohësh, por edhe ata do ta shohin, se cilin prej jush e ka prekur marrëzia. Zoti yt e di mirë se cili është shmangur nga rruga e Tij dhe i njeh mirë ata që janë në rrugën e drejtë." *(Kalem, 68/1-2)*

Ndërsa pretendimet e tjera kishin të bënin me cilësimin e tij si falltar, magjistar dhe poet.

"... Nëse ti u thua: 'Ju do të ringjalleni pas vdekjes', mohuesit, me siguri do të thonë: 'Kjo nuk është asgjë tjetër, përveçse magji e kulluar!' Nëse Ne ua shtyjmë dënimin për një kohë të shkurtër, ata me siguri do të thoshin: 'Kush po e vonon?' Por ditën që do t'u vijë dënimi, asgjë nuk do t'ua largojë atë dhe do t'i përfshijë ajo që ata e përqeshnin." *(Hud, 11/7-8)*

"Betohem për gjithçka që ju shihni dhe për gjithçka që nuk e shihni, se ky (Kur'an) është vërtet fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari të nderuar (Muhammedit s.a.s.) e nuk është fjalë poeti; sa pak që besoni! Nuk është as fjalë e ndonjë falltari; sa pak që po reflektoni! Ai është shpallje e zbritur nga Zoti i botëve! Sikur ai (Muhammedi), në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorës së djathtë dhe me siguri që do t'ia prisnim damarin e qafës e askush prej jush nuk do të mund ta mbronte. Natyrisht, Kur'ani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!" (Hakka, 69/38-48)

Pretendimi se ajetet që këndonte Hz. Pejgamberi ishin fryt i mendjes njerëzore

Njëri prej pretendimeve themelore të mohuesve kishte të bënte me faktin se Kur'ani është fryt i mendjes njerëzore, që është fjalë njerëzore. Libri ynë i lartë, Kur'ani, u përgjigjet kështu këtyre pretendimeve:

"E, kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin para Nesh thonë: 'Na sill ndonjë Kur'an tjetër, ose ndërroje atë!' Thuaj (o Muhammed): 'Është e pamundur që unë ta ndërroj atë. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj ta kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe."*(Junus, 10/15)*

"Ose ata thonë: 'Ai (Muhammedi) e ka trilluar vetë atë (Kur'anin).' Thuaju: 'Por, nëse unë e trilloj atë, ju nuk do të mund të më mbroni nga dënimi i Allahut. Ai i di më së miri të gjitha shpifjet tuaja për të (Kur'anin). Mjafton Ai dëshmitar ndërmjet meje dhe jush..." *(Ahkaf, 46/8)*

'Ky (Kur'an) nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar! Këto janë vetëm fjalë të një vdekatari!' Do ta hedh në Sekar (xhehennem)!" *(Mudeth-thir, 74/24-26)*

"Ata thonë: 'Këto janë vetëm ëndrra të turbullta! Ose ai i ka trilluar ato. Madje, ai është poet. Le të na sjellë një mrekulli, ashtu si i kanë sjellë të dërguarit e parë!' Asnjë vendbanim nga ata që i kemi shkatërruar, nuk ka besuar. E vallë, a do të besojnë këta?" *(Enbija, 21/5-6)*

Mendimi se Muhammedi (s.a.s.) nuk zotëronte veçoritë e nevojshme për të marrë vahj

Njëra prej kritikave që idhujtarët i drejtuan Hz. Pejgamberit, sipas dëshmisë së Kur'anit Famëlartë, ishte se ai nuk zotëronte veçoritë e nevojshme për të marrë vahj.

"Njerëzit nuk i pengoi asgjë të besojnë, kur u erdhi shpallja, përveçse thanë: 'A mos vallë, Allahu ka sjellë si të dërguar një njeri?' Thuaj: 'Sikur në Tokë të kishte melekë që ecnin qetësisht, Ne do t'u çonim atyre nga qielli një melek si të dërguar." *(Isra, 17/94)*

"Gjithashtu, ata thonë: 'Ç'është ky i dërguar që ha ushqim dhe shëtit nëpër tregje?! Përse nuk i është dërguar atij një melek e të bëhet me të paralajmërues?! Ose, përse nuk i është zbritur një thesar apo të kishte një kopsht, nga i cili të ushqehej?!' Të padrejtët thonë: 'Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur!' Shiko çfarë shembujsh të sjellin e ata (me këtë) kanë humbur e nuk mund të gjejnë rrugën e vërtetë. Qoftë i lartësuar Ai, i Cili, nëse do, mund të të japë gjëra më të mira se këto, kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe të bëjë për ty pallate." *(Furkan, 25/7-10)*

"Sikur t'i kishte zbritur ky Kur'an ndonjë njeriu të madh prej njërit nga këto dy qytete!" Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur disa më lart se të tjerët, me qëllim që disa t'u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata." *(Zuhruf, 43/31-32)*

"Sa herë që të shohin ty, të marrin vetëm për tallje: 'Vallë, këtë ka sjellë Allahu si të dërguar?!'" *(Furkan, 25/41)*

Pritshmëritë që ai të tregojë mrekulli si Pejgamber

Një tjetër metodë që përdorën mohuesit për të vënë në pozitë të vështirë Hz. Pejgamberin ishte kërkesa që ai të demonstronte ngjarje të jashtëzakonshme. Në lidhje me këtë çështje, Kur'ani jep këto të dhëna:

"Ata thonë: 'Ne nuk do të të besojmë (o Muhammed), derisa të bësh që të shpërthejë nga toka një gurrë uji për ne; ose, derisa të kesh një kopsht hurmash dhe rrushi, nëpër të cilin të rrjedhin lumenj; ose, derisa ta bësh qiellin të bjerë copa mbi ne, siç ke thënë; ose, derisa të sjellësh Allahun dhe melekët përpara nesh; ose, derisa të kesh shtëpi prej ari; ose, derisa të ngjitesh në qiell. Ne nuk do të të besojmë, edhe sikur të ngjitesh në qiell, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë.' Thuaj: 'I Përlëvduar qoftë Zoti im! Unë nuk jam tjetër, veçse njeri - i dërguar!'" *(Isra, 17/90-93)*

"Dhe ata thonë: 'Sikur t'i ishte zbritur atij ndonjë mrekulli prej Zotit të tij?' Thuaj: 'Me të vërtetë, të padukshmet i di vetëm Allahu. E, pritni ju, se edhe unë po pres me ju (gjykimin e Allahut).'" *(Junus, 10/20)*

"Ata (idhujtarët) thonë: 'O ti që të është shpallur Këshilla (Kur'ani), ti je vërtet i marrë! Përse nuk na sjell melekët, nëse ajo që thua është e vërtetë?' Ne i dërgojmë melekët vetëm me shpallje dhe dënim e atëherë (të dënuarve) nuk u jepet afat për të pritur.'" *(Hixhr, 15/6-8)*

"Ata thonë: 'Përse nuk i janë zbritur (Muhammedit) mrekulli nga Zoti i tij?' Thuaj (o Muhammed): 'Mrekullitë janë vetëm tek Allahu; unë jam vetëm një paralajmërues i qartë.' Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre? Me të vërtetë që në të ka mëshirë dhe këshillë për njerëzit që besojnë." *(Ankebut, 29/50-51)*

"Neve nuk na pengon asgjë që të dërgojmë shenja, mirëpo ato i kanë përgënjeshtruar popujt e lashtë. Ne i dhamë fisit Themud devenë si shenjë të qartë, por ai u soll keq me atë. Ne dërgojmë shenja vetëm për t'i frikësuar njerëzit." *(Isra, 17/59)*

Është radha juaj

A gjeni ndonjë lidhje ndërmjet mjedisit social, ekonomik dhe fetar ku ndodhej shoqëria arabe dhe kundërshtimeve që iu bënë Pejgamberit?

4 Torturat që u ushtruan ndaj muslimanëve, presionet shoqërore dhe emigrimi në Etiopi

Pasi Hz. Muhammedi, pejgamberi i mëshirës dhe i dhembshurisë, filloi të bënte thirrje të hapur në emër të Islamit, reagimet ndaj tij nisën të shtoheshin vazhdimisht. Në veçanti krerët e Mekës u sollën shumë të pamëshirshëm në këtë pikë. Ata nuk u mjaftuan vetëm me kundërvënien ndaj Pejgamberit tonë të dashur, me nxjerrjen e pengesave atij dhe me sfidat që i hapnin, por u përpoqën edhe të ushtrojnë tortura mbi muslimanët, të vështirësojnë jetën e tyre dhe ta bëjnë atë të padurueshme. Krerët e fisit Kurejsh i shtuan presionet e tyre pasi panë se, pavarësisht çdo gjëje, i dërguari i mëshirës e vijonte ftesën dhe thirrjen e tij dhe se numri i besimtarëve sa vinte e shtohej. Fakti që të varfrit dhe të vetmuarit gjetën prehje dhe qetësi në zemrat e tyre nga thirrja e tij, kjo u bë sidomos shkak që liderët e Mekës të ndiheshin të shqetësuar. Prandaj edhe i shtrënguan ata me metodën e dhunës që të ktheheshin nga besimi i tyre. Ushtruan tortura çnjerëzore ndaj të varfërve dhe të vetmuarve si Ammari, i ati Jasiri dhe e ëma Sumejje, ndaj etiopianit Bilal dhe Habbab b. Eretit.

Në këtë periudhë, edhe Hz. Pejgamberi vetë ra pre e torturave dhe presioneve. Që në fillim ai kishte zgjedhur si pikë takimi shtëpinë e Erkamit, një i ri sahabe, në të cilën drejtonte thirrjen e Islamit. Kjo shtëpi gjendej në rrëzë të kodrës së Safasë dhe ishte një vend i volitshëm për të krijuar kontakt me ata që vinin nga jashtë qytetit me qëllim kryerjen e haxhit dhe umresë, pa tërhequr vëmendje. Këtu, Hz. Pejgamberi u jepte informacione atyre që pranonin Islamin, u mësonte atyre ajetet e Kur'anit dhe i ftonte ata në Islam; bënte adhurim ndaj Zotit të tij bashkë me besimtarët.

Idhujtarët e Mekës, ngaqë nuk e arritën synimin e tyre nëpërmjet metodave që përdorën për të penguar Hz. Pejgamberin, iu drejtuan xhaxhait të Hz. Pejgamberit, Ebu Talibit, me qëllim që ta pengonte nipin ose të hiqte dorë nga mbrojtja e tij.

Ushtruan presion ndaj Ebu Talibit duke i thënë: "Nipi yt ofendoi zotat tanë, keqësoi fenë tonë, tha se ne jemi të pamend dhe se etërit tanë janë në rrugë të gabuar. Tani ose ti pengoje atë, ose hiq dorë nga mbrojtja e tij."

Pas kësaj, Ebu Talibi thirri nipin dhe e informoi për fjalët e kurejshitëve. I tha atij që të heqë dorë nga kauza e tij, se çështja kishte arritur në një pikë që edhe ai nuk e përballonte dot. Pas kësaj, Hz. Pejgamberi i tha: "Xhaxha! Mos vallë edhe ti po më braktis? Betohem në Allah, i cili ka në dorë jetën time, se edhe sikur të më jepnin diellin në dorën e djathtë dhe hënën në të majtën, unë nuk do ta braktisja detyrën time të shpalljes hyjnore; madje, edhe nëse ti do të më braktisësh, unë sërish nuk do t'i realizoj fjalët e tyre. Zoti im, Allahu, më mjafton mua!" Pas këtyre fjalëve e braktisi vendin e mbledhjes, ndërsa Ebu Talibi u shpreh se për sa kohë do të ishte gjallë, nuk do ta braktiste kurrë nipin e tij dhe e ktheu pas delegacionin e ardhur *(Ibnu'l-Esir, el-Kamil, II, 63-64).*

Le të mendojmë

Cilat veçori të Pejgamberit tregohen në përgjigjen që ai i dha xhaxhait të tij?

Pasi idhujtarët nuk morën ndonjë rezultat nga kjo, iu drejtuan personalisht Hz. Pejgamberit dhe i bënë disa propozime. Njëri prej krerëve, Utbe b. Rebia, vajti te Hz. Pejgamberi dhe i tha: "Muhammed! Ty gjithmonë të kemi ditur dhe njohur si të mençur, humanitar, gjakëmbël dhe të afërt përzemërsisht. Nuk të kemi parë të bësh të këqija ndaj askujt, si dhe nuk do të të përsëris dhe të të them se sa entuziazëm, por dhe kaos kanë krijuar mbi qytetarët vendës lajmet që ti ke sjellë nga bota e panjohur. Më thuaj me sinqeritet, ç'qëllim dhe synim ke nga të gjitha këto? Mos vallë dëshiron para? Unë të garantoj, qyteti do të mbledhë dhe do të të japë aq sa dëshiron ti. Mos vallë dëshiron ndonjë grua? Zgjidh dhe merr vajzat më të bukura të qytetit si bashkëshortet e tua! Të jesh i sigurt se kemi vendosur të bëjmë çdo gjë që të të kënaqim ty. Apo kërkon të kalosh në krye të qytetit? Përsëri ne jemi të gatshëm të të zgjedhim si kryetarin më të lartë tonin, veçse me një kusht: të mos sulmosh fenë dhe vlerat që zotërojmë, mos t'i tronditësh ata! Mos thuaj se do të hidhen në zjarrin e përjetshëm të xhehennemit idhujt që etërit tanë adhuronin më parë dhe ata që ne adhurojmë tani!"

Cakun e tejkaloi në fund të fjalës së tij, kur tha: "Nëse e ndien veten të sëmurë, le të gjejmë për ty njerëzit më të mirë që të përkujdesen dhe të shërojnë trupin e shpirtin tënd, por nuk duam që në qytet, brenda kësaj bashkësie e shoqërie, të shfaqen ngatërresa, përplasje e konflikte."

Si përgjigje, Hz. Pejgamberi lexoi disa ajete nga Kur'ani:

"Ha, Mim. Kjo është shpallje prej të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë shtjelluar qartë, një Kur'an në gjuhën arabe, për njerëzit me dije. Ai sjell lajme të mira dhe paralajmërime, por shumica e njerëzve ia kthejnë shpinën dhe largohen pa e dëgjuar.

Ata thonë: 'Ajo për të cilën ti na thërret, nuk i arrin zemrat tona, sepse ato janë të mbrojtura mirë. Veshët tanë janë të shurdhër e midis nesh e teje ka perde. Prandaj ti vepro si të duash, se edhe ne kështu do të veprojmë.'"

Thuaj (o Muhammed!): "Në të vërtetë, unë jam vetëm një njeri si ju. Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i Vetëm, andaj ecni në rrugën e drejtë që të çon tek Ai dhe kërkoni falje prej Tij! Mjerë ata të cilët i shoqërojnë Atij zota të tjerë, e të cilët nuk japin zekatin dhe nuk besojnë në jetën tjetër! Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që do të kenë shpërblim të pandërprerë."

Thuaj: "Vallë, vërtet e mohoni Atë, i cili e ka krijuar Tokën në dy ditë dhe sajoni zota të barabartë me Atë?!" Ai është Zoti i botëve! Ai krijoi në Tokë male të palëvizshme që ngrihen lart, e bekoi atë dhe përcaktoi në të furnizimin (për banorët) e saj me masë për katër ditë; ky është shpjegimi për të gjithë ata që pyesin. Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullire e i tha atij dhe Tokës: 'Ejani të dy, me hir a me pahir!' Ata u përgjigjën: "Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!"

Ai krijoi shtatë qiej në dy ditë dhe çdo qielli i caktoi detyrat e tij. Qiellin më të afërm Ne e zbukuruam me yje të shkëlqyer dhe i vumë roje. Ky është urdhri i të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshmit. Nëse ata shmangen, ti thuaju: "Ju paralajmëroj me rrufenë që goditi fiset Ad dhe Themud." *(Fussilet, 41/1-13)*

Le të mendojmë

Pejgamberi ynë u përgjigjet propozimeve të Utbe b. Rebia me ajetet e Kur'anit. Cili është mesazhi thelbësor që kërkohet të jepet nëpërmjet ajeteve të kënduara nga Pejgamberi ynë?

Utbe b. Rebia mbeti i shtangur kur dëgjoi këto ajete dhe iu përgjërua Hz. Pejgamberit që të ndalonte së kënduari. Më pas u largua thuajse sikur po arratisej nga aty, për të shkuar drejt vendit ku po e prisnin kurejshitët, të cilëve u tha: "Veproni siç të dëshironi, sepse kjo nuk është diçka që mund ta zgjidh unë..." *(Hamidullah, Pejgamberi islam, I, 109-111)*.

Fakti që shtypja, mizoria, tortura dhe presioni shoqëror po vijonin në Mekë dhe Hz. Pejgamberi nuk kishte mundësi t'i parandalonte, bëri që ai të orientohej drejt kërkimeve të tjera. Ai u dha këtë sugjerim besimtarëve: "Nëse dëshironi dhe mund t'ia arrini, strehohuni në Etiopi! Sepse atje është në krye një sovran që nuk tregohet mizor ndaj askujt në shtetin e tij; ai vend atje është vend i drejtësisë, qëndroni atje deri sa Allahu të falë një lehtësi në punët tona" *(Hamidullah, po aty, I, 117)*.

Pas këtij sugjerimi, një grup nga muslimanët vendosën të emigrojnë në Etiopi. Emigrimi i parë për në Etiopi është realizuar në muajin Rexheb të vitit të pestë të profetësisë (viti 615). Fillimisht, një grup i përbërë prej pesëmbëdhjetë personash, katër prej tyre gra dhe njëmbëdhjetë burra, u nisën drejt Etiopisë. Ndër ta ishte edhe Hz. Osmani dhe bashkëshortja e tij, vajza e Pejgamberit tonë të dashur, Rukija.

Pasi torturat e idhujtarëve vazhduan të shtoheshin më tej, rreth një vit më vonë, grupin e parë e pasoi një grup tjetër i dytë. Emigrimi i dytë në Etiopi u realizua me një grup të përbërë prej tetëdhjetë meshkujsh dhe tetëmbëdhjetë grash, nën kryesinë e Xhafer b. Ebi Talibit.

Mekasit kishin ndier shqetësim nga braktisja e Mekës prej muslimanëve, të cilët patën emigruar në Etiopi dhe kishin ngarkuar me detyrën e delegatit Amr b. Asin dhe Abdullah b. Ebu Rebian. Ata i kishin ofruar Nexhashiut dhurata të shumta, me qëllim që emigrantët të ktheheshin pas. Por Nexhashiu nuk ua kishte kthyer pas emigrantët delegatëve. Më pas, disa prej emigrantëve, në periudha të ndryshme kohore, u kthyen me dëshirë në Mekë dhe Medine, ndërsa grupi i fundit u kthye në Medine në vitin 7/628.

Bojkotimi që populli i Mekës bëri ndaj besimtarëve

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve të bëra që Pejgamberi i fundit i njerëzimit, Muhammedi (s.a.s.), të hiqte dorë nga thirrja profetike, pavarësisht torturave të ushtruara me qëllim që muslimanët të ktheheshin nga ky besim, fakti që delegati i dërguar te sovrani i Etiopisë për të kthyer mbrapsht të emigruarit atje mori përgjigje negative, i shtyu mekasit drejt mënyrave të tjera për të ndaluar thirrjen e Hz. Pejgamberit. Në këtë kuadër, idhujtarët mekas vendosën që të përjashtojnë fisin e Hz. Pejgamberit (s.a.s.), si dhe ta bojkotojnë atë.

Lidhur me këtë vendim arritën në konsensus që të ndaloheshin diskutimet me fisin Hashim, qëndrimi me ta, martesat e ndërsjella mes tyre, të mos kishte më marrëdhënie tregtare, si dhe të mos arrihej asnjë marrëveshje paqeje e sigurie deri sa të dorëzohej Hz. Pejgamberi, me qëllim që ta vrisnin. Pasi e shkruan këtë vendim, e varën atë në Qabe.

Pas këtyre vendimeve të vështira që ishin marrë, Ebu Talibi mori Muhammedin (s.a.s.) dhe familjen e tij dhe i transferoi në lagjen Ebu Talib (Shi'b Ebi Talib), në të cilën besonte se do të ishin më të sigurt. Përveç Ebu Lehebit dhe familjes së tij, të gjithë muslimanët dhe idhujtarët që i përkisnin fisit Hashim u mblodhën në këtë lagje. Këta u detyruan të jetojnë në rrethana tejet të vështira këtu, ku ishin të izoluar dhe nën kushtet e një

bojkoti social-ekonomik. Idhujtarët mekas punonin në mënyrë të rregullt për të zbatuar vendimet e marra, si dhe mbanin nën kontroll lagjen ku jetonte fisi Hashim. Në muajt haram, kur ishte e ndaluar lufta (Dhilkade, Dhilhixh-xhe, Rexheb dhe Muharrem), muslimanët mundoheshin të siguronin ushqime prej haxhinjve që vinin nga jashtë qytetit. Edhe nga populli i Mekës kishte prej atyre që iu dhimbseshin muslimanët dhe u çonin ushqime në luginën ku ishin strehuar. Njëri prej këtyre ishte edhe Hisham b. Amri.

Pasi torturat ndaj Hz. Pejgamberit dhe shokëve të tij kishin arritur në një pikë të parezistueshme, Hishami u takua me Zuhejr b. Ebi Umejjen dhe kërkoi nga ai që të shfuqizohet embargoja. Këta të dy arritën në konsensus që të anulojnë marrëveshjen dhe për këtë të merrnin edhe mbështetjen e të tjerëve. Atyre iu bashkuan edhe Mutim b. Adij, Ebu'l-Bahteri b. Hisham dhe Zema b. Esued. Ditën tjetër Zuhejri vajti te Qabeja dhe i bëri thirrje popullit që të përfundonte bojkotimin ndaj fisit Hashim. Edhe pse disa persona kundërshtuan, siç ishte Ebu Xhehili, në fund, me përpjekjet e bëra, ky bojkot social, psikologjik dhe ekonomik, që filloi në vitin 616 dhe zgjati për tre vjet, përfundoi.

Le të mendojmë

Si mendoni, ndikimi i bojkotit mbi muslimanët ka qenë pozitiv apo negativ? Përse?

Fundi i bojkotimit dhe Viti i Pikëllimit

Pak kohë pasi përfundoi bojkotimi i mekasve ndaj fisit Hashim, i cili filloi në vitin 616 dhe zgjati deri në vitin 619, Hz. Pejgamberi humbi xhaxhanë, Ebu Talibin, i cili ishte mbrojtësi i tij dhe që i pati qëndruar pranë në çdo rrethanë. Po ashtu, humbi edhe bashkëshorten e tij, Hz. Hatixhenë, të cilën e donte shumë dhe me të cilën ndante çdo gjë. Këto dy vdekje të ndodhura brenda një periudhe të shkurtër kohore, e pikëlluan thellë atë. Në historinë islame, viti kur ndodhën këto dy vdekje përmendet si "Viti i pikëllimit".

Udhëtimi në Taif

Qëndrimi i Hz. Pejgamberit në Mekë sa vinte e përkeqësohej. Pas vdekjes së Ebu Talibit dhe Hz. Hatixhesë, presionet mbi muslimanët në Mekë filluan të shtoheshin. Nën këto kushte, Pejgamberi ynë vendosi të kërkojë një vend jashtë Mekës, ku mund të strehohej. Për këtë arsye mendoi Taifin. Taifi, përveç disa dallimeve të vogla, ishte një kopje e vogël e Mekës. Taifi ishte një qendër tregtare, e cila kishte veçanërisht marrëdhënie të afërta me Jemenin. Kishte një klimë të shëndetshme dhe ishte një zonë produktive. Populli vendës i Taifit ishte fisi Thakif. Shumica e të pasurve të Mekës kishin toka në Taif, të cilat i përdornin si vendpushim veror. Përveç kësaj, edhe fisi Hashim, ku bënte pjesë Pejgamberi (s.a.s.), kishte marrëdhënie të afërta me Taifin.

Pejgamberi ynë, pas vdekjes së Ebu Talibit, për shkak të sjelljes së keqe që shtohej ditaditës ndaj tij, në vitin e dhjetë të profetësisë (m. 20), rreth fundit të muajit Sheuual, vajti në Taif për të kërkuar një mbrojtës dhe për të gjetur mbështetës të rinj. Ai e braktisi Mekën fshehurazi dhe u nis drejt Taifit më këmbë. Ka shumë mundësi që atij t'i ishte bashkuar edhe djali që pati birësuar, Zejd b. Harithe.

Udhëtimi drejt Taifit, i cili u realizua në muajin Sheuual të vitit 620, rezultoi me takimin e tre kryetarëve që ishin krerët e Taifit dhe që kishin marrëdhënie fisnore me të. Në bisedimet që patën, i Dërguari i Allahut u përball me një sjellje mjaft të ashpër, aq sa i kërkuan ta braktiste menjëherë qytetin, madje edhe i folën në mënyrë tallëse. Për më tepër, nxitën edhe shtresën e ulët të qytetit që ta godisnin me gurë. I dërguari i Allahut, edhe pse i plagosur, arriti të strehohej me shumë vështirësi në një shtëpi me kopsht, e cila u përkiste mekasve jashtë Taifit. Këtu u sollën mirë me të dhe treguan interes ndaj tij. Pasi pushoi për një kohë të shkurtër këtu, u nis për udhëtim drejt Mekës. I lodhur, arriti në kodrat që rrethonin Mekën. Ebu Lehebi kishte shpallur se ai nuk mund të hynte në Mekë, prandaj kërkoi dikë që mund ta mbronte për të hyrë në qytet. Mut'im b. Adiji mori edhe djemtë e tij dhe vajti ta priste Hz. Pejgamberin, duke e marrë kështu nën mbrojtje.

Të studiojmë - Të mësojmë

Bëni një studim mbi çështjen e qëndrimit të Pejgamberit në Taif, mbi situatën negative me të cilën u përball dhe mbi fjalët që tha. Duke u nisur nga studimi që keni bërë, përcaktoni se cilat veçori morale të Pejgamberit dalin në plan të parë.

Hz. Pejgamberi, së pari fali dy rekat namaz, duke bërë tavaf Qabenë dhe nga atje vajti në shtëpinë e tij.

5 Udhëtimi i Natës (Isra)

Që kur nisi shpalljen hyjnore, Hz. Pejgamberi u përball në mënyrë të hapur me reagime, aq sa herë pas here gjendej në rrethana tepër të vështira. Humbja e xhaxhait, Ebu Talibit, i cili e mbrojti atë gjatë bojkotimit social, psikologjik dhe ekonomik, më pas edhe humbja e bashkëshortes së tij, Hz. Hatixhesë, e shtoi më shumë pikëllimin e tij. Ky pikëllim mori përmasa edhe më të mëdha pasi nuk u prit mirë në Taif. Por, në njërën prej këtyre kohëve të vështira dhe të mbushura me dëshpërim, një natë, Allahu e çoi atë nga Mesxhidi Haram në Mesxhidin Aksa. Ky udhëtim i ndërmarrë natën emërohet si "Isra"; edhe emri i sures që flet për këtë ngjarje në Kur'an është "Isra".

"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhammedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë." *(Isra, 17/1)*

Ashtu siç e shpreh dhe literatura, në këtë natë ka ndodhur njëkohësisht edhe ngjarja e lartësimit në qiell (Mi'raxh) e Pejgamberit tonë dhe në Mi'raxh ishin përcaktuar si farz pesë kohë namaz.

Është radha juaj

Përse Allahu ka mundësuar që Pejgamberi ynë të përjetojë një përvojë të tillë të veçantë?

6 Takimi me medinasit dhe Besëlidhjet e Akabesë

Hz. Pejgamberi, pavarësisht të gjitha vështirësive që kishte përjetuar, vijonte thirrjen, mundohej të arrinte marrëveshje mbrojtjeje, me qëllim që të shkonte në zonat jashtë Mekës. Për këtë qëllim u ishte drejtuar rreth 15 përfaqësuesve të fiseve, por nuk kishte marrë mbështetjen e tyre. Në vitin 11 të profetësisë kishte filluar të shëtiste mes grupeve dhe karvanëve të huaj për t'u takuar me haxhinjtë që vinin në Mekë. Ndërkohë, në vitin 620, në periudhën e haxhit, ndërsa vijonte aktivitetet e prezantimit të Islamit, u takua me gjashtë persona, pjesëtarë të fisit Hazrexh nga Jethribi (Medinja), në zonën e Akabesë. I ftoi ata të bëheshin muslimanë duke u treguar Islamin. Ata e pranuan këtë thirrje. Këta persona ishin: Es'ad b. Dhurare, Auf b. Harith, Rafi b. Malik, Ukbe b. Amir dhe Xhabir b. Abdullah.

Dhanë fjalën që të takoheshin sërish vitin e ardhshëm, në të njëjtin vend, në periudhën e haxhit. Këta gjashtë persona nga fisi Hazrexh, filluan të përhapnin Islamin në Medine.

Në periudhën e haxhit të vitit që pasoi (në vitin 621), me të u takuan dymbëdhjetë persona, dhjetë hazrexhas, ndër ta edhe gjashtë personat që ishin takuar një vit më parë me Pejgamberin në Mekë, si dhe dy persona nga fisi Eus. Këta dymbëdhjetë persona i dhanë fjalën Hz. Pejgamberit se nuk do t'i njihnin ortak Allahut, se nuk do të bënin vjedhje dhe zina (marrëdhënie të jashtëligjshme), se nuk do të vrisnin fëmijët e tyre, se nuk do të shpifnin dhe se do të respektonin urdhrat. Ky takim dhe kjo marrëveshje u quajt "Besëlidhja e Parë e Akabesë".

Bashkë me këtë delegacion, Pejgamberi ynë dërgoi në Medine edhe sahabiun e besueshëm, i cili e njihte mirë Kur'anin, Mus'ab b. Umejrin. Brenda vitit të mëpastajmë, si rezultat i përpjekjeve dhe vullnetit të Mus'ab b. Umejrit, numri i muslimanëve në Medine u shtua në shifra të konsiderueshme dhe pothuajse nga çdo fis pati prej atyre

që pranuan Islamin. Në periudhën e haxhit të vitit 622, medinasit dërguan një karvan haxhi prej 500 personash në Mekë. Ndër këta gjendeshin 73 meshkuj, 2 femra, gjithsej 75 muslimanë. Një natë, këta ranë dakord të takoheshin në Akabe me Hz. Pejgamberin. Në vendin ku ishin strehuar, për të mos tërhequr vëmendjen e të tjerëve, u nisën për rrugë të organizuar në grupe të vogla. Pejgamberi (s.a.s.) ishte atje bashkë me xhaxhanë e tij, Abbasin. Abbasi në atë kohë ende nuk e kishte pranuar Islamin, ai e donte nipin e tij dhe e mbronte atë për shkak të marrëdhënieve fisnore. Në këto bisedime të bëra u trajtua çështja e migrimit të muslimanëve që ndodheshin në Medine në rrethana të vështira.

Hz. Muhammedi u tha: "Më premtoni se kur të vij në qytetin tuaj do të më ndihmoni në çdo aspekt, se do të më mbroni mua ashtu siç mbroni gratë dhe fëmijët tuaj."

Ata iu përgjigjën: "Po, betohemi në Allahun që të ka dërguar me fenë e vërtetë, se do të të ruajmë ty nga çdo gjë që ruajmë gratë dhe fëmijët tanë." *(shih Ibn Hisham, II, 54, 55, 56, 64)*.

Kjo bashkësi u betua këtu jo vetëm se do t'i bindej Hz. Pejgamberit, por edhe se do të luftonte bashkë me të në periudha të vështira. Hz. Pejgamberi kërkoi nga ata që të zgjedhin mes tyre 12 përfaqësues, me qëllim që të bënin një kryesi. Pas kësaj ata zgjodhën 12 përfaqësues, 3 prej tyre nga fisi Eus, ndërsa 9 nga fisi Hazrexh. Si përfundim, me këtë besëlidhje, e cila u emërtua si "Besëlidhja e Dytë e Akabesë", u mor vendimi mbi migrimin në Medine. Edhe pse Kurejshi kishte dëgjuar disa fjalë në lidhje me këto bisedime, të cilat për ta dukeshin si armiqësore, nuk arritën ta konfirmojnë këtë. Më pas, Hz. Pejgamberi filloi t'i nxisë shokët e tij që të shkonin në Medine.

Para se Hz. Pejgamberi të migronte atje, qyteti i Medines përmendej me emrin Jethrib. Pasi u emërtua Medinetu'n-Nebi (qyteti i Pejgamberit), emri i saj filloi të përmendej në formë të shkurtër, Medine. Populli vendës i Jethribit ishin fiset arabe Eus dhe Hazrexh, si dhe fiset hebrenje të përbëra nga fisi Kurajdha, Kajnuka dhe Nadir.

7 Migrimi (Hixhreti) në Medine

Pas kësaj besëlidhjeje, e cila u realizua me medinasit në muajin Dhilhixh-xhe të vitit 622 në Akabe dhe në të cilën u mor vendimi i migrimit në Medine nga muslimanët mekas, këta të fundit, të organizuar në grupe të vogla, u nisën për rrugë, me qëllim që të shkonin në Medine. Për një kohë të shkurtër, në Mekë nuk pati mbetur musliman tjetër, përveç Hz. Pejgamberit, Hz. Ebubekrit dhe familjeve të tyre; po ashtu edhe Hz. Aliu dhe disa persona të tjerë, të cilët për arsye të ndryshme nuk kishin mundur të migronin.

Një grup që përbëhej nga krerët e idhujtarëve, organizuan një mbledhje për të diskutuar mbi situatën e migrimit të muslimanëve në Medine dhe për të përcaktuar qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Hz. Pejgamberit. Migrimi i muslimanëve në Medine i kishte shqetësuar tej mase kurejshitët. Kjo sepse migrimi në Medine mund të bënte që kjo e fundit të shndërrohej në një qendër të fuqishme. Në këtë mbledhje, ku u parashtruan qasje të ndryshme, më shumë u ndalën mbi faktin nëse këto qasje ishin strategjike: në rast se Hz. Muhammedi do të syrgjynosej dhe do të nxirrej nga qyteti, në vendin ku do të shkonte, do të mblidhte përkrahës, gjë që do t'i linte mekasit në situatë të vështirë. Më në fund u pranua sugjerimi i Ebu Xhehilit. Sipas propozimit të tij, një grup të rinjsh, ku secili prej tyre t'i përkiste nga një fisi, do të sulmonin njëkohësisht me shpatat e tyre të dërguarin e Allahut, kështu nuk do të kishte më pas çështje gjakmarrjeje.

Vendimin e komplotit të marrë në këtë mbledhje e kishte dëgjuar Rakika, njëra prej hallave të Hz. Pejgamberit, e cila edhe e informoi për situatën. Pejgamberi (s.a.s.) vajti pa humbur kohë te Ebubekri, të cilin e informoi për sa kishte dëgjuar në lidhje me komplotin dhe i bëri të ditur vendimin që kishte marrë për të braktisur qytetin. Hz. Ebubekri ishte i gatshëm për një situatë të tillë. Kështu ranë dakord që në një orë të vonë të natës, të fshiheshin bashkë në një shpellë në malin Theur, e cila ndodhej në një lartësi të konsiderueshme jashtë qytetit dhe më pas të niseshin për atje. Ebubekri ra në ujdi edhe me udhërrëfyesin, bariun e deveve, idhujtarin Abdullah b. Urajkit, që ky t'u printe atyre në udhë dhe më pas përgatiti gjithçka që i duhej për rrugën që do të ndërmerrnin.

Është radha juaj

Rendisni shkaqet që përgatitën migrimin e muslimanëve në Medine.

Udhëtimi i Medines

Me qëllim që mekasit të mendonin se Hz. Pejgamberi po flinte, ai shtriu në krevatin e tij Hz. Aliun, ndërsa vetë u largua fshehurazi dhe vajti te Ebubekri. Në mesnatë shkuan të dy në shpellën Theur, e cila gjendej pesë kilometra në jugperëndim të Mekës. Orientimi për drejt jugut, edhe pse Medina gjendej në veri, ishte një strategji që u ndoq për të shmangur dyshimet. Në shpellë qëndruan për tri ditë e tri net.

Nga ana tjetër, kurejshitët, kur panë në mëngjes Hz. Aliun të shtrirë në krevatin e Hz. Muhammedit, u habitën, por edhe u zemëruan. Filluan ta kërkonin atë në çdo anë, madje premtuan edhe njëqind deve ndaj atij që e gjente. Kërkimet u bënë të detajuara në Mekë dhe në rrethinat e saj. Një grup ndër ta erdhi deri para shpellës ku qe fshehur bashkë me Hz. Ebubekrin. Hz. Ebubekri u shqetësua nga kjo situatë, por Pejgamberi (s.a.s.) i tha: "Mos u mërzit! Allahu është me ne" *(Teube, 9/40)*.

Kur'ani na e paraqet kështu shqetësimin e Hz. Ebubekrit dhe faktin se Allahu i ndihmoi ata në këtë situatë të vështirë:

"Nëse ju nuk e ndihmoni (Muhammedin s.a.s.), Allahu tashmë e ka ndihmuar atë ditën kur e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebubekrit): 'Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!' Atëherë, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (melekësh) dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara...'" *(Teube, 9/40)*.

Në shpellë qëndruan për tri ditë e tri net rresht, deri kur kërkimet filluan të ndalonin. Në fund të ditës së tretë, erdhën në shpellë çobani i Hz. Ebubekrit, Amir b. Fuhejre dhe udhërrëfyesi, çobani i deveve Abdullah b. Urajkit, bashkë me dy deve. Kështu, karvani i vogël i përbërë prej katër personash u nis drejt Medines. Ndërsa shkonin në Medine nuk zgjodhën rrugën kryesore, por ndoqën rrugët e thepisura dhe ato dytësore, por edhe duke kaluar herë pas herë nga rruga kryesore.

Mesxhidi i parë

Ditën e dymbëdhjetë të muajit Rebiuleuuel (24 shtator 622), Pejgamberi (s.a.s.) dhe ata që ishin me të arritën në Kuba, në buzë të luginës së Medines, e cila gjendej tre milje larg Medines. Ata u përballën me brohoritje nga një bashkësi medinase që i priste. Për rreth katër ditë qëndruan si mysafirë në fshatin Kuba, në shtëpinë e njërit prej kryetarëve të fisit Amr b. Auf, Kulthum b. Hidmit. Në këtë periudhë kohore, në një formë tejet të thjeshtë, u ndërtua mesxhidi i parë, i cili u bë i famshëm me emrin Mesxhidi Kuba. Ndërkohë, aty arriti edhe Hz. Aliu, i cili pati mbetur në Mekë.

Xhumaja e parë dhe hutbeja e parë

Pejgamberi ynë i dashur dhe ata që ishin me të, pasi qëndruan për katër ditë në Kuba, një ditë të premte u nisën drejt Medines. Namazi i parë i xhumasë u fal në luginën Ranuna dhe u këndua hutbeja e parë:

> "O njerëz...
>
> Para së gjithash mendoni nefsin tuaj: duhet ta dini që, në rast se njëri prej jush vdes, e lë pa çoban tufën që ka lënë pas dhe kur përballet me Zotin, i cili nuk ka nevojë për asnjë mjet e për asnjë përkthyes, kur Allahu e pyet: 'A nuk të erdhi ty i Dërguari që të nisa? A nuk të dhashë pasuri? Atëherë ç'më solle mua?', ai burrë kthen kokën në të majtë, e kthen në të djathtë, por nuk arrin të shohë askënd (që do ta shpëtojë) dhe përpara tij shfaqet xhehennemi. Pra, kushdo që prej jush dëshiron ta ruajë veten (nga zjarri), qoftë edhe me një kokërr hurmë, le ta japë atë. Ndërsa ata që nuk kanë asgjë për të dhënë, të thonë një fjalë me ëmbëlsi dhe me mirësi; sepse një mirësi nga Allahu, shpërblehet me dhjetë deri në njëqindfish nga vlera që ka. Paqja e Allahut qoftë mbi ju!" *(Ibn Hisham, II, 107-108; Hamidullah, po aty, I, 190)*.

Pas namazit vazhduan drejt Medines.

Është radha juaj

Cilat janë parimet themelore që theksohen në hutben e parë?

Pasqyrimet shoqërore, kulturore dhe historike të migrimit

Migrimi i muslimanëve nga Meka në Medine është njëra prej pikëkthesave të historisë së Islamit dhe të të gjithë njerëzimit.

Bashkë me migrimin, muslimanët kishin shpëtuar nga presionet e torturat dhe kishin filluar të jetonin në një shoqëri më të pavarur dhe më të lirë. Bashkësia muslimane, e përballur me pengesa në realizimin e synimeve të tyre, duke sakrifikuar çdo gjë që kishin, u orientuan drejt metodës së rrjedhës së historisë dhe arritën sukses.

Në jetën e Hz. Pejgamberit migrimi u shndërrua në një etapë të re e të rëndësishme, që mundësoi përhapjen e thirrjes ndaj të gjithë njerëzimit.

Migrimi, i cili ishte shprehja e një periudhe të re nga muslimanët, edhe në periudhën e Hz. Omerit u pranua si fillimi i historisë (17/638).

Është radha juaj

Diskutoni mbi arsyet se përse migrimi u vlerësua aq i rëndësishëm më pas, sa të merrej si filli i kalendarit hënor?

Përmbledhja e kapitullit

Koncepti i vahjit ka kuptimin e frymëzimit dhe futjes së të vërtetës në zemër, të shenjës së ardhur me shpejtësi, si dhe të informimit në një mënyrë shumë të fshehtë, në vend të informimit haptazi. Vahji nënkupton përcjelljen e lajmeve nga Allahu te pejgamberët.

Pejgamberi ynë e mori shpalljen e parë hyjnore në muajin Ramazan, në shpellën Hira, kur ishte rreth 40 vjeç.

Hz. Pejgamberi e filloi detyrën e thirrjes fillimisht duke organizuar fshehurazi thirrje individuale. Ftesat individuale i nisi së pari ndaj pjesëtarëve të familjes së tij, me të cilët jetonte. Në këtë etapë, thirrjes fetare i besuan dhe iu përgjigjën pozitivisht bashkëshortja e tij, Hz. Hatixheja, djali i xhaxhait të tij, Hz. Aliu dhe Zejdi. Në vijim, kësaj ftese iu përgjigj miku i tij i afërt, shoku Hz. Ebubekri.

Pas një farë kohe, Pejgamberi ynë i dashur u ngarkua me detyrë që t'i drejtonte thirrjet në formë të hapur ndaj shoqërisë, jo fshehurazi. Në këtë proces ku hyri Hz. Muhammedi, bëri përpjekje për ta përhapur në të gjithë shoqërinë thirrjen hyjnore që kishte marrë nga Allahu. Ai i ftonte që të rregullonin besimin e Allahut, i cili atë periudhë ishte prishur, të bënin ftesë te një Allah i vetëm, të mos i bënin ortak Atij, të largoheshin nga idhujtaria, të frikësoheshin prej Tij, t'i bënin adhurim vetëm Atij dhe të kishin si tipar dallues dhe të karakterizoheshin nga morali i bukur.

Pasi Pejgamberi filloi të ftonte hapur në Islam, idhujtarët e panë si kërcënim serioz dhe e shtuan edhe më shumë armiqësinë që kishin ndaj tij. Filluan të provojnë çdo rrugë për të penguar ftesën e tij: talleshin me të dhe me muslimanët. I torturonin ato, madje disa prej tyre edhe i vrisnin. Sidomos skllevërit dhe muslimanët e privuar nga mbrojtja ishin pre e hapur ndaj torturës, gjë që njerëzit e ndiqnin me frikë dhe shqetësim.

Që nga çasti kur Pejgamberi i fundit filloi t'i përcjellë shoqërisë shpalljet hyjnore që kishte marrë nga Allahu, u gjend përballë shumë akuzave. Ndër pretendimet dhe shpifjet kryesore që ishin lëshuar ndaj tij, ishte edhe fakti që e konsideronin si të çmendur. Ndërsa të tjerë pretendonin se ai ishte falltar, magjistar dhe poet.

Fakti që në Mekë vijonin torturat dhe presioni social, e kishin orientuar atë drejt kërkimeve të tjera. Besimtarët i këshilloi si në vijim: "Nëse dëshironi dhe mund t'ia arrini, strehohuni në Etiopi! Sepse në krye të atij vendi është një sovran që nuk ka treguar mizori ndaj askujt në shtetin e tij; ai vend atje është vendi i drejtësisë, qëndroni atje deri sa Allahu të falë një lehtësi në punët tona." Pas kësaj këshille, një grup prej muslimanëve emigroi në Etiopi.

Ndërkohë, bojkotimi që po zbatonin mekasit ndaj fisit Hashim, pjesë e të cilit ishte edhe familja e Hz. Pejgamberit, po vazhdonte me të gjitha mënyrat. Pak kohë pasi përfundoi bojkotimi i mekasve ndaj fisit Hashim, i cili filloi në vitin 616 dhe zgjati deri në vitin 619, Hz. Pejgamberi humbi xhaxhanë e tij, Ebu Talibin, të cilin e pati si mbrojtës dhe i pati qëndruar pranë në çdo rrethanë. Po ashtu, humbi edhe bashkëshorten e tij, Hz. Hatixhenë, të cilën e donte shumë dhe me të cilën ndante çdo gjë. Këto dy vdekje ndodhën në një periudhë të shkurtër kohore dhe e pikëlluan shumë atë. Viti kur ndodhën këto dy vdekje, në historinë islame përmendet si "Viti i pikëllimit".

Në njërën prej këtyre ditëve të vështira dhe problematike, në darkë, Allahu e çoi atë nga Mesxhidi Haram në Mesxhidin Aksa. Ky udhëtim nate emërohet si "Isra"; edhe emri i sures që flet për këtë ngjarje në Kur'an është "Isra". Ashtu siç gjendet në literaturën tonë, këtë natë ndodhi në të njëjtën kohë edhe ngjarja e lartësimit të Hz. Pejgamberit në qiell dhe u përcaktuan si farz pesë kohë namaz në Miraxh. Ngjarja Isra është një përvojë shumë e veçantë që ka përjetuar Pejgamberi. Me sa duket, Allahu, duke bërë që Hz. Muhammedi të përjetojë një përvojë të tillë në çastet e vështira, e ka shpëtuar atë nga rënia dhe shkatërrimi moral.

Hz. Pejgamberi e vijonte detyrën e shpalljes nën kushte shumë të vështira. Në vitin 11 të profetësisë filloi të shëtisë mes grupeve dhe karvanëve të huaja që vinin në Mekë për t'u takuar me haxhinjtë. Në vitin 620, në periudhën e haxhit, ndërsa vijonte përpjekjet për të përhapur Islamin, në vendin e quajtur Akabe u takua me gjashtë persona, të cilët i përkisnin fisit Hazrexh. I ftoi ata të bëheshin muslimanë, pasi u tregoi mbi Islamin. Ata e pranuan thirrjen.

Muslimanët medinas arritën në konsensus që, vitin e ardhshëm, gjatë periudhës dhe stinës së haxhit, të takoheshin me Pejgamberin në një orë nate në Akabe. Një vendim i rëndësishëm i marrë nga këto bisedime të bëra ishte edhe çështja e "migrimit në Medine të muslimanëve me pozitë të vështirë në Mekë". Në bazë të kësaj marrëveshjeje, që mori emrin "Besëlidhja e Dytë e Akabesë", u mor vendimi për hixhretin në Medine. Edhe pse Kurejshi kishte dëgjuar diçka në lidhje me këto bisedime, të cilat dukeshin si armiqësore ndaj tyre, nuk arritën ta konfirmonin këtë.

Pas kësaj marrëveshjeje që u arrit me medinasit në Akabe, në muajin Dhilhixh-xhe të vitit 622 dhe në të cilën u mor vendimi që muslimanët mekas të bënin hixhret për në Medine, muslimanët filluan të niseshin në grupe të vogla drejt Medines. Për një kohë të shkurtër në Mekë nuk mbeti asnjë musliman, përveç Hz. Pejgamberit, Hz. Ebubekrit dhe familjeve të këtyre; si dhe Hz. Aliut dhe disa muslimanëve, të cilët, për arsye të ndryshme, nuk kishin gjetur mundësinë e migrimit.

Pas kësaj situate, një grup i përbërë nga krerët e idhujtarëve, organizuan një mbledhje për të diskutuar mbi situatën e migrimit të muslimanëve në Medine dhe për të përcaktuar qëndrimin që duhet të mbahej kundrejt Hz. Pejgamberit. Vendimin e komplotit të marrë në këtë mbledhje e kishte dëgjuar Rakika, njëra prej hallave të Hz. Pejgamberit, e cila e njoftoi atë për situatën. Pejgamberi (s.a.s.), pa humbur kohë, vajti te Ebubekri dhe pasi i tregoi për ç'kishte dëgjuar në lidhje me komplotin, i bëri të ditur vendimin që kishte marrë mbi çështjen e braktisjes së qytetit. Hz. Ebubekri ishte i gatshëm për një situatë të tillë dhe mori masat parapërgatitore për këtë udhëtim.

Mali Theur

Me qëllim që mekasit të mendonin sikur Hz. Pejgamberi po flinte, ai shtriu Hz. Aliun në krevatin e tij, ndërsa vetë u largua fshehurazi dhe vajti te Ebubekri. Në mesnatë shkuan të dy në shpellën Theur, e cila gjendej pesë kilometra në jugperëndim të Mekës. Orientimi për drejt jugut, edhe pse Medina gjendej në veri, ishte një strategji që u ndoq për të shmangur dyshimet. Në shpellë qëndruan për tri ditë e tri net.

Nga ana tjetër, kurejshitët, kur panë në mëngjes Hz. Aliun të shtrirë në krevatin e Hz. Muhammedit, u habitën, por edhe u zemëruan. Filluan ta kërkonin atë në çdo anë, madje premtuan edhe njëqind deve ndaj atij që e gjente. Kërkimet u bënë të detajuara në Mekë dhe në rrethinat e saj. Një grup ndër ta erdhi deri para shpellës ku qe fshehur bashkë me Hz. Ebubekrin. Hz. Ebubekri u shqetësua nga kjo situatë, por Pejgamberi (s.a.s.) i tha: "Mos u mërzit! Allahu është me ne" *(Teube, 9/40)*.

Në ditën e dymbëdhjetë të muajit Rebiuleuuel (24 shtator 622), Pejgamberi (s.a.s.) dhe ata që ishin bashkë me të, patën arritur në Kuba, në buzë të luginës së Medines, e cila gjendej tri milje larg Medines. Ata u përballën me entuziazëm nga një bashkësi medinase që po i priste. Për rreth katër ditë qëndruan si mysafirë në fshatin Kuba. Në këtë periudhë kohore, në një formë tejet të thjeshtë, u ndërtua mesxhidi i parë që fitoi famë, me emrin Mesxhidi Kuba. Ndërkohë, edhe Hz. Aliu që kishte mbetur në Mekë, arriti atje. Pasi qëndruan për katër ditë në Kuba, ditën e premte u nisën për në Medine. Pejgamberi ynë priu namazin e parë të xhumasë ndaj shokëve të tij në luginën Ranuna dhe këndoi hutbenë e parë. Pas namazit vazhduan udhëtimin për në Medine dhe pas një kohe arritën në Medine, ku u pritën me brohoritje nga medinasit.

Hixhreti i muslimanëve nga Meka në Medine është njëra prej pikëkthesave më të rëndësishme të historisë islame. Bashkë me hixhretin, muslimanët kishin shpëtuar nga presioni dhe tortura, kishin filluar të jetonin në një shoqëri, në të cilën ishin më të pavarur dhe më të lirë. Bashkësia muslimane, e cila hasi në pengesa gjatë realizimit të objektivave të saj, ndërmori nisma për të rishkruar historinë e vet dhe ia doli me sukses.

Në jetën e Pejgamberit të fundit të dërguar ndaj njerëzimit, hixhreti përbënte një etapë krejt të re dhe kështu u bë një element i rëndësishëm që mundësoi përhapjen e thirrjes në të gjithë njerëzimin.

Hixhreti, i cili nënkuptonte fillimin e një periudhe të re, është pranuar si fillimi i historisë në periudhën e Hz. Omerit (17/638).

Të rishikojmë kapitullin

1. Me çfarë vështirësish u përball Pejgamberi ynë në vitet e para të profetësisë?
2. Çfarë kundërshtimesh shprehën ata që nuk donin të besonin Hz. Pejgamberin dhe si është treguar kjo situatë në Kur'an?
3. Cilët janë muslimanët e parë që i besuan Hz. Pejgamberit?
4. Ç'lloj torturash dhe presionesh janë ushtruar mbi muslimanët e parë që besuan te Hz. Pejgamberi dhe ç'qëndrim mbajtën muslimanët kundrejt tyre?
5. Në ç'kushte është realizuar hixhreti?
6. Çfarë shpreh hixhreti për muslimanët?

Pyetje vlerësuese

1. Cili është emri i shpellës ku Hz. Pejgamberi mori shpalljen e parë hyjnore?

A) Hira
B) Ranuna
C) Ebua
D) Theur

2. Cili është kuptimi i shprehjes "Fetreti Vahj"?

A) Vendi ku erdhi shpallja hyjnore
B) Shpallja e parë hyjnore
C) Ndërprerja e shpalljes hyjnore
D) Meleku i shpalljes

3. Në cilën sure gjenden ajetet e para që nisnin shpalljen hyjnore të Hz. Pejgamberit?

A) Alak
B) Mudeth-thir
C) Kalem
D) Fatiha

4. Cili është kuptimi i emrit "Daru'l-Erkam"?

A) Shtëpia e Erkamit
B) Fisi Erkam
C) Sahabiu i quajtur Erkam
D) Mesxhidi i parë

5. Cilën prej veçorive të mëposhtme i kishin ngarkuar idhujtarët Hz. Muhammedit kur e kundërshtonin atë?

A) Poet
B) Falltar
C) Magjistar
D) Të gjitha

6. Drejt cilit vend është realizuar emigrimi i parë?

A) Medine
B) Taif
C) Etiopi
D) Iran

7. Cili prej të mëposhtëmve është xhaxhai i Hz. Pejgamberit që e mbrojti për sa kohë ishte në jetë?

A) Ebu Leheb

B) Zubejir

C) Abdulmuttalib

D) Ebu Talib

8. Ç'është "Viti i pikëllimit"?

A) Viti kur u realizua migrimi

B) Viti ku u realizua lufta me idhujtarët

C) Viti kur Hz. Muhammedi humbi gjyshin e tij

D) Viti kur Hz. Hatixheja dhe Ebu Talibi ndërruan jetë

9. Drejt cilit vend u realizua ngjarja "Isra" (Udhëtimi i Natës)?

A) Mesxhidi Aksa

B) Mesxhidi Haram

C) Taif

D) Etiopi

10. Kush ishte me Hz. Pejgamberin, ndërsa ky po migronte në Medine?

A) Hz. Aliu

B) Hz. Osmani

C) Hz. Ebubekiri

D) Hz. Omeri

KAPITULLI 3

Profetësia: Periudha e Medines:

1. Veprimtaritë e para të Pejgamberit në Medine
2. Marrëdhëniet me idhujtarët
3. Marrëdhëniet me hebrenjtë
4. Marrëdhëniet me të krishterët
5. Çlirimi i Mekës
6. Delegatët e thirrjes universale
7. Haxhi i Lamtumirës, Hutbeja e Lamtumirës dhe mesazhet universale
8. Vdekja e Hz. Pejgamberit

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Në këtë kapitull trajtohen rrethanat, në të cilat u gjend Pejgamberi ynë pas migrimit në Medine.

Në kapitull tregohet situata në Medine para hixhretit, trajtohen veprimtaritë e realizuara pas ardhjes së Pejgamberit në Medine dhe sanksionet që u vendosën në këtë kohë.
Po ashtu, trajtohen luftërat me idhujtarët dhe Marrëveshja e Hudejbijes. Pas trajtimit të çështjeve në lidhje me marrëdhëniet e hebrenjve me të krishterët, është marrë në shqyrtim Çlirimi i Mekës, që përshpejtoi procesin e përhapjes së Islamit dhe që u bë pikë kthese në historinë islame.
Krahas çlirimit të Mekës në vitin 8/630, pranimit të Islamit nga fisi i fuqishëm, Hevazin, hyrjes së Arabisë Veriore nën sovranitetin e muslimanëve dhe fushatës luftarake të Tebukut në vitin e 9 hixhri, filluan të vinin edhe delegacione në Medine nga çdo zonë e Arabisë. Duke qenë se viti i 9 hixhri është shumë i ngarkuar sa i përket ardhjes së delegacioneve, ky vit është quajtur si Senetu'l-Vufud (Viti i delegacioneve). Në kapitull trajtohen disa prej këtyre çështjeve.
Ndërsa çështjet e fundit që trajtohen në këtë kapitull lidhen me detyrat e haxhit të realizuara nga Pejgamberi ynë dhe me vdekjen e tij. Haxhi që realizoi Hz. Pejgamberi (s.a.s.) në vitin e dhjetë të hixhretit (m. 632), ka marrë emrin Haxhi i Lamtumirës, ngaqë këtu përshëndetet me shokët e tij dhe ngaqë nuk e vizitoi më Qabenë. Këtu ai ka drejtuar hutbenë më të rëndësishme (Hutbeja e Lamtumirës) të thirrjes së fesë islame. Pasi përfundoi detyrën e haxhit u kthye në Medine, më 10/26 mars 632. Nuk kaloi shumë kohë dhe u sëmur, ku edhe ndërroi jetë.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të përfundoni këtë kapitull:

1. Do të mësoni se si muslimanët medinas e pritën me dashuri dhe entuziazëm Hz. Pejgamberin.
2. Do të mësoni se Mesxhidi i Pejgamberit, krahas themelimit për adhurim, është themeluar e ndërtuar edhe për të plotësuar funksione socio-kulturore, të tilla si mësimdhënia dhe mësimnxënia.
3. Do të mësoni mbi rëndësinë e shpalljes së vëllazërimit ndërmjet muslimanëve mekas dhe atyre medinas, me qëllim që të shtohej dashuria dhe solidariteti mes tyre.
4. Në haxhin e Hz. Pejgamberit dhe në hutbenë që drejtoi gjatë haxhit do të zbuloni vlera të tilla si: humanizmi, barazia, drejtësia dhe vëllazëria.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Mendoni vazhdimisht nëse keni arritur apo jo synimet e përmendura në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni temat që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Mos u mjaftoni vetëm me këtë libër për të mësuar. Në fund të librit paraqitet një listë e pasur me literaturë. Analizoni burimet që mund të arrini nga kjo listë.
3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe bartini ato në mjediset mësimore.
4. Gjatë trajtimit të haxhit dëgjoni eksperiencat personale të personave që kanë plotësuar këtë detyrë.

1 Veprimtaritë e para të Pejgamberit në Medine

Situata në Medine para hixhretit dhe pritja e Pejgamberit (s.a.s.) me entuziazëm e hare

Medinja, emri i vjetër i së cilës ishte Jethrib, ka qenë njëri prej qyteteve më të rëndësishme të zonës së Hixhazit. Populli vendës i këtushëm përbëhej nga fiset hebreje Beni Kurajdha, Beni Kajnuka dhe Beni Nadir, si dhe nga fiset arabe Eus dhe Hazrexh, të cilat erdhën nga Arabia jugore dhe u vendosën aty.

Kur fiset Eus dhe Hazrexh erdhën në Jethrib, fillimisht jetuan si të nënshtruar ndaj fiseve hebreje, të cilat qenë vendosur aty më përpara. Fiset Eus dhe Hazrexh u bënë pre e presioneve të hebrenjve dhe kërkuan ndihmë nga gassanitët, të cilët ishin të afërmit e tyre. Me kalimin e kohës ata mundën të merrnin epërsinë në Jethrib. Por, pak kohë më vonë, edhe ndërmjet fiseve Eus dhe Hazrexh filluan të shfaqen konflikte, madje u bënë edhe luftëra ndërmjet tyre. Lufta Buath ishte njëra prej këtyre. Konflikti filloi pasi njëri prej fisit Eus vrau dikë që ishte strehuar te Hazrexhi. Lufta përfundoi me fitoren e fisit Eus. Kjo luftë ishte realizuar pesë vjet para hixhretit të Hz. Pejgamberit në Medine. Si rezultat i Besëlidhjeve të Akabesë që arabët medinas arritën me Hz. Pejgamberin, në Medine u shtua numri i muslimanëve dhe bashkë me vendimin e hixhretit, muslimanët filluan të shpërnguleshin në grupe drejt Medines. Në etapën e fundit Pejgamberi (s.a.s.) ishte nisur për udhëtim drejt hixhretit.

Medinasit u informuan se ai qe larguar nga Meka dhe se qe nisur drejt qytetit të tyre. Çdo ditë dilnin nga shtëpia, ngjiteshin mbi një kodër të lartë dhe vëzhgonin rrugët që vinin nga Meka, në pritje të Hz. Pejgamberit. Kodra ku ngjiteshin quhej Senijjetu'l-Ueda. Pasi pritën për një kohë të gjatë, nisën të shpërndaheshin, por në këtë çast morën lajmin se qe dukur Hz. Pejgamberi. U kthyen pas. Muslimanët ishin mjaft të hareshëm dhe të gëzuar dhe po këndonin vargjet:

"Mbi ne lindi hëna e plotë, që lartësohet nga Senijjetu'l-Ueda.

Mbi ne u bë farz mirënjohja dhe falënderimet, për sa kohë ftohemi drejt Allahut.

O i Dërguar, që Allahu të dërgoi te ne,

Na përçove një urdhër hyjnor, ndaj të cilit do të bindemi plotësisht."

Fëmijët dhe gratë i këndonin këto këngë duke u rënë dajreve. Kishte një gëzim të madh te njerëzit dhe çdonjëri prej tyre e ftonte të Dërguarin e Allahut që të bëhej mysafir në shtëpinë e tij. Ndërsa Pejgamberi urdhëroi: "Lëreni të lirë devenë, ajo është e ngarkuar me këtë punë." Deveja vajti dhe u ul në një truall që u përkiste dy jetimëve. Ebu Ejjub el-Ensariu, pronari i shtëpisë më të afërt me vendin ku deveja ishte ulur, mori sendet e Pejgamberit (s.a.s.), vajti në shtëpinë e tij dhe e mbajti atë si mysafir për rreth shtatë muaj, deri sa u plotësua ndërtimi i mesxhidit.

Është radha juaj

Sipas jush, a ka ndonjë lidhje ndërmjet entuziazmit me të cilin u prit Hz. Pejgamberi në Medine dhe nivelit kulturor të qytetit të Medines?

Ndërtimi i mesxhidit të Pejgamberit dhe funksioni shoqëror i tij

Në Medine qe marrë vendimi për ndërtimin e mesxhidit. Ashtu siç citohet më lart, Hz. Pejgamberi u ishte përgjigjur mjaft mirë këmbënguljeve për ta pasur atë mysafir, kur e kishte lënë këtë në dorë të devesë: "Lëreni devenë të ecë e lirë, ajo do të na çojë në një vend, me të cilin Allahu është i kënaqur". Edhe pse dy vëllezërit jetimë, të cilët ishin pronarët e vendit, deshën ta jepnin truallin pa pagesë, Pejgamberi ynë nuk e kishte pranuar këtë. Trualli u ble nga Hz. Ebubekri dhe menjëherë filloi ndërtimi i mesxhidit.

A e dini?

Në ndërtimin e mesxhidit, krahas muslimanëve të tjerë, ka punuar si punëtor edhe Hz. Pejgamberi.

Në dyshemenë e mesxhidit u përdor rërë, ndërsa në muret e tij qerpiç. Shtyllat u vendosën prej druri hurme, ndërsa çatia e mesxhidit mbulohej me degët dhe gjethet e hurmave. Mesxhidi kishte një mihrab, kibla e të cilit qe drejtuar fillimisht për nga Kudusi; po ashtu, kishte edhe tri porta, njëra nga lindja, njëra nga jugu dhe tjetra nga perëndimi. Gjatë gjithë murit jugor gjendej një tendë dhe vend-hijeje i quajtur Suffe. Gjatë ditës Suffeja përdorej si shkollë, ndërsa gjatë netëve si një vend ku mund të qëndronin të pastrehët, beqarët dhe studentët e dijes, të cilët kishin migruar në Medine. Ata që qëndronin këtu quheshin njerëzit e Suffesë ose sahabet e Suffesë. Sahabet e Suffesë në përgjithësi ishin persona të varfër. Pejgamberi (s.a.s.) interesohej konkretisht për nevojat e tyre dhe i orientonte muslimanët pikërisht tek ata.

Pasi kibla qe drejtuar për nga Kudusi dhe u kthye në Qabe, u mbyll porta në jug dhe u hap një portë në drejtim të veriut. Në këto kushte, Suffeja u kalua nga jugu në veri.

Lartësia e mesxhidit ishte pak më shumë se gjatësia e njeriut. Kur përfundoi ndërtimi i kësaj strukture, që u njoh si Mesxhidi Nebeui (Mesxhidi i Pejgamberit), Pejgamberi ynë u largua nga shtëpia e Ebu Ejjubit, tek i cili kishte qëndruar si mysafir dhe u transferua në dhomat që qenë ndërtuar për pjesëtarët e familjes, të cilat ishin menjëherë ngjitur me mesxhidin.

Mesxhidi i Pejgamberit kishte disa funksione. Njëri prej tyre ishte të përdorej si vend adhurimi. Ky ishte një vend ku muslimanët mblidheshin për të falur namazet e kohëve dhe namazet e xhumasë. Njëkohësisht ishte një vend shumëdimensional, ku Hz. Pejgamberi ushtronte detyrën e shpalljes hyjnore, ku realizoheshin aktivitetet mësimdhënëse-mësimnxënëse, ku merreshin vendime të rëndësishme dhe ku pranoheshin delegatët.

Ndërsa me përfundimin e ndërtimit të mesxhidit, me qëllim që muslimanët të arrinin në mesxhid në kohët e namazeve, menduan mbi çështjen e lajmërimit dhe njoftimit të kohëve të namazit. Hz. Pejgamberi (s.a.s.) bisedoi me shokët e tij mbi këtë çështje. Abdullah b. Zejdi, që ishte ndër sahabet, i tregoi atij ëndrrën që kishte parë në lidhje me

dhënien e ezanit. Hz. Pejgamberi e miratoi atë, ia mësoi ezanin Bilal Habeshiut dhe, më në fund, ezani filloi të këndohej siç këndohet edhe sot sa i përket thirrjes në namaz. Për këndimin e ezanit u ndërtua një vend i posaçëm në mesxhidin e Pejgamberit.

Është radha juaj

Cilat veçori të Islamit tregon ndërtimi i Suffesë ngjitur me mesxhidin e Pejgamberit për nxënësit e dijes?

Shpallja e vëllazërimit ndërmjet muslimanëve

Pas rreth pesë muajsh nga mbërritja e Pejgamberit (s.a.s.) në Medine u organizua një mbledhje, në të cilën morën pjesë ata që erdhën nga Meka (Muhaxhirët) dhe kryetarët e familjeve medinase (Ensarët). Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte të jepeshin disa sugjerime konkrete në lidhje me jetesën e muslimanëve në paqe, të zbatoheshin këto sugjerime dhe të përshtateshin në aspektin material dhe shpirtëror në Medine. Hz. Pejgamberi i ftoi muslimanët e Mekës dhe të Medines në një bashkëpunim të sinqertë. I shpalli vëllezër muhaxhirët dhe ensarët.

Sipas marrëveshjes së arritur të vëllazërisë, të dyja palët do të punonin bashkërisht, do të ndanin fitimin e korrur, madje do të mund të ishin trashëgimtarë për njëri-tjetrin. Por, përmasa e lënies trashëgim te kjo vëllazëri u shfuqizua bashkë me ajetin Kur'anor që zbriti pas luftës së Bedrit: *"... ndonëse, sipas Librit të Allahut, besimtarët që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin (në ndarjen e trashëgimisë)."* (Enfal, 8/75) Palët e pritën pozitivisht këtë sugjerim. Shumë familje mekase dhe medinase u vëllazëruan në këtë mënyrë.

Kështu u lehtësuan vështirësitë materiale të mekasve që bënë hixhret për hir të besimit të tyre, duke lënë pas çdo gjë që kishin; u hodh edhe një hap domethënës në lidhje me vijimin e jetesës së tyre duke qenë në besim. Ensarët dhe muhaxhirët u forcuan më shumë si rezultat i vëllazërimit.

Sanksionet shoqërore dhe vendosja e paqes

Bashkë me hixhretin e Hz. Pejgamberit në Medine, struktura shoqërore e Medines u formësua si më poshtë:

1. Muhaxhirët: Muslimanët që migruan nga Meka në Medine.

2. Ensarët: Janë fiset Eus dhe Hazrexh, vendësit e Medines që pranuan Islamin.

3. Hebrenjtë: Fiset Beni Kajnuka, Beni Nadir dhe Beni Kurajdha, të cilat qenë vendosur në Medine.

4. Fiset arabe që ende nuk kishin pranuar Islamin.

Nëpërmjet vëllazërimit, Hz. Pejgamberi kishte forcuar unitetin mes muslimanëve, por dëshironte të arrinte në një konsensus edhe me hebrenjtë që jetonin në Medine dhe me arabët jomuslimanë, me qëllim që të mundësonte sigurinë e qytetit dhe të jetonte në

harmoni me ta. Për këtë arsye bisedoi si me shokët e tij, ashtu edhe me elementët e tjerë që nuk ishin muslimanë. Më në fund arritën në konsensus mbi strukturën qytet-shtet. Përgatitën një tekst, ku përfshiheshin parimet dhe kriteret që ripërpilonin shoqërinë e Medines. Ky tekst, i cili ishte një marrëveshje sociale, përfshinte marrëdhëniet e vendësve të qytetit me njëri-tjetrin dhe me të huajt, strukturat administrative dhe gjyqësore, lirinë fetare dhe ndërgjegjësore që zotëronin individët, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Krahas kësaj marrëveshjeje u parandalua ndihmesa që hebrenjtë mund të jepnin ndaj idhujtarëve të Mekës, si dhe u vendos që, në rast të ndonjë sulmi ndaj Medines, muslimanët dhe hebrenjtë do të vepronin bashkërisht. Me këtë marrëveshje u forcua edhe ekzistenca sociale dhe juridike e muslimanëve, u mundësua liria e besimit, siguria e jetës dhe e pasurisë. Kështu u vendos paqja shoqërore në Medine.

Është radha juaj

Cili është synimi themelor i aktiviteteve që kreu Hz. Pejgamberi mes muslimanëve dhe grupeve të tjera që jetonin në Medine?

2 Marrëdhëniet me idhujtarët

Luftërat e zhvilluara me idhujtarët

Bedir

Beteja e parë ndërmjet muslimanëve dhe idhujtarëve mekas u realizua në Bedir. Bediri gjendet rreth 160 km në jug-perëndim dhe 30 km larg bregut të Detit të Kuq. Qyteti i Medines ndodhet në pikën ku bashkohet rruga Meka-Medine me rrugën e karvanit që shkonte për në Siri. Puset e Bedrit atëherë përdoreshin për vendfurnizim të karvanëve.

Beteja e Bedrit u realizua si rezultat i qëndrimeve agresore të idhujtarëve të Mekës ndaj muslimanëve, pasi bënë hixhret në Medine. Presionet që u ushtruan në Mekë ndaj muslimanëve dhe ngjarje të tilla si përpjekja për vrasjen e Hz. Pejgamberit, i detyruan muslimanët të braktisin qytetin e tyre. Idhujtarët e Kurejshit nuk i linin të qetë muslimanët as në Medine dhe, me qëllim që të mos cenonin tregtinë dhe strukturën besimore që zotëronin, përpiqeshin të gjenin zgjidhje të ndryshme. Edhe muslimanët zhvillonin taktikat e veta për t'u ruajtur nga mekasit.

Ebu Sufjani u dërgoi një letër medinasve, nëpërmjet së cilës qortonte faktin pse kishin marrë nën mbrojtje Hz. Muhammedin. Me sa kuptohet, mekasit kishin marrë edhe disa masa parandaluese presioni ekonomik ndaj medinasve. Hz. Pejgamberi, duke qenë në

dijeni të të gjitha këtyre, ishte i vendosur për ta mbrojtur strukturën në Medine. Për këtë arsye, rreth një vit pas ardhjes në Medine, organizoi ndaj mekasve një fushatë ushtarake (serijje), për t'u bërë të ditur se tashmë karvanët tregtarë që i përkisnin Kurejshit nuk duhet të kalonin nga zonat autoritare të muslimanëve. Disa fushata ushtarake të këtij lloji u dërguan ndaj mekasve, madje pati edhe përleshje në përmasa të vogla.

Në vitin e dytë hixhri, kurejshitët dërguan në Siri një karvan të madh, nën drejtimin e Ebu Sufjanit. Pejgamberi (s.a.s.) ishte informuar për këto zhvillime. Duke biseduar me shokët e tij, tha se mund ta kapnin në Bedir karvanin, aty ku do të kalonte në kthim dhe u kërkoi që të përgatiteshin.

I Dërguari i Allahut, pasi mori lajmin e kthimit të karvanit, u nis nga Medina drejt Bedrit në datën 12 Ramazan 2/9 mars 624. Në Medine la si zëvendës Abdullah b. Ummu Mektumin. Në ushtrinë që përbëhej prej rreth 305 personash gjendeshin rreth 70 deve dhe kuaj. Ndërkohë, edhe Ebu Sufjani e kishte mësuar se Hz. Muhammedi ishte nisur nga qyteti i Medines. Ebu Sufjani kërkoi ndihmë duke dërguar në Mekë personin me emër Damdam b. Amr. Edhe ai, duke përzgjedhur rrugën e bregut, e cila përdorej pak, pa kaluar në Bedir, u orientua drejt Mekës, me qëllim që të shpëtonte karvanin nga pusia e ngritur.

Brenda një kohe të shkurtër mekasit u nisën drejt Bedirit me një ushtri prej rreth 1000 personash, nën drejtimin e Ebu Xhehlit. Në ushtri gjendeshin 100 kuaj dhe rreth 700 deve. Edhe pse Ebu Sufjani dërgoi një lajm ku i informonte se karvani kishte shpëtuar dhe se mekasit duhet të ktheheshin pas, Ebu Xhehili mori vendim të mos kthehen. Të dyja ushtritë erdhën në Bedir pa pasur informacione për njëra-tjetrën. Në Kur'an kjo çështje aludohet në këtë mënyrë:

"Kur ju ishit në bregun e afërt të luginës, ata ndodheshin në bregun e largët, ndërsa karvani poshtë jush. Edhe sikur t'i kishit lënë takim njëri-tjetrit, nuk do të ishit pajtuar për kohën e ndeshjes. Por Allahu e përmbushi atë ngjarje që ishte e caktuar, me qëllim që kush duhej të vdiste, të vdiste me prova të qarta dhe, kush duhej të mbetej gjallë, të jetonte me prova të qarta. Vërtet, Allahu i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë." *(Enfal, 8/42)*

Në mëngjesin e së premtes, më datë 17 Ramazan 2/14 mars 624, të dyja ushtritë u nisën për nga Bedri. Muslimanët arritën më parë në puset e Bedrit. Puset i mbyllën që të gjitha me rërë, përveç njërit. Pasi mbaroi me përgatitjet e luftës, Hz. Pejgamberi bëri dua si më poshtë:

"O Zoti im! Ja ku erdhi Kurejshi me mburrje e krenari, po të sfidon ty, përgënjeshtron edhe Pejgamberin tënd, o Zoti im! Kërkoj nga Ti që të plotësosh premtimin e dhënies së ndihmesës ndaj pejgamberëve, në veçanti premtimin që më ke dhënë mua për fitore. Allahu im! Nëse ti do të shkatërrosh këtë grusht muslimanësh, nuk do të ketë njeri që të të adhurojë." *(Ibnu'l-Esir, el-Kamil, II, 122-123)*

Lufta, sipas traditës arabe, filloi me mubareze (përleshje një më një, duel). Në orët në vijim u shndërrua në shesh-betejë. Lufta zgjati për 4-5 orë dhe rezultoi me fitoren e muslimanëve. Kurejshitët lanë 70 të vdekur. Rreth 70 kurejshitë u morën nga muslimanët. Ndërsa muslimanët lanë 14 dëshmorë.

Pavarësisht se mekasit ishin shumë të lartë në numër, pas fitores së luftës nga muslimanët brenda një kohe të shkurtër, krahas durimit, qëndrueshmërisë dhe taktikës së besimtarëve, qëndron ndihmesa e Allahut me anë të melekëve. Si rrjedhojë, në Kur'an kjo situatë shprehet kështu:

"Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, andaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues. Atëherë ti (Muhammed) u thoshe besimtarëve: 'A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë melekë të dërguar?"' *(Al-i Imran, 3/123-124)*

Pas luftës u mblodhën ganimetet dhe muslimanët u nisën drejt Medines bashkë me robërit. Hz. Pejgamberi kishte urdhëruar që të silleshin mirë me robërit, duke marrë nën mbrojtje sigurinë e jetës së tyre. Si rezultat i bisedimeve të bëra, robërit u lanë të lirë në këmbim të shpagimit, mirëpo u mor si vendim që robërit që dinin shkrim dhe lexim, por që nuk kishin mundësi të paguanin shpagimin, do të liheshin të lirë nëse u mësonin shkrim e lexim dhjetë fëmijëve muslimanë.

Lufta e Bedrit ishte fitorja e parë dhe madhështore që muslimanët fituan përballë mekasve. Kjo fitore i bëri më të fuqishëm ata.

Uhud

Idhujtarët mekas, pas humbjes që pësuan dhe pasi kishin lënë shumë të afërt në luftë, dëshironin të hakmerreshin me çdo kusht. Duke iu drejtuar Ebu Sufjanit, ata kërkuan që të ardhurat e fituara nga karvani të përdoreshin për luftë ndaj muslimanëve. Ebu Sufjani u shpreh se ndante të njëjtat ndjenja me ta dhe e pranoi sugjerimin e tyre. Idhujtarët mekas donin edhe të hakmerreshin për Bedirin, por edhe të mundësonin sigurinë e rrugës tregtare, e cila ishte shumë e rëndësishme për ta.

Idhujtarët mekas, për të shtuar më shumë fuqinë e tyre, filluan të mbledhin mercenarë, edhe nga fiset përreth Mekës. Më në fund, nën komandën e Ebu Sufjanit dhe me një ushtri të përbërë prej 3000 ushtarësh, 200 kuaj, 3000 deve dhe 700 persona të pajisur me mburojë, u nisën drejt Medines. Pasi Hz. Pejgamberi u informua se ushtria po vinte drejt Medines, mblodhi shokët për t'u konsultuar mbi strategjinë që duhej ndjekur. Një grup parashtroi mendimin se duhej të qëndronin brenda Medines dhe të merrnin masa mbrojtëse, ndërsa grupi tjetër sugjeroi ballafaqimin me armikun jashtë Medines. Hz. Pejgamberi anonte nga mendimi se duhet të qëndronin brenda Medines dhe të qëndronin në mbrojtje. Mirëpo të rinjtë që nuk kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit, si

dhe xhaxhai i Pejgamberit, Hz. Hamzai, ngulën këmbë që lufta të zhvillohej jashtë, në shesh-betejë.

Më në fund, në bazë të kërkesës së shumicës, u vendos të realizohej në shesh-betejë. Hz. Pejgamberi veshi mburojën, vendosi shpatën dhe vuri përkrenaren në kokë. Në Medine, në vend të tij la Abdullah b. Mektumin dhe u nis për udhëtim me një ushtri prej 1000 personash. Nuk pranoi në ushtri një njësi hebrenjsh prej 600 personash, të cilët deshën t'i bashkoheshin në rrugë. Edhe Abdullah b. Ubej u kthye pas bashkë me 300 përkrahësit e tij, duke thënë se ishte kundër shesh-betejës, dhe sepse, sipas tij, Muhammedi kishte dëgjuar fjalën e fëmijëve dhe nuk e kish respektuar fjalën e tyre. Mëngjesin e së shtunës, më 11 sheuual 3/25 janar 625, muslimanët arritën në malin Uhud, i cili gjendej një orë larg qytetit, në veri të Medines.

Muslimanët ishin pozicionuar në mënyrë të tillë që malin Uhud ta kishin nga pas. Hz. Muhammedi e kishte vendosur ushtrinë sipas rregullit të luftës dhe flamurin ia kishte dhënë Mus'ab b. Umejrit. Në krye të njësive me mburoja gjendej Zubejr b. Auuami, ndërsa Hz. Hamzai u përcaktua si komandant ndaj ushtarëve të tjerë. Me qëllim që të parandalonte sulmin e armikut nga pas, Hz. Pejgamberi pozicionoi në ngushticën Ajnejn rreth 50 shigjetarë, të cilët ishin nën komandën e Abdullah b. Xhubejrit, dhe i porositi që në asnjë rrethanë të mos largoheshin prej atje pa marrë urdhër nga vetë ai.

Kodra e Shigjetarëve

Muslimanët arritën t'i mposhtnin idhujtarët, por duke menduar se lufta ishte përfundimisht e fituar, ata filluan të mbledhin ganimete. Edhe shigjetarët e vendosur në ngushticën Ajnejn, duke menduar se lufta ishte fituar, pavarësisht urdhrit të prerë që kishin, i braktisën vendet e tyre. Halid b. Uelidi po priste pikërisht këtë mundësi dhe u hodh në veprim. Abdullah b. Xhubejri dhe 10 shokët e tij, të cilët nuk u larguan nga vendet e tyre, ranë dëshmorë gjatë përleshjes. Më pas, Halid b. Uelidi sulmoi muslimanët e angazhuar me mbledhjen e ganimetit. Edhe idhujtarët e tjerë që panë këtë situatë, u

kthyen pas dhe kaluan përsëri në mësymje. Muslimanët mbetën në pozitë të vështirë. Ndërkohë, Hz. Hamzai ra dëshmor nga Uahshi b. Harbi. Po ashtu, personi me emrin Ibn Kamie plagosi me shpatë Hz. Pejgamberin në fytyrë. Për shkak të goditjes, përkrenarja e Pejgamberit u nda më dysh dhe hallkat e saj iu ngulën në fytyrë. Ndërsa guri që iu hodh në fytyrë, i çau buzën e poshtme dhe iu thye një dhemb. Sikur të mos mjaftonte kjo, pati edhe një situatë tjetër, e cila u bë shkak për gjendje paniku mes muslimanëve. Kjo kishte të bënte me vrasjen e Mus'ab b. Umejrit nga Abdullah b. Kamie, të cilit i ngjasoi me Pejgamberin dhe bërtiti duke thënë: "E vrava Muhammedin!" Ky lajm i shqetësoi shumë muslimanët, por pasi u kuptua se lajmi nuk ishte i vërtetë, u vendos qetësia.

Bashkëshortja e Ebu Sufjanit, Hindi, e cila erdhi vetë në sheshin e luftës, urdhëroi skllavin e saj, Uahshiun, që t'i nxirrte mushkërinë Hz. Hamzait, të cilën pasi e mori në dorë, nisi ta përtypte me dhëmbë. Thuhet se pikërisht për këtë arsye, pavarësisht lidhjes së afërt që Pejgamberi kishte pasur me xhaxhanë e tij, Uahshiun, i cili më pas u bë musliman, e ka mbajtur sa më larg ka qenë e mundur, pasi nuk e shihte dot, për shkak se i kujtonte pikërisht këtë ngjarje.

Si përfundim, në këtë luftë që kaloi me shumë vështirësi, muslimanët dhanë 70 dëshmorë, ndërsa nga idhujtarët u vranë 23 persona.

Idhujtarët mekas nuk këmbëngulën më tej në luftë. Më në fund, Ebu Sufjani kaloi nëpër shesh-betejë dhe u largua edhe ai.

Edhe Hz. Pejgamberi, pasi varrosi dëshmorët, u kthye në Medine në të njëjtën ditë. Megjithatë, atë e brente dyshimi i kthimit pas të kurejshitëve, i cili nuk ishte krejt i qartë. Duke supozuar se ata ishin penduar dhe qenë kthyer përsëri pas, me një ushtri prej 500 personash, me qëllim që të ndiqnin kurejshitët, vajtën deri në Hamrau'l-Esed, një vend që gjendej 16 km larg Mekës dhe qëndruan atje për pesë ditë me radhë.

Gjatë netëve, për t'u dukur se janë të shumtë në numër, u ndezën mijëra zjarre. Ky udhëtim quhet fushata luftarake Hamrau'l-Esed.

Hendeku

Një tjetër luftë e realizuar ndërmjet muslimanëve dhe idhujtarëve është edhe ajo e Hendekut. Kjo luftë është emërtuar si Beteja e Hendekut për shkak të një hendeku me gjatësi prej 5 kilometrash që u hap jashtë qytetit, por ajo njihet edhe si lufta Ahzab, për shkak se në të u sulmuan muslimanët nga grupe të ndryshme të bashkuara.

Në ngjarjet e mëpastajme të Betejës së Hendekut ka luajtur një rol nxitja e idhujtarëve mekas nga hebrenjtë. Zhvillimi i ngjarjes ka ndodhur si më poshtë: pasi Pejgamberi (s.a.s.) migroi në Medine, u arrit marrëveshje me fiset hebrenje që ishin vendës këtu, sipas së cilës do të vepronin së bashku në mbrojtjen e qytetit dhe se nuk do të bashkëpunonin me idhujtarët. Fiset Beni Nadir dhe Beni Kajnuka nga fiset hebrenje, shumë shpejt e prishën këtë marrëveshje dhe bashkëpunuan me idhujtarët mekas. Po ashtu, ata bënë edhe një tentativë për komplot ndaj Pejgamberit (a.s.), gjë që i shkëputi krejtësisht lidhjet ndërmjet tyre, ndërsa fiset Beni Kajnuka dhe Beni Nadir u syrgjynosën nga qyteti i Medines. Një pjesë e hebrenjve që ishin syrgjynosur nga Medinja u vendosën në Hajber.

Krerët e hebrenjve të fisit Beni Nadir, të cilët dëshironin të krijonin një forcë të përbashkët përballë muslimanëve, vajtën në Mekë dhe u bënë thirrje idhujtarëve për luftë ndaj

muslimanëve. Ebu Sufjani e miratoi i gëzuar këtë përpjekje të tyre. Ky grup, në të njëjtën mënyrë veproi edhe kundrejt disa fiseve idhujtare, si: Gatafan, Sulejm, Esed, Fezare, Murre dhe Esh'xha.

Më në fund, hebrenjtë, idhujtarët dhe një pjesë e fiseve të tjera idhujtare arabe u bënë të gjithë bashkë kundër muslimanëve. Në Mekë dhe përreth saj ishte mbledhur një ushtri prej 4000 personash, të cilët bashkë me njësitë e ardhura nga zonat përreth, kur mbërritën në Mekë, kapnin shifrën prej dhjetë mijë personash.

Hz. Pejgamberi e mësoi situatën nëpërmjet lajmëtarëve që i kishte dërguar fisi Huzaa në rrethinë të Mekës, fis ky i cili ishte aleat me të. Pas kësaj mblodhi shokët dhe diskutoi me ta mbi taktikën e luftës që do të ndiqnin. Çështja ishte nëse do të qëndronin në mbrojtje brenda në Medine, apo do të dilnin jashtë saj dhe do të luftonin në shesh-betejë. Më në fund, ndryshe nga ç'kishte ndodhur me luftën e Uhudit, u mor vendimi që të kalohej në mbrojtje.

Selman Farisiu, sahabiu me origjinë iraniane, sugjeroi që të gërmohej një hendek i thellë dhe i gjerë në zonën veriore të Medines. Selman Farisiu u shpreh se në Iran gërmonin hendeqe rreth qyteteve, jo vetëm për të shmangur ndonjë sulm të orëve të natës nga armiqtë që kishin rrethuar qytetin, por edhe që kalorësit e forcave armike të mos e kalonin vijën mbrojtëse. Ky sugjerim mori mbështetje dhe menjëherë kaluan në veprim për të bërë atë që duhej. Mendohet se gjatësia e hendekut ishte 5.5 km, gjerësia 9 metra, ndërsa thellësia ishte rreth 4.5 metra.

Kur forcat armike erdhën në rrethinë të Medines, puna e gërmimit të hendekut qe përfunduar. Idhujtarët u habitën kur panë hendekun. Edhe pse disa persona ia kishin dalë ta tejkalonin hendekun, nuk arritën të tejkalojnë frontet mbrojtëse të muslimanëve, sepse muslimanët tregonin rezistencë të fortë në frontin e mbrojtjes. Rrethimi sa vinte e zgjaste. Idhujtarëve u ishin pakësuar ushqimet dhe kishin rënë në pozitë të vështirë. Si rezultat, te disa prej tyre lindi dëshira e kthimit pas, gjë që u bë shkas për krijimin e problemeve në frontin e tyre. Ndërkohë që po kërkonin mënyra për kapërcimin e hendekut dhe kalimin përballë, nga ana tjetër donin t'i linin muslimanët mes dy zjarreve, duke vënë në veprim hebrenjtë e fisit Beni Kurajdha. Hebreu Hujej b. Ahtab, i cili u bë shkak për rrethimin e Medines, vajti te Ka'b b. Esedi, kryetari i hebrenjve të fisit Beni Kurajdha dhe e ftoi atë të bashkohej me idhujtarët dhe t'i godiste ata nga pas.

Ka'b b. Esedi, fillimisht u shpreh se kishte një marrëveshje me Hz. Pejgamberin dhe e refuzoi këtë sugjerim, por në fund nuk u rezistoi dot këmbënguljeve dhe pranoi sugjerimin, duke grisur njëkohësisht tekstin e marrëveshjes që kishte me Hz. Pejgamberin. Nën këto kushte muslimanët mbetën në pozitë të vështirë. Hz. Pejgamberi e mori vesh se Beni Kurajdha e kishte prishur marrëveshjen dhe dërgoi te hebrenjtë e fisit Beni Kurajdha një grup, në të cilin gjendej edhe Sa'd b. Muadhi dhe Sa'd b. Ubade. Ky grup i ftoi ata të rinovojnë marrëveshjen e prishur, mirëpo ata e refuzuan këtë. Situata iu bë e ditur Hz. Pejgamberit, i cili pas kësaj filloi të marrë masa parandaluese për të mbrojtur muslimanët nga pjesëtarët e fisit Kurajdha.

Në vijim pati një zhvillim që u bë rreze shprese për muslimanët, të cilët gjendeshin në rrethana të vështira: kryetari i fisit Esh'xha, Nuajm b. Mes'ud, i cili gjendej në anën e idhujtarëve, pranoi Islamin dhe erdhi fshehurazi te Hz. Pejgamberi. I bëri të ditur atij se idhujtarët nuk ishin të informuar që ky e kishte pranuar Islamin dhe se mund t'i ndihmonte muslimanët. Hz. Pejgamberi kërkoi nga ai që të mos tregonte se ishte bërë musliman dhe pasi e urdhëroi: "Largohu nga ne, sepse lufta është dredhi!" *(Ibnu'l-Esir, el-Kamil, II, 182)*, e nisi duke i dhënë disa këshilla. Nuajmi vajti te Beni Kurajdha dhe u tha: "Nëse Kurejshi kthehet në Mekë për çfarëdolloj arsye, muslimanët do ta dënojnë shumë rëndë Beni Kurajdhan." Përveç kësaj, për të qenë i sigurt se Kurejshi nuk do ta linte të vetëm ata përballë muslimanëve, i këshilloi ata që të mbajnë peng njërin prej krerëve të Kurejshit. Nuajmi, menjëherë pas kësaj vajti te Kurejshi, të cilëve u tha se Beni Kurajdha kishte bërë marrëveshje të fshehtë me muslimanët dhe se do të kërkonin një peng nga ata e do t'ia dorëzonin Hz. Muhammedit. Për këtë arsye u kërkoi që të distancohen nga hebrenjtë. Pasi Beni Kurajdha kërkoi peng prej tyre, idhujtarët menduan se fjalët që kishte thënë Nuajmi ishin të vërteta, prandaj u dërguan lajm hebrenjve, ku i informonin se nuk do t'u jepnin kurrë peng atyre. Pas kësaj Beni Kurajdha arriti në përfundimin se Kurejshi nuk ishte i sinqertë.

Secili nga grupet fajësoi tjetrin për tradhti. Kështu aleanca mes hebrenjve dhe idhujtarëve erdhi në pikën e shkëputjes. Ndërkohë, muaji Dhilkade ishte gati të hynte. Kjo nënkuptonte edhe fillimin e muajve haram. Në rrethinë të Mekës do të ngriheshin panaire dhe do të fillonte stina e haxhit. Për këtë arsye kurejshitët vendosën të kthehen në Mekë. Në këtë kohë, bashkë me furtunën që filloi krejt papritur, idhujtarët mbetën të shtangur.

Kur'ani aludon kështu në lidhje me këtë situatë:

"O besimtarë! Kujtoni dhuntinë e Allahut kur ju erdhi një ushtri (idhujtarësh), e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri (melekësh) që ju nuk e shihnit; ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju." *(Ahzab, 33/9)*

Pasi era prishi garnizonin e idhujtarëve, Ebu Sufjani mbajti një fjalim, ku bëri të ditur se e kishte ngritur rrethimin. Edhe Hz. Pejgamberi, pas ngritjes së rrethimit, lejoi njerëzit të ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Rrethimi i Hendekut, i cili filloi në 7 sheuual 5/1 janar 627, vazhdoi për 23 ditë dhe përfundoi në 1 dhilkade 5/24 janar 627.

Lufta e Hendekut kishte rezultuar me disfatën e idhujtarëve. Në këtë luftë ranë dëshmorë gjashtë muslimanë, ndërsa nga idhujtarët vdiqën tre persona.

Kthimi pas i idhujtarëve dhe i aleatëve pas disfatës së pësuar, ndikoi shumë në përhapjen e Islamit mes fiseve arabe.

Gjatë kësaj lufte u konstatua edhe një herë në formë të qartë gjenialiteti ushtarak dhe politik i Hz. Pejgamberit.

Është radha juaj

Cilat janë kriteret themelore që ndoqi Pejgamberi ynë në luftërat e bëra me idhujtarët?

Periudha e paqes: Marrëveshja e Hudejbijes

Disa muaj pas luftës së Hendekut, në vitin e 6 hixhri, Hz. Pejgamberi pa ëndërr se kishte bërë tavaf Qabenë. Ua tregoi këtë ëndërr shokëve të tij dhe morën vendim të bënin umre.

Pasi u përgatitën, u nisën për udhëtim në muajin Dhilkade, në vitin e 6 hixhri. Pejgamberi (s.a.s.) u nis bashkë me 1500 shokë, ndërsa si zëvendës në Medine la Abdullah b. Mektumin. Qëllimi i tij ishte vetëm të vizitonte Qabenë. Për të treguar se kishin këtë qëllim, i veshën ihramet pa u larguar shumë nga Medina, nuk morën me vete armë të tjera përveç atyre të udhëtimit, po ashtu, morën me vete edhe 70 deve për t'i bërë kurban.

Mekasve nuk u pëlqeu kjo situatë dhe ngritën dyshime në lidhje me këtë vizitë. Prandaj menduan për mënyrat se si të kthenin pas muslimanët para se ata të hynin në Mekë. Mekasit dërguan në ndjekje të tyre Halid b. Uelidin dhe Ikrime b. Ebu Xhehilin, bashkë me një grup kalorësish. Mirëpo muslimanët u shmangën nga rruga ku i prisnin ata dhe arritën në Hudejbije, e cila gjendej 17 kilometra larg nga Meka.

Me synimin për të zgjidhur problemin në fjalë, të dyja palët nisën drejt njëra-tjetrës delegatë. Kurejshitët, për të kuptuar qëllimin e vërtetë të muslimanëve, bashkë me një grup nga fisi Huzaa, dërguan Budejl b. Barkanë si delegat. Pejgamberi (s.a.s.) kërkoi nga ai që t'i bënte të ditur Kurejshit se nuk kishin ardhur për të luftuar, por për të vizituar Qabenë. Njëkohësisht, dërgoi si delegat në Mekë Hirash b. Umejjen, për t'i thënë se kishin ardhur veçse për umre, se do të bënin tavaf Qabenë, do të ktheheshin pas dhe se nuk kishin si synim të luftonin. Megjithatë, mekasit u sollën keq me të dhe ai ia tregoi këtë Hz. Pejgamberit.

Hz. Pejgamberi këtë herë dërgoi Hz. Omerin si delegat te mekasit. Mirëpo Hz. Omeri, ngaqë e dinte se nuk kishte të afërm në Mekë që mund ta mbronin dhe ishte në dijeni të armiqësisë dhe ashpërsisë së Kurejshit ndaj tyre, nuk pranoi të shkojë dhe sugjeroi të shkonte Hz. Osmani. Hz. Pejgamberi dërgoi Hz. Osmanin si delegat në Mekë. Mekasit thanë se nuk do ta lejonin këtë vizitë, por, nëse ai dëshironte, mund të bënte tavaf Qabenë. Hz. Osmani nuk e pranoi këtë. Pas kësaj, mekasit u zemëruan me të dhe e arrestuan. Ndërkohë, Hz. Pejgamberit i erdhi një lajm, sipas të cilit Hz. Osmani ishte vrarë. Të gjendur në zhvillime të tilla negative, Hz. Pejgamberi vendosi të marrë besë nga shokët e tij se nuk do të largoheshin nga atje pa luftuar. Në Hudejbije, nën pemën ku ishin strehuar, mori besë nga sahabet se "do të luftonin deri në vdekje", ose "deri kur të arrinin sukses". Kjo besëlidhje quhet Bej'atu'r-Riduan.

Kur'ani flet kështu për këtë besëlidhje:

"Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt e me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." *(Fetih, 48/18-19)*

Mekasit ishin lajmëruar në lidhje me këtë besëlidhje dhe, të kapluar nga frika, e lanë të lirë Hz. Osmanin. Më pas kishin dërguar në Hudejbije një grup të përbërë nga Hu'uejtib b. Abduluzza dhe Mikrez b. Hafs, ku kërkonin paqe. Si rezultat i bisedimeve reciproke, u realizua marrëveshja e Hudejbijes. Sipas kësaj marrëveshjeje:

1. Në vitin në fjalë, muslimanët do të ktheheshin pas pa e vizituar Qabenë, por vitin tjetër do të mund të bënin një vizitë katërditore. Në periudhën kohore prej tri ditësh gjatë vitit të ardhshëm, me ta nuk do të bisedonte asnjë mekas. Kur të vinin për vizitën e Qabesë do të merrnin me vete vetëm armët e udhëtimit.

2. Ndër fiset arabe, çdonjëri prej fiseve mund të bënte marrëveshje me Kurejshin, ose nëse dëshironte, me Hz. Muhammedin.

3. Asnjë musliman medinas që strehohej në Mekë nuk do të rikthehej pas, por edhe nëse ndonjëri prej muslimanëve të Kurejshit strehohej te muslimanët e Medines, ky person nuk duhej të pranohet nga muslimanët.

4. Ata që vinin në Mekë për të kryer haxhin dhe umrenë, ose që kalonin nga këtu për të vajtur në Jemen dhe Taif, si dhe ata që vinin në Medine gjatë udhëtimit për në Siri ose në lindje, do të ishin të mbrojtur e të sigurt.

5. Kjo marrëveshje do të ishte e vlefshme për një periudhë 10-vjeçare, gjatë së cilës as Kurejshi nuk do të sulmonte muslimanët dhe as muslinanët nuk do të sulmonin Kurejshin. Në këtë pikë përfshiheshin edhe aleatët e të dyja palëve.

Pas përpilimit të marrëveshjes doli një problem tjetër, i cili lidhej me mënyrën e shkrimit të emrave në fund të marrëveshjes. Mekasit e kundërshtuan faktin që Hz. Pejgamberi kishte urdhëruar shkrimin poshtë marrëveshjes në formën: "Rasulullah Muhammed" (I Dërguari i Allahut, Muhammedi) dhe kishin kërkuar nga ai që ta ndryshonte dhe ta bënte: "Muhammed b. Abdullah" (Muhammedi, i biri i Abdullahut). Hz. Pejgamberi e kishte pranuar këtë propozim të tyre dhe marrëveshjen e kishte nënshkruar në formën Muhammedi, i biri i Abdullahut.

Një problem tjetër ishte që në vend të fjalës "Bismil-lahirrahmanirrahim" të vendosej fjala "Bismikellahume", të cilën e kishin pjesë të traditës së tyre. Hz. Pejgamberi, për shkak se kjo fjalë nuk ishte në kundërshtim me teuhidin (njëjësinë e Allahut), nuk kundërshtoi në vendosjen e saj në tekst. Teksti i marrëveshjes i shkruar nga Hz. Aliu u përgatit në dy kopje dhe dëshmitarët e secilës prej dy palëve nënshkruan marrëveshjen.

Menjëherë pas marrëveshjes, Ebu Xhendeli, djali i Suhejl b. Amrit, kryetarit të delegacionit të Kurejshit, u arratis nga burgu ku ishte futur ngaqë kishte pranuar Islamin dhe u strehua te muslimanët. Por, për shkak të marrëveshjes ai iu kthye të atit.

Kthimi pas pa plotësuar haxhin, kthimi i njëanshëm i atyre që ktheheshin nga feja dhe heqja e shprehjes "Rasulullah" nga teksti i marrëveshjes kishin ndikuar negativisht mbi muslimanët. Hz. Pejgamberi, duke i inkurajuar psikologjikisht shokët e tij, u tha se kjo marrëveshje nuk do të ishte një humbje për ta, përkundrazi, ishte tregues i një fitoreje të rëndësishme afatgjatë. Në të vërtetë, edhe pse në shikim të parë marrëveshja e Hudejbijes dukej në disfavor të muslimanëve, ajo përbënte një pikë kthese në aspektin e përhapjes së Islamit me shpejtësi.

Muslimanët, të cilët qëndruan aty për më shumë se dhjetë ditë, pas marrëveshjes u kthyen në Medine.

Vitin e ardhshëm, rreth 2000 muslimanë erdhën në Qabe dhe kryen lehtësisht vizitat e tyre aty.

3 Marrëdhëniet me hebrenjtë

Marrëdhëniet sociale, politike dhe kulturore mes muslimanëve dhe hebrenjve filluan bashkë me hixhretin e muslimanëve nga Meka në Medine. Hz. Pejgamberi, pasi migroi në Medine, nënshkroi një marrëveshje me hebrenjtë vendës, të cilët gëzonin një autoritet të rëndësishëm dhe bashkë me këtë marrëveshje u hodhën hapat drejt paqes shoqërore mes muslimanëve dhe hebrenjve.

Hebrenjtë, që prej kohëve të vjetra, kishin përcaktuar si vendbanim Medinen dhe disa zona mbi rrugën e Damaskut. Numri i shumtë i tyre, pasuria, veprimtaria në fushën e bujqësisë, artit dhe tregtisë, u bë shkak që të ngriheshin më lart se populli vendës, duke i besuar një Pejgamberi dhe librit që ai kishte sjellë. Me këtë pozitë të tyre, herë pas here pretendonin për epërsi ndaj bashkëqytetarëve me të cilët ndanin të njëjtin qytet.

Hz. Pejgamberi, sapo erdhi në Medine bëri marrëveshje me ta. Kështu, mori nën mbrojtje liritë e tyre fetare dhe të drejtat themelore. Ndërkohë, duke lënë në fuqi marrëveshjet e paqes të arritura më parë me fiset Eus dhe Hazrexh, kishte ruajtur pozitën e tyre në Medine, me kusht që të mos bënin tradhti, të mos ndihmonin armikun dhe të mos cenonin të drejtën e askujt. Por, ato kishin filluar të shqetësoheshin, për faktin se Hz. Pejgamberi forcohej vazhdimisht e më shumë në Medine dhe Islami sa vinte e përhapej. Në këtë aspekt ishin frikësuar se mos tronditej pozita që zotëronin më përpara.

Hz. Pejgamberi herë pas here i ftoi në Islam, por ata e refuzuan ftesën islame dhe nga brenda kishin filluar të ndienin mllef ndaj Pejgamberit (s.a.s.). Nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por nisën të krijonin intriga në disfavor të muslimanëve.

I pari nga fiset që prishi marrëveshjen e bërë me muslimanët ishte Beni Kajnuka. Fisi Kajnuka, pas luftës së Bedrit, filloi ta përçmojë fitoren që korrën muslimanët, të bëjë propagandë duke e lidhur fitoren e muslimanëve me mosnjohjen e taktikës së luftës nga kurejshitët.

Një grua nga ensarët kishte vajtur në çarshinë e fisit Beni Kajnuka. Një hebre që gjendej në dyqan, pa dijeninë e gruas, kishte kapur pjesën e poshtme të fustanit të kësaj gruaje. Kur gruaja ishte ngritur më këmbë, i kishte rënë veshja dhe ishte zbuluar. Hebrenjtë kishin filluar të qeshnin me njëri-tjetrin për këtë situatë, ndërsa gruaja kishte filluar të bërtiste. Një musliman që po kalonte andej, nisi të përleshej me hebreun që kishte bërë këtë veprim, derisa ky i fundit kishte vdekur. Hebrenjtë e tjerë që ishin atje kishin vrarë muslimanin.

Pas kësaj hebrenjtë njoftuan se e kishin prishur marrëveshjen dhe u përgatitën për luftë. Edhe pse Hz. Pejgamberi foli me ta dhe i paralajmëroi që kjo punë nuk do të përfundonte mirë, ata u treguan këmbëngulës në qëndrimin e tyre. Nën këto kushte, Hz. Pejgamberi, për shkak të tradhtisë së treguar nga Beni Kajnuka, i rrethon ata në sheuual 2/mars-prill 624. Muslimanët i rrethuan për 15 ditë hebrenjtë, të cilët ishin tërhequr në kalanë e tyre. Pas kësaj hebrenjtë u kapluan nga pesimizmi.

Më në fund, duke pranuar vendimin që do të jepte Hz. Pejgamberi, dolën nga kalaja e tyre dhe u dorëzuan. Aleati i vjetër i fisit Kajnuka, Abdullah b. Ubej, kërkoi nga Hz. Pejgamberi që t'i falte. Hz. Pejgamberi mori vendim që ata të braktisnin Medinen. Fisi Kajnuka la pasurinë e armët dhe e braktisi Medinen, për t'u vendosur në qytetin Ezriat në anën e Sirisë.

Sipas marrëveshjes që ekzistonte ende mes muslimanëve dhe hebrenjve, palët do të jepnin mbështetje materiale ndaj njëri-tjetrit në rast nevoje. Njëri prej muslimanëve kishte vrarë gabimisht dy persona dhe muslimanët kishin marrë mbi vete pagesën e shpagimit të tyre. Hz. Pejgamberi, duke u bazuar në këtë marrëveshje, vajti personalisht në lagjen e tyre për të kërkuar që edhe Beni Nadiri të përfshihet në pagesën e shpagimit. Hebrenjtë e fisit Beni Nadr fillimisht u sollën mirë me Hz. Pejgamberin. Pasi i thanë se do të ishin ortakë në shlyerjen e shpagimit, i kërkuan që të pushonte për një kohë. Ndërsa Muhammedi (s.a.s.) po qëndronte në hijen e një muri bashkë me shokët e vet, ata planifikuan vrasjen e tij, duke rrokullisur një gur mbi të. Hz. Pejgamberi e parandjeu situatën dhe u ngrit e u largua nga aty. U bëri të ditur muslimanëve se fisi Nadr kishte tentuar ta vriste dhe kërkoi nga ata të bëheshin gati për luftë. Dërgoi Muhammed b. Meslemenë si delegat te fisi Beni Nadr dhe u kërkoi që të braktisin Medinen brenda 10 ditësh, pasi u kishte kujtuar tradhtinë që i bënë.

Edhe pse fillimisht fisi Beni Nadr kishte marrë vendim që të emigronte, hoqën dorë nga emigrimi, të mashtruar nga premtimi për ndihmë që u kishte bërë Abdullah b. Ubeji. Hz. Pejgamberi u nis drejt fisit Beni Nadr më 18 rebiuleuuel 4/29 qershor 625. Pasi i rrethoi, së pari i ftoi të bënin marrëveshje. Rrethimi zgjati 15 ditë. Abdullah b. Ubeji nuk e mbajti premtimin e dhënë për ndihmë, as hebrenjtë e fisit Beni Kurajdha nuk u treguan të gatshëm t'i ndihmonin, kështu që fisi Beni Nadr pranoi të dilte nga Medina.

Për shkak të marrëveshjes së arritur, përveç materialeve dhe pajisjeve të luftës, morën mallra aq sa të mund t'i ngarkonin në devetë e tyre dhe u larguan nga Medina bashkë me familjet. Shumica prej tyre u vendosën në Hajber. Ndërsa një pjesë vajti në anë të Sirisë. Kryetari i tyre, Hujej b. Ahtab, pasi e la familjen në Hajber, shkoi në Mekë për të nxitur idhujtarët e Kurejshit kundër Hz. Pejgamberit. Gërmimi i hendekut u krye si rezultat i këtyre aktiviteteve.

Me nxjerrjen e fisit Beni Kajnuka dhe Beni Nadr nga Medina, në qytet kishte mbetur vetëm fisi Beni Kurajdha. Fisi Beni Kurajdha i tradhtoi muslimanët në çastet më të vështira të luftës së Hendekut, i nxitur nga lideri i Beni Nadrit, Hujej b. Ahtab. Ndërsa muslimanët po mundoheshin të mbronin qytetin në luftën e Hendekut përballë idhujtarëve, ballafaqimi i tyre me një tradhti të tillë nga brenda i vuri në një pozitë mjaft të vështirë. Kur Hz. Pejgamberi mësoi për situatën, dërgoi një delegacion për informim dhe konfirmim, si dhe kërkoi që të heqin dorë nga tradhtia. Mirëpo lideri i Beni Kurajdha, Ka'b b. Esed, u tall me delegacionin musliman dhe u soll mjaft ashpër ndaj tyre.

Pas rrethimit të hendekut, Hz. Pejgamberi u nis për mësymje menjëherë drejt Beni Kurajdha dhe rrethoi lagjen ku ata banonin. Pjesëtarët e fisit Beni Kurajdha, i provokuan muslimanët duke u tërhequr në kalatë e tyre, por mbetën në pozitë të vështirë, pasi rrethimi zgjati për shumë kohë, kështu që iu desh të kërkonin rrugëzgjidhje. Muslimanët

u propozuan të pranonin Islamin, mirëpo ata e refuzuan këtë. Beni Kurajdha u dorëzua, me kusht që t'i nënshtroheshin vendimit që do të merrte ish-aleati i tyre, Sa'd b. Muadhi.

Sa'di mori vendim që meshkujt e rritur të vriten për shkak të krimit të luftës, gratë dhe fëmijët të merren si robër lufte, ndërsa pasuria e tyre të vlerësohet në statusin e ganimetit.

Fushata luftarake Kurajdha, e cila u realizua në dhilkade 5/janar-shkurt 627, përfundoi krahas zbatimit të urdhrit të sipërpërmendur.

Me mënjanimin e pjesëtarëve të fisit Beni Kurajdha, qyteti i Medines shpëtoi nga hebrenjtë që kishin prishur marrëveshjen, mirëpo për muslimanët rreziku i hebrenjve ekzistonte ende.

Hebrenjtë e Hajberit, të cilët u informuan për ngjarjen e fisit Beni Kurajdha, vendosën të nisen drejt Medines, duke u bashkuar me hebrenjtë që banonin në Hajber, Tejma, Fedek, Uadi'l-Kura. Hz. Pejgamberi, sapo u informua për një përgatitje të tillë, dërgoi në Hajber një delegacion, nën kryesinë e Abdullah b. Reuaha, në muajin e Ramazanit, në vitin e 6 të hixhretit. Delegacioni konstatoi vërtetësinë e lajmit. Hz. Pejgamberi përgatiti një ushtri prej dy mijë personash dhe u nis nga Medina në fund të muajit Muharrem, në vitin e 7 hixhri. Pas një udhëtimi treditor arriti në Hajber, i cili gjendej në një largësi prej 150 kilometër nga Medina. Pejgamberi (s.a.s.) i ftoi ata që të pranonin Islamin ose të bënin marrëveshje për paqe, por ata i refuzuan të dy propozimet. Në rrethimin që zgjati për 20 ditë hebrenjtë u mbrojtën me aq sa mundën, mirëpo dalëngadalë kalaja e tyre ra dhe në fund Hajberi u çlirua.

Hz. Muhammedi ua la hebrenjve tokat e Hajberit, me kusht që t'i kultivojnë dhe t'u japin muslimanëve gjysmën e produkteve. Në saje të këtyre të ardhurave, forca ekonomike e muslimanëve u shtua.

Pejgamberi (s.a.s.) qëndroi këtu edhe disa ditë pas çlirimit të Hajberit, por u gjend përballë një tentative për komplot. Zejnebe, vajza e Harithit, njërit prej liderëve të fiseve hebrenje, u përpoq ta helmonte atë, por nuk ia doli. Gjatë çlirimit të Hajberit u përfitua ganimet dhe robër në sasi të konsiderueshme. Ndërkohë, Safijen, vajzën e Hujej b. Ahtabit, liderit hebre, e cila gjendej mes robërve, e la të lirë dhe u martua me të.

Pas çlirimit të Hajberit, Hz. Pejgamberi shtiu sërish në dorë një qendër banimi të hebrenjve, Uadi'l-Kura. Edhe ndaj atyre u vendos kushti i dhënies së gjysmës së produkteve vjetore ndaj muslimanëve, njësoj siç kishte ndodhur me hebrenjtë e Hajberit. Pasi ra kalaja e Hajberit, hebrenjtë e Fedekut kërkuan paqe. Kështu u thye edhe forca e hebrenjve.

4 Marrëdhëniet me të krishterët

Që ditën e parë, muslimanët krijuan marrëdhënie me të krishterët, por, ngjarja e parë që i vuri përballë të dyja palët, filloi me vrasjen e Harith b. Umejr el-Ezdiut, të cilin Hz. Pejgamberi e dërgoi me një letër për prefektin e qytetit Busra të shtetit bizantin, dhe që u vra nga një prefekt tjetër i shtetit bizantin, Shurah b. Amr el-Gassani, në kohën kur arriti në vendin e quajtur Mu'te.

Hz. Pejgamberi përgatiti një ushtri prej tre mijë personash, me në krye sahabet Zejd b. Harithe, Xhafer b. Ebi Talib dhe Abdullah b. Reuaha. Edhe prijësi i qytetit Busra, Shurah b. el-Gassani, kishte filluar përgatitjet, me një ushtri prej afërsisht njëqindmijë personash, i mbështetur edhe nga rumët. Kur muslimanët erdhën në Mu'te, e cila gjendej rreth 35-40 km nga Kudusi dhe në afërsi të qytetit Belka, panë përballë tyre ushtrinë armike prej rreth njëqind mijë personash.

Muslimanët luftuan me gjithë forcat e tyre. Zejdi, Xhaferi dhe Abdullah b. Reuaha ranë dëshmor njëri pas tjetrit. Ushtria e muslimanëve filloi të humbë rregullin. Halid b. Uelidi, i cili u soll në krye të ushtrisë, e mblodhi ushtrinë që po shpërndahej dhe filloi të luftojë me armikun. Meqë gjatë natës lufta u ndërpre dhe duke pasur parasysh se në ditët në vijim do të përballeshin me një ushtri në numër të lartë, Halid b. Uelidi vendosi të zbatojë një taktikë ndryshe. Kështu, në frontin e majtë mori ushtarët e frontit të djathtë, të djathtët i kaloi në të majtin, ata të frontit të parë në të pasmin dhe të pasmit në të parmin. Kjo do të krijonte përshtypjen se muslimanët kishin marrë ndihmë gjatë natës.

Qëllimi kryesor i Halid b. Uelidit ishte që ta thyente armikun psikologjikisht, të prapste ata me një sulm, të shpëtonte ushtrinë muslimane nga shkatërrimi total dhe të tërhiqeshin pas. Çdo gjë u bë ashtu siç e planifikoi Halid b. Uelidi. Muslimanët u tërhoqën pas një sulmi të menjëhershëm. Ushtarët armiq nuk patën guxim t'i ndiqnin muslimanët dhe ushtria e tyre u kthye në Medine. Hz. Pejgamberi, për shkak të këtij suksesi, i dha Halid b. Uelidit titullin "Sejfullah" (shpata e Allahut). Ngjarja ka ndodhur në hixhri 8/miladi 629.

Mesxhidi Nebevi

Një tjetër ngjarje që vuri përballë njëri-tjetrit muslimanët dhe të krishterët ishte fushata luftarake e Tebukut, e cila u zhvillua pas rrethimit të Taifit. Pasi u informua prej disa tregtarësh që vinin nga Siria, se perandori bizantin, duke pasur edhe mbështetjen e disa fiseve arabe, po përgatitej për luftë, Hz. Pejgamberi nisi të merrte masat. Përgatiti një ushtri prej tridhjetë mijë personash dhe megjithëse në përgjithësi e mbante fshehur vendin ku do të realizohej lufta, kësaj radhe e shpalli hapur se kjo luftë do të bëhej përballë bizantinëve. Moti nuk ishte shumë i volitshëm për luftë. Temperaturat ishin shumë të larta dhe ishte një periudhë kur pati rënë zia. Prandaj edhe kjo fushatë u quajt "Gazuetu'l-Usre" (Fushata luftarake e vështirësisë).

Ushtria, e cila u përgatit nën kushte mjaft të vështira, në vitin e 9 hixhri u nis drejt Sirisë, nën komandën e Pejgamberit. Muslimanët vajtën në Tebuk, i cili gjendej 778 kilometra larg nga Medina dhe mbi rrugën e Sirisë. Pavarësisht se qëndruan për 20 ditë në Tebuk, armiku nuk u duk. U kuptua se nuk ishte përgatitur asnjë ushtri kundër muslimanëve dhe se lajmet që kishin arritur në Medine nuk ishin të sakta.

Gjatë fushatës luftarake të Tebukut u arritën marrëveshje edhe me shtetet fqinje. Duke u dërguar njësi ushtarake drejt zonave Xherba, Ejle, Ezruh, Makna dhe Maan, në shumicën e të cilave jetonin të krishterët, e në disa të tjera hebrenjtë, popujt vendas u thirrën në Islam. Këta, edhe pse nuk e kishin pranuar fenë islame, paguan xhizje, duke njohur kështu autoritetin e muslimanëve.

Në zonën Nexhran të Gadishullit Arabik jetonte një bashkësi e krishterë mjaft e lartë në numër. Në vitin e 9 hixhri, të cilën historianët e shprehin si Viti i Delegacioneve, të krishterët e Nexhranit, pas letrës që u kishte nisur Hz. Pejgamberi, dërguan në Medine një delegacion prej 60 personash. Në letrën e tij, Hz. Pejgamberi u bënte thirrje që të pranonin Islamin ose të jepnin xhizje, përndryshe do t'u shpallte luftë.

Delegacioni i fisit Nexhran erdhi në Mesxhidin Nebeui në një kohë ikindie. Muslimanët sapo kishin falur namazin. Ngaqë kishte ardhur edhe koha e adhurimit të të krishterëve, deshën të drejtohen drejt lindjes dhe të bëjnë adhurimet e tyre. Edhe pse disa sahabe deshën t'i pengonin, Hz. Pejgamberi lejoi që ata t'i kryenin adhurimet. Më pas i ftoi të bëhen muslimanë. Ata thanë: "Ne u bëmë muslimanë para teje." Por Hz. Pejgamberi u tha atyre se ishin tri gjëra që i pengonin të pranonin Islamin: ngrënia e mishit të derrit, adhurimi i kryqit dhe besimi se Zoti kishte një djalë.

"Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: 'Bëhu!' dhe ai u bë." *(Al-u Imran, 3/59)*

Pas kësaj ata pyetën: "Atëherë kush është babai i Isait?" Hz. Pejgamberi nuk iu përgjigj kësaj pyetjeje dhe heshti. Në këtë periudhë u shpallën më shumë se 80 ajete të sures Al-u Imran, ku përfshihen të dhënat në fjalë. Ajeti 59 i sures Al-u Imran i dha përgjigje pyetjes së tyre:

"Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: 'Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!" *(Al-u Imran, 3/61)*

Pasi iu lexoi atyre këtë ajet, Pejgamberi, sërish siç shprehej në ajetin 61 të sures Al-u Imran, i ftoi ata në mallkimin e ndërsjellë.

Të gjendur përballë këtij propozimi, pjesëtarët e fisit Nexhran kërkuan leje që të bisedojnë mes tyre. Më në fund vendosën të mos shprehin mallkime të ndërsjella. Pranuan të japin xhizje, me kusht që të qëndronin në fenë e tyre. Pas këtij propozimi të Hz. Pejgamberit, nënshkruan një marrëveshje, me kusht që të jepnin dy mijë veshje, një mijë prej tyre në muajin rexheb dhe një mijë të tjera në muajin safer.

Është radha juaj

Cilat janë parimet themelore që ndiqte Pejgamberi ynë sa i përket vetëdijes mbi bashkëjetesën në marrëdhëniet me hebrenjtë dhe me të krishterët?

5 Çlirimi i Mekës

Marrëveshja e Hudejbijes qe prishur prej idhujtarëve pa kaluar as dy vjet nga nënshkrimi i saj. Prej kohëve të hershme ekzistonte një armiqësi mes fisit Huzaa, i cili kishte krijuar aleancë me muslimanët pas Marrëveshjes së Hudejbijes dhe fisit Bekr, që kishte krijuar aleancë me idhujtarët.

Një grup prej fisit Bekr, në muajin shaban të vitit 8 hixhri, sulmuan papritur fisin Huzaa, duke vrarë 23 persona. Gjatë këtij sulmi idhujtarët e Kurejshit e ndihmuan fisin Bekr me armë.

I gjendur përballë kësaj situate, Amr b. Salimi nga fisi Huzaa vajti në Medine dhe informoi Hz. Pejgamberin për ngjarjen. Pejgamberi (s.a.s.) u shkroi një letër kurejshitëve, ku kërkonte prej tyre ose të prishnin aleancën me fisin Bekr, ose të paguanin shpagimet e pjesëtarëve të vrarë të fisit Huzaa. Nëse nuk do të bënin ndonjërën prej këtyre, u shkruante se ndërmjet tyre do të kishte luftë. Kurejshitët e refuzuan këtë propozim dhe e kthyen prapa delegatin, duke i dhënë përgjigje negative. Mirëpo, siç duket, të frikësuar nga rezultati i kësaj situate, dërguan në Medine Ebu Sufjanin, në shenjë pendese, me qëllim që të rinovohej Marrëveshja e Hudejbijes. Hz. Pejgamberi nuk e priti Ebu Sufjanin dhe e refuzoi propozimin e tij. Ebu Sufjani u kthye pas.

Pasi Ebu Sufjani u largua nga Medina, u mor vendimi që të niseshin drejt Mekës. Për këtë filluan përgatitjet fshehurazi. U dërgua lajm ndaj fiseve përreth Medines dhe u kërkua prej tyre që të mblidhen në krye të Ramazanit në Medine.

Përgatitjet për luftë mbaheshin krejtësisht të fshehta. Duhej që kurejshitët të mos informoheshin për këtë luftë. Mirëpo Hatib b. Ebu Beltea nga muhaxhirët, i dha një letër të fshehtë një gruaje, ku i jepte të dhëna Kurejshit në lidhje me përgatitjet ushtarake. Pasi ngjarja doli në shesh, ngaqë u kap personi që do të çonte këtë letër, Hatibi u mor në pyetje, por gjeti justifikime. Pas gjykimit, Hatibi u fal.

Në ditët e para të muajit Ramazan, të gjitha përgatitjet ishin realizuar. Në 10 ramazan 8/1 janar 630, Hz. Pejgamberi u nis nga Medina me një ushtri prej dhjetë mijë personash. Ushtria u vendos në luginën e quajtur Merru'dh-Dhahran, e cila gjendej 16 kilometër larg Mekës. Hz. Pejgamberi, i cili kishte ngritur garnizonin në luginë, kur u errësua, kërkoi të ndizeshin aq zjarre sa ishte edhe numri i ushtarëve. Mekasit, të cilët panë këto zjarre dhe që nuk e dinin se kush ishin, dërguan Ebu Sufjanin bashkë me dy shokët e tij për të mësuar se ç'po ndodhte. Mirëpo Ebu Sufjani dhe shokët u kapën nga muslimanët dhe u sollën te Hz. Pejgamberi. Pas një hezitimi të gjatë, Ebu Sufjani u bë musliman.

Muslimanët hynë në Mekë nga katër anët. Hz. Pejgamberi (s.a.s.) ngarkoi dikë me detyrë dhe kërkoi nga ai që të shpallë këto fjalë: "Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt. Kushdo që mbyll portën është i sigurt. Kushdo që hyn në el-Mesxhidu'l-Haram është i sigurt."

Hz. Pejgamberi kërkoi që të mos derdhej gjak pa pasur arsye. Meka u dorëzua, muslimanët bënë tavaf Qabenë dhe thyen idhujt. Hz. Pejgamberi mbajti një fjalim përpara njerëzve të mbledhur rreth Qabesë, në të cilin, ndër të tjera tha: "Nuk ka Zot tjetër veç Allahut, vetëm Ai ekziston. Ai nuk ka shok, premtimi i tij doli i drejtë, ndihmoi robin e tij, bëri të mundur dështimin dhe mposhtjen e të gjitha bashkësive. Kini kujdes, çdo diskriminim, gjakmarrje dhe çështje pasurie gjendet nën këmbët e mia. Puna e përkujdesjes ndaj Bejtullahut dhe e ofrimit të zemzemit është jashtë këtyre.

"O bashkësia e Kurejshit, Allahu ju ka ndaluar të mburreni si në periudhën e injorancës dhe të krenoheni me etërit tuaj; njerëzit janë nga Ademi, ndërsa Ademi është nga dheu;

"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë." (Huxhurat, 49/13)

"Pyeti: 'O bashkësia e Kurejshit, ç'do t'ju bëj unë ju?', u përgjigjën të gjithë me një zë: 'Më të mirën; ti je një vëlla i nderuar dhe një nip i nderuar'. Ai urdhëroi: 'Hajde ikni, jeni të gjithë të lirë.'" *(Imaduddin Halil, Muhammed Alejhisselam, f. 253)*.

Hz. Pejgamberi shpalli faljen e përgjithshme (amnistinë) në Mekë. Nga kjo amnisti nuk përfituan shtatëmbëdhjetë persona, shumica prej të cilëve u fal më pas. Çlirimi i Mekës përshpejtoi jashtë mase përhapjen e Islamit dhe u bë një pikë kthese e rëndësishme në historinë islame.

Është radha juaj

Ç'rëndësi ka në ditët e sotme hutbeja e ligjëruar nga Pejgamberi ynë gjatë çlirimit të Mekës?

6 Delegatët e shpalljes universale

Krahas çlirimit të Mekës në vitin 8/630, me pranimin e Islamit nga një fis i fuqishëm si Heuazini, me fushatën luftarake të Tebukut në vitin 9 hixhri dhe me hyrjen e Arabisë Veriore nën sovranitetin e muslimanëve, filluan të vijnë në Medine delegatë nga çdo zonë e Arabisë. Ngaqë viti i 9 hixhri ishte shumë i ngarkuar nga pikëpamja e ardhjes së delegacioneve, ky vit u quajt Senetu'l-Vufud (Viti i delegacioneve).

Numri i fiseve që nisën delegacione e tejkalonte shtatëdhjetën. Një pjesë prej këtyre delegacioneve janë: Sa'd b. Bekir, Temim, Himjeritët, Bexhile, Taj, Esed, Taglib, Fezare, Kinane, Kinde, Thekif, Sulejm...

Qëllimet e këtyre delegacioneve që u mirëpritën nga Hz. Pejgamberi, në përgjithësi ishin të njoftonin se qenë bërë muslimanë, se dëshironin të mësonin Islamin ose të kërkonin mësues që t'u mësonin Islamin. Mirëpo, siç u shpreh më parë, pati edhe nga ata që bënë bisedime me kusht që të paguanin xhizje, duke pranuar hyrjen nën sovranitet. Shembull për këtë mund të merret delegacioni i krishterë i Nexhranit.

Muhammedi (s.a.s.) u tregua shumë mirënjohës me këto delegacione dhe u angazhua personalisht për mikpritjen e tyre. Delegacionet më shumë u mirëpritën në shtëpitë e sahabeve, por edhe në çadrën e përdorur si mysafirhane pranë Suffesë dhe Mesxhidit.

Krahas marrëveshjes së paqes që u realizua me Kurejshin në vitin e 6 hixhri, Hz. Pejgamberi kishte një mundësi të bukur për të ftuar njerëzit në Islam. Pas marrëveshjes së Hudejbijes, dërgoi letra dhe delegatë ndaj prijësve në Gadishullin Arabik, si dhe ndaj kryetarëve të fiseve dhe sovranëve në zonat që rrethonin gadishullin. Në këtë mënyrë ftonte në Islam ata dhe popullin që kishin nën drejtim dhe u bënte të ditur atyre parimet e fesë islame. Dërgoi Dihje b. Halife el-Kelbiun ndaj sovranit të Bizantit; Amr b. Umejje ed-Damriun ndaj sovranit të Etiopisë; Abdullah b. Hudhejfe es-Sehmiun ndaj mbretit të Iranit; Shuxha b. Uehbin ndaj mbretit gassanit Harith b. Ebu Shemirit; Selit b. Amrin ndaj sovranit të Jemames Heuze b. Aliun. Përveç këtyre, u dërgoi letra edhe prijësve të fiseve arabe, personave të famshëm dhe me ndikim edhe ndaj të krishterëve, hebrenjve dhe zjarradhuruesve, të cilët i ftonte në Islam. Delegatët që përçonin thirrjen përballeshin herë pas here me sjellje negative, herë të tjera me sjellje pozitive. Disa shembuj që mund të jepen për këtë situatë janë radhitur si më poshtë:

Herakleios e pranoi delegatin e Hz. Pejgamberit aty ku gjendej, në Kudus, u soll mirë me të dhe i dha dhurata, por nuk e pranoi Islamin.

Sovrani i Etiopisë e mirëpriti delegatin e dërguar, Amr b. Umejje ed-Damriun. Madje transmetohet se ka pranuar edhe Islamin. Hipi në anije muhaxhirët që banonin në shtetin e tij dhe i nisi ata në Medine.

Mbreti i Iranit, Husrev Peruizi, ka urdhëruar që letra e sjellë nga Abdullah b. Hudhafe es-Sehmiu të lexohet prej daktilografit nga Hireja, por, i zemëruar që në letër emri i Pejgamberit shkruhej para emrit të tij, e kishte grisur atë dhe e kishte dëbuar delegatin.

Sovrani i Egjiptit, Mukaukisi, e mirëpriti Hatib b. Ebi Beltean, por nuk e pranoi Islamin. Bashkë me delegatin, kishte dërguar në Medine edhe një robëreshë me emrin Marije dhe disa dhurata të tjera. Pejgamberi (s.a.s.) u martua me Marijen dhe madje i lindi edhe një djalë, të cilit ia vunë emrin Ibrahim.

Letrat e dërguara ndaj sovranëve u shkruan me një përmbajtje që karakterizohej nga urtësia. Shprehjet ishin më se toleruese. Disa nga shembujt e këtyre letrave janë cituar më poshtë:

Letra që iu dërgua perandorit të Bizantit, Herakleios, është si më poshtë:

"Bismil-lahirrahmanirrahim,

Nga robi dhe i dërguari i Allahut, Muhammedi, ndaj perandorit të Bizantit, Herakleios:

Selami i Allahut qoftë ndaj atyre që janë në rrugën e Allahut. Të ftoj ty në Islam. Pranoje Islamin që të arrish në shpëtim. Edhe Allahu të shpërbleftë dyfish. Nëse nuk e pranon, do të marrësh përsipër gjynahun e popullit. "O Ehlu'l-kitab! Ejani drejt fjalës së përbashkët mes jush dhe nesh. Të bëjmë robërim vetëm ndaj Allahut dhe të mos i njohim shok Atij, të mos lëmë Allahun dhe të njohim zotër të tjerë. Nëse kthejnë fytyrë, jini dëshmitarë dhe thoni: ne jemi muslimanë."

Letra që u dërgua ndaj mbretit të Iranit:

"Bismil'lahirrahhmanirrahim,

Selami i Allahut qoftë ndaj atyre që janë në rrugë të drejtë, ndaj atyre që besojnë tek Allahu dhe i Dërguari i tij, ndaj atyre që dëshmojnë se nuk ka zot tjetër veç Allahut, se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i tij. Të ftoj ty të pranosh Islamin. Sepse unë jam një Pejgamber i dërguar ndaj gjithë njerëzve, me qëllim që të paralajmëroj ata që janë në jetë dhe të realizoj fjalën e Allahut. Bëhu musliman që të arrish në shpëtim. Nëse nuk e pranon, gjithë gjynahu i zjarradhuruesve do të jetë mbi ty." *(shih Doğuştan Günümüze Büyük İslam Tarihi (Historia e madhe islame nga lindja dhe deri në ditët tona), I, 503-504)*.

7 Haxhi i Lamtumirës, Hutbeja e Lamtumirës dhe mesazhet universale

Haxhi që Hz. Pejgamberi ynë realizoi në vitin e 10 të hixhretit (m. 632) ka marrë emrin Haxhi i Lamtumirës, për shkak se u përshëndet për herë të fundit me shokët e tij dhe se nuk e vizitoi më Qabenë.

Në muajin dhilkade të vitit të 10 të hixhretit, janë bërë përgatitjet për haxh dhe ata që dëshironin të bënin haxh u mblodhën në Medine. Hz. Pejgamberi, ditën e shtunë, më 26 dhilkade 10/22 shkurt 632, bashkë me një grup të përbërë prej pjesëtarëve të familjes, muhaxhirët, ensarët dhe nga fiset e tjera arabe, u nisën nga Medina. Me vete mori 100 deve për t'i prerë si kurban. Kur erdhën në vendin e quajtur Dhulhulejfe, fali namazin e drekës si dy rekate, në statutin e udhëtarit dhe hyri në ihram në të njëjtin ditë këtu. Më 4 dhilhixh-xhe, ditën e diel paradite, arriti në Mekë mbi devenë e quajtur Kasua. Bëri tavaf Qabenë, fali dy rekate namaz dhe realizoi ecejaken mes Safasë dhe Merues.

Hz. Pejgamberi dhe muslimanët që vajtën në Mina në ditën e 9 të muajit dhilhixh-xhe, të njëjtën ditë pas drekës u ngjitën në malin Arafat. I Dërguari i Allahut, pasi arriti deri në mes të luginës së Arafatit i hipur mbi devenë e quajtur Kasua, u drejtua ndaj më shumë se njëqindmijë muslimanëve, ku këndoi hutbenë më të madhe dhe më të rëndësishme të thirrjes dhe shpalljes islame:

"Hamdi dhe falënderimi i përket Allahut; ne e falënderojmë Atë, kërkojmë ndihmë nga Ai, kërkojmë falje nga Ai dhe drejtohemi drejt Tij. Mbështetemi tek Allahu nga sherri i nefsit tonë, nga veprimet dhe aktet tona negative. Këdo që Allahu të drejtojë në rrugë të drejtë, për atë nuk ka devijim; këdo që e orienton drejt rrugës së drejtë, për atë nuk ka mbetur njeri që ta orientojë drejt rrugës së drejtë. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut, dëshmoj në njëjësinë e tij dhe se nuk ka shok. Përsëri dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij.

O robërit e Allahut! Ju këshilloj që të jeni të respektueshëm ndaj Allahut dhe të mos kundërshtoni urdhëresat e tij dhe ju nxis ju të shprehni bindje ndaj Tij. Dua t'i nis fjalët e mia me diçka të mirë dhe të hairit:

Atëherë o njerëz! Dëgjojini ato që do t'ju them. Sepse, pas këtij viti, ndoshta nuk do të takohem më me ju në vendin ku gjendem tani.

O njerëz! Ashtu sikurse janë të shenjta këto ditë, këta muaj dhe ky qytet i bekuar (Qabeja), ashtu janë të shenjta dhe të paprekshme edhe jeta, pasuria dhe nderi juaj, janë mbrojtur nga çdo lloj sulmi.

Sahabet e mi! Do të vijë dita që të takoheni me Zotin tuaj dhe do të jepni llogari për të gjitha veprimet që keni kryer.

Bëni kujdes! Pasi të vdes unë, mos u ktheni sërish te zakonet e mbrapshta, kur vriteshit me njëri-tjetrin.

Ata që janë të pranishëm këtu, t'ua përcjellin këto fjalë, këtë testament, atyre që nuk gjenden këtu! Mund të ndodhë që, ata të cilët nuk janë të pranishëm, t'i kuptojnë më mirë fjalët e mia sesa ata që ua përcjellin atyre këto fjalë e kështu i mbrojnë ata..."

"... O njerëz! Zoti juaj është një, etërit tuaj janë një. Të gjithë keni prejardhjen nga Ademi. Ndërsa Ademi është krijuar nga dheu. Ai që është më i vyeri dhe më i pranuari tek Allahu është ai që është i respektueshëm ndaj urdhëresave të tij dhe që shmanget nga kundërshtimi ndaj tij. Një arab nuk ka epërsi ndaj atij që nuk është arab dhe, nëse ka, kjo vjen nga devotshmëria. Kini kujdes! A shpalla? O Allahu im, ji dëshmitar!"

Nëpërmjet këtyre fjalëve, Hz. Pejgamberi ka dhënë një mesazh universal ndaj njerëzimit *(shih Ibn Abdirabbih, "el-Ikdu'l-Ferid", IV, 57-58; përveç kësaj shih Ja'kubi, Historia, II, 109-110*).

Pasi Pejgamberi ynë këndoi hutbenë, u ngjit në Arafat. Kur ishte në Arafat mori këtë ajet, që bënte të ditur se e kishte plotësuar shpalljen hyjnore:

"... Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj." *(Maide, 5/3)*

Më 29 dhilhixh-xhe 10/26 mars 632, pasi përfundoi detyrën e haxhit, Hz. Pejgamberi u kthye në Medine.

Është radha juaj

Zbuloni mesazhet universale të Hutbesë së Lamtumirës!

8 Vdekja e Hz. Pejgamberit



Ravdha-i Mutahhara

Më 29 safer 11/27, maj 632, pak kohë pas Haxhit të Lamtumirës, Pejgamberi (s.a.s.) u sëmur. Në ditët e para të sëmundjes kishte temperaturë të lartë. Megjithatë, sapo i binte temperatura, ai shkonte në mesxhid, dhe kështu printe namazin ndaj njerëzve. Kur e pati të pamundur të shkonte, ngarkoi me detyrë Hz. Ebubekrin, që të printe në faljen e namazit. Hz. Pejgamberi ndërroi jetë ditën e hënë, më 13 rebiuleuuel / 8 qershor.

Për shumë njerëz, lajmi i vdekjes së tij u duk i pabesueshëm. Hz. Omeri filloi të zemërohej ndaj të gjithë atyre që thoshin se kishte vdekur Rasulullahu. Duke nxjerrë shpatën u shpreh:

"Do të këpus qafën e të gjithë atyre që hamendësojnë se Rasulullahu ka vdekur. Vallahi ai nuk ka vdekur, por ashtu si ikja e Musait, ai ka shkuar pranë Allahut që të kthehet përsëri mes ummetit dhe të gjendet në krye të këtyre njerëzve deri në ditën e kiametit." *(Ibnu'l-Esir, II, 323)*

Ai që i habiti më shumë Hz. Omerin dhe muslimanët e tjerë ishte Hz. Ebubekri. Hz. Ebubekri, pasi mori lajmin e dëshpëruar, u fut në Mesxhidin Nebeui, vajti në dhomën ku gjendej Pejgamberi dhe doli prej andej tepër i dëshpëruar. Më pas u kthye në Mesxhid dhe mbajti këtë fjalim domethënës: "O njerëz! Kushdo qoftë ai që adhuron Muhammedin, le ta dijë se në të vërtetë ai ka vdekur. Ai që është rob ndaj Allahut dhe që e adhuron Atë, le ta dijë se Allahu është i përjetshëm, kurrë nuk vdes." *(Ibnu'l-Esir, po aty, II, 324)*.

Ndërsa më pas këndoi këto ajete të Kur'anit Famëlartë:

Ndërsa më pas këndoi këto ajete të Kur'anit Famëlartë: "Muhammedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit." *(Al-u Imran, 3/144)*

Ky fjalim i tij i zbuti muslimanët. Xhenazja e Hz. Pejgamberit, i cili ndërroi jetë ditën e hënë, u la nga Hz. Aliu ditën e martë dhe u vendos mbi krevatin prej druri. Muslimanët formuan grupe më të vogla dhe e falën namazin e tij të xhenazes pa imam. U parashtruan mendime të ndryshme se ku mund të varrosej ai, por ky problem u tejkalua pasi Hz. Ebubekri u kujtoi një hadith, sipas të cilit pejgamberët varroseshin aty ku vdisnin. Kështu, Hz. Pejgamberi u varros në dhomën e Hz. Aishes, aty ku kishte ndërruar jetë.

Përmbledhja e kapitullit

Medinja, e cila më përpara emërtohej Jethrib, ishte njëri prej qyteteve më të rëndësishme të zonës së Hixhazit. Si rezultat i Besëlidhjeve të Akabesë që arabët medinas kishin bërë me Hz. Pejgamberin, numri i muslimanëve që shkonin në Medine në grupe të vogla, u shtua. Në etapën e fundit, edhe Hz. Pejgamberi (s.a.s.) bëri hixhret.

Aktiviteti i parë i Pejgamberit tonë në Medine ishte të merrte vendim për ndërtimin e mesxhidit. Mesxhidi i Pejgamberit kishte shumë funksione sociale. Njëri prej tyre ishte të përdorej si vendadhurim. Ky ishte një vend ku muslimanët mblidheshin për të falur namazet e vaktit dhe të xhumasë. Po ashtu, ishte edhe një vend ku ushtrohej detyra e shpalljes hyjnore, aktivitetet e mësimdhënies-mësimnxënies, ku merreshin vendime të

rëndësishme dhe ku pranoheshin delegatët.

Pas rreth pesë muajsh nga arritja e tyre në Medine, u organizua një mbledhje, në të cilën morën pjesë kryetarët e familjeve të ardhur nga Meka (Muhaxhirët) dhe medinasit (Ensar). Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte parashtrimi i disa sugjerimeve konkrete mbi çështjen e përjetësimit në qetësi dhe harmoni në aspektin material dhe shpirtëror, si dhe vënia në zbatim e këtyre. Në këtë kontekst, Pejgamberi ynë i ftoi mekasit dhe medinasit në një bashkëpunim të sinqertë, ndërsa muhaxhirët dhe ensarët i bëri vëllezër.

Krahas vëllazërimit, Pejgamberi ynë kishte krijuar lidhjen ndërmjet muslimanëve dhe përpiqej të arrinte në ujdi edhe me hebrenjtë dhe arabët që jetonin në këtë qytet, por nuk ishin muslimanë. Qëllimi i tij ishte të mundësonte sigurinë e qytetit, si dhe të jetonte në harmoni me ta. Për këtë arsye bëri bisedime si me shokët e tij, ashtu edhe me elementët e tjerë që nuk ishin muslimanë. Më në fund arritën të bien dakord për formimin e një strukture qytet-shtet. Për këtë përgatitën një tekst, ku përfshiheshin parimet që risanksiononin shoqërinë e Medines. Në këtë tekst, i cili ishte një marrëveshje sociale, përfshiheshin marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe me të huajt, strukturat e tyre administrative dhe gjyqësore, liria fetare dhe ndërgjegjësore që zotëronin individët, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ndërkohë, vazhdonin marrëdhëniet edhe me idhujtarët mekas. Në kontekstin e këtyre marrëdhënieve u realizuan luftëra ose marrëveshje. Në të njëjtën mënyrë vazhduan edhe marrëdhëniet me hebrenjtë dhe me të krishterët.

Më pas u çlirua Meka, ndërsa në vijim, fisi Heuazin, i cili ishte një fis i fuqishëm, pranoi Islamin dhe bashkë me hyrjen e Arabisë Veriore nën sovranitetin e muslimanëve, me fushatën luftarake në vitin e 9 hixhri, nga çdo zonë e Arabisë filluan të vinin delegacione në Medine.

Qëllimet e këtyre delegacioneve, të cilat u mirëpritën nga Hz. Pejgamberi (s.a.s.), në përgjithësi ishin të informonin se qenë bërë muslimanë, se dëshironin të mësonin Islamin ose të kërkonin dikë që t'ua mësonte Islamin. Ai ishte sjellë mjaft mirë ndaj këtyre delegacioneve dhe u angazhua personalisht me mikpritjen e tyre.

Haxhi që Hz. Pejgamberi realizoi më vitin e 10 (m. 632), ka marrë emrin Haxhi i Lamtumirës, për shkak se në këtë haxh u përshëndet me shokët e tij dhe se nuk arriti ta vizitonte më Qabenë. Këtu ai ligjëroi përpara më shumë se njëqindmijë muslimanëve. Ky ligjërim u quajt si Hutbeja e Lamtumirës. Më 20 safer 11/27 maj 632, pak kohë pas Haxhit të Lamtumirës, Hz. Pejgamberi u sëmur. Në ditët e para të sëmundjes temperaturën e kishte shumë të lartë, por sapo temperatura i ulej, ai shkonte dhe printe namazet ndaj njerëzve. Kjo situatë vazhdoi kështu për disa ditë dhe, kur e kishte të pamundur të vazhdonte në prirjen e namazit, ngarkoi me këtë detyrë Hz. Ebubekrin. Pejgamberi i fundit, Muhammedi (s.a.s.), ndërroi jetë ditën e hënë, më 13 rebiuleuuel /8 qershor.

Të rishikojmë kapitullin

1. Si ishte gjendja e Medines para hixhretit? Shpjegojeni shkurtimisht.
2. Si e mikpritën Hz. Pejgamberin muslimanët medinas?
3. Me ç'qëllim është ndërtuar Mesxhidi i Pejgamberit?
4. Ç'lloj sanksionesh u vendosën, me qëllim që të shtohej dashuria dhe solidariteti ndërmjet muslimanëve mekas dhe atyre medinas?
5. Cilat janë kriteret thelbësore të hutbesë që realizoi Hz. Pejgamberi gjatë haxhit? Shpjegojini.

Pyetje vlerësuese

1. Cili është emri i vjetër i "Medines"?

A) Eus
B) Kurajdha
C) Jethrib
D) Hazrexh

2) Kush ishte sahabiu që priti si mysafir Hz. Pejgamberin për herë të parë në Medine?

A) Ebu Ejjub el-Ensari
B) Zejd b. Harithe
C) Mus'ab b. Umejr
D) Hz. Ebubekir

3) Cili është kuptimi i fjalës "Suffe"?

A) Emri i një mesxhidi
B) Emri i një fisi
C) Shtëpia e Hz. Muhammedit
D) Një pjesë e Mesxhidit të Pejgamberit

4) Si quhen ata që migruan nga Meka në Medine?

A) Ensar
B) Kajnuka
C) Eus
D) Muhaxhir

5) Cila luftë nuk është realizuar kundër idhujtarëve mekas?

A) Bedir
B) Uhud
C) Kajnuka
D) Hendek

6) Kur u bë musliman Ebu Sufjani?

A) Pas luftës së Bedirit
B) Pas luftës së Uhudit
C) Pas luftës së Hendekut
D) Gjatë çlirimit të Mekës

7) Në cilin vit e ka plotësuar Hz. Pejgamberi detyrën e haxhit?

A) 629
B) 630
C) 631
D) 632

pejgamberi im

KAPITULLI

4

Personaliteti i Hz. Muhammedit dhe të qënit e tij shembull

1. Hz. Muhammedi në Kur'an
2. Hz. Pejgamberi si shembull për të kuptuar Islamin
3. Morali shembullor i Hz. Pejgamberit

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Në këtë kapitull trajtohen aspekte të ndryshme që lidhen me Pejgamberin tonë. Duke u nisur nga Kur'ani, këtu janë përfshirë të dhëna në lidhje me të. Të qenët të tij shembull është treguar pikërisht me vepra konkrete nga jeta e tij, të shoqëruara edhe nëpërmjet komentimeve të ndryshme.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni lexuar këtë kapitull, do të mund të:

1. Radhisni ajetet që e cilësojnë Pejgamberin tonë si një njeri.
2. Radhisni ajetet që e cilësojnë Muhammedin (s.a.s.) si një Pejgamber.
3. Vini re sjelljen delikate të Hz. Pejgamberit me njerëzit.
4. Rendisni parimet që merr për bazë ai në sjelljet e tij.
5. Shpjegoni se përse Hz. Pejgamberi konsiderohet "el-emin".
6. Jepni shembuj nga sjelljet e Hz. Pejgamberit.
7. Shpjegoni një fjalë të Hz. Pejgamberit që tregon vlerën e kohës.
8. Shpjegoni se në cilat situata ka dhënë këshilla Hz. Pejgamberi.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Mendoni vazhdimisht nëse i keni arritur qëllimet që janë cituar në fillim të kapitullit. Rilexoni çështjet që lidhen me ato qëllimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Në fund të tij jepet një listë e pasur bibliografie. Analizoni veprat që mund të siguroni nga kjo listë.
3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe bartini ato në mjediset mësimore.

1 Hz. Muhammedi në Kur'anin Famëlartë

Nën këtë titull trajtohet çështja e Pejgamberit tonë të dashur, të treguar si njeri dhe si Pejgamber.

Aspekti njerëzor

Kur'ani Famëlartë, ndërsa thekson faktin se Pejgamberi ynë ishte një njeri, thekson se veçoria më e rëndësishme që e dallon atë nga njerëzit e tjerë, është të marrë shpallje nga Allahu. Ajetet e mëposhtme aludojnë pikërisht mbi këtë çështje:

"Thuaj: 'Unë nuk jam tjetër, veçse njeri - i dërguar!"' *(Isra, 17/93)*

"Thuaj: 'Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm..."' *(Kehf, 18/110)*

"Thuaj (o Muhammed!): 'Në të vërtetë, unë jam vetëm një njeri si ju. Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i Vetëm..."' *(Fussilet, 41/6)*

Le të mendojmë

Përse Kur'ani Famëlartë e vë theksin mbi aspektin njerëzor të Hz. Pejgamberit?

Kur'ani Famëlartë bën të ditur se Hz. Pejgamberi ishte një person që zotëronte veçori të një njeriu normal dhe se nuk mbahej si i ndryshëm nga të qenët njeri. Kjo situatë shprehet sidomos me "vdekshmërinë", e cila është veçoria e përbashkët e çdo qenieje të krijuar.

"Para teje Ne nuk e kemi bërë asnjë të pavdekshëm. Nëse ti vdes, a do të mbesin ata të përjetshëm?! Çdo njeri do ta shijojë vdekjen!.." *(Enbija, 21/34-35)*

"Sigurisht që ti (o Muhammed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin." *(Zumer, 39/30)*

Fakti që Hz. Pejgamberi ishte njeri, qe bërë shkak që idhujtarët të mos besonin se ai ishte Pejgamber dhe ta kritikonin vazhdimisht, duke i thënë se ishte si gjithë të tjerët. Sa i përket kësaj çështjeje, në Kur'anin Famëlartë thuhet:

"Njerëzit nuk i pengoi asgjë të besojnë, kur u erdhi shpallja, përveç thënies: 'A mos vallë, Allahu ka sjellë si të dërguar një njeri?' Thuaj: 'Sikur në Tokë të kishte melekë që ecnin qetësisht, Ne do t'u çonim atyre nga qielli një melek si të dërguar.'" *(Isra, 17/94-95)*

"Gjithashtu, ata thonë: 'Ç'është ky i dërguar që ha ushqim dhe shëtit nëpër tregje?! Përse nuk i është dërguar atij një melek e të bëhet me të paralajmërues? Ose, përse nuk i është zbritur një thesar apo të kishte një kopsht, nga i cili të ushqehej?!' Të padrejtët thonë: 'Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur!' Shiko çfarë shembujsh të sjellin ata (me këtë) dhe kanë humbur e nuk mund të gjejnë rrugën e vërtetë. Qoftë i lartësuar Ai, i Cili, nëse do, mund të të japë gjëra më të mira se këto, kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe të bëjë për ty pallate." (*Furkan, 25/7-10)*

Është radha juaj

Sa i përket shpalljes hyjnore dhe përjetësimit të vajit, cili qe ndikimi që pati fakti që Hz. Pejgamberi ishte njeri?

Aspekti i profetësisë

Pejgamberi ynë e ka treguar Islamin në periudhën e profetësisë njëzetetrevjeçare. Në të njëjtën kohë, duke i zbatuar ato që ka treguar, është bërë shembull ndaj njerëzve. Ndërsa realizonte këtë detyrë, kishte ditur të rezistonte ndaj kushteve të vështira dhe të rënda, duke vepruar me një vendosmëri dhe durim të madh. Kufijtë e detyrës së tij të profetësisë janë përcaktuar mjaft qartë në Kur'anin Famëlartë:

"O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve..." *(Maide, 5/67)*

"... i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë qartazi." *(Ankebut, 29/18)*

Siç kuptohet nga ajetet e mësipërme, detyra e Hz. Pejgamberit është "shpallja hyjnore". Ai ishte ngarkuar me detyrë që të përcillte ndaj njerëzve shpalljen hyjnore të marrë nga Allahu.

"Ti je vetëm paralajmërues. Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues." *(Fatir, 35/23-24)*

Hz. Pejgamberi është një paralajmërues.

"Edhe para teje ne kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve u kemi dhënë shpallje, andaj pyetini dijetarët e Librit, nëse nuk e dini (këtë). (Të dërguarit i çuam) me prova të qarta dhe libra. Ndërsa ty (o Muhammed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë." *(Nahl, 16/43-44)*

Siç citohet në ajetin e mësipërm, Hz. Pejgamberi është udhërrëfyes dhe udhëtregues. Në përgjithësi, ajetet kanë si veçori dalluese detyrën e Pejgamberit tonë të dashur si profet për të udhërrëfyer njerëzit, si dhe për të qenë shembull i bukur ndër ta.

Në Kur'an citohet edhe se ç'kritere duhet të ketë parasysh gjatë kryerjes së kësaj detyre, pasi ai ishte ngarkuar me detyrën e Pejgamberit. Për shembull, në lidhje me faktin se nuk duhet të bëjë asnjë dallim mes njerëzve dhe se nuk duhej të lëndonte njerëzit, urdhërohet kështu:

"Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij! Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty. Nëse ti i dëbon ata, atëherë do të jesh keqbërës." *(En'am, 6/52)*

Përgjegjësia e çdo njeriu i përket vetë atij. Të jesh Pejgamber nuk do të thotë të bëhesh ortak në përgjegjësitë e njerëzve. Çdokush është përgjegjës për ato që dëgjon dhe që sheh. Duke u rikujtuar edhe kjo situatë në Kur'an, për njerëzit që mbyllin veshët ndaj atyre që shpall Pejgamberi, bëhet e ditur edhe se mund të mërzitet me ndjeshmërinë e një njeriu, por përtej kësaj nuk do t'u krijojë dobi, për sa kohë nuk ndryshojnë situatat e tyre.

Ajeti i mëposhtëm tregon pikërisht këtë situatë: "... Sa për atë që është i pasur, ti po i kushton vëmendje atij, megjithëse nuk ke përgjegjësi nëse ai nuk dëshiron të pastrohet." *(Abese, 80/5-7)*

Le të mendojmë

Ç'mund të ketë ndier Hz. Pejgamberi kundrejt njerëzve që nuk besonin në shpalljet e tij?

Në një ajet tjetër theksohet se mohimi dhe rebelimi i idhujtarëve të ftuar në Islam është ndaj ajeteve të Allahut dhe këshillohet që Pejgamberi ynë të mos lëndohet:

"Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut! Edhe para teje (o Muhammed!), shumë të dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin (që kanë pësuar), derisa u ka ardhur ndihma Jonë, sepse askush nuk mund t'i ndryshojë vendimet e Allahut. Ti tashmë ke dëgjuar për ata të dërguar. Nëse ty të duket e rëndë për t'u mbajtur përbuzja e tyre, atëherë kërko - nëse mundesh - një zgavër në tokë ose shkallë në qiell, që t'u sjellësh atyre një mrekulli! Sikur Allahu të donte, do t'i kishte mbledhur ata në rrugë të mbarë, prandaj mos u bëj nga ata që nuk e dinë këtë!" *(En'am, 6/33-35*

Ndërsa fakti që Pejgamberi ynë i do shumë njerëzit dhe që sillet shumë i mëshirshëm e i duruar me to, se kjo dashuri e tyre nuk do të mjaftojë që ata ta shohin këtë të vërtetë dhe ta pranojnë, se individët janë përgjegjës për besimet dhe bëmat e tyre me vullnetin e tyre të lirë, jepet nëpërmjet ajeteve të mëposhtme:

"Vërtet, ti (Muhammed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar." *(Kassas, 28/56)*

"(Thuaju o Muhammed): 'Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj."' *(En'am, 6/104)*

"Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij." *(Fussilet, 41/46)*

"Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do të bartë barrën e tjetrit. Nëse i ngarkuari rëndë thërret dikë për ndihmë, nuk do t'i merret asgjë nga barra, edhe sikur të jetë i afërt. Në të vërtetë, ti paralajmëron vetëm ata që i frikësohen Zotit të tyre në fshehtësi dhe që falin namazin. Kush e pastron veten (nga gjynahet), në të vërtetë e ka për dobinë e vet, ndërsa kthimi është tek Allahu." *(Fatir, 35/18)*

Le të mendojmë

Ç'kuptim ka fakti që në Kur'anin Famëlartë theksohet qoftë aspekti njerëzor i Hz. Pejgamberit, ashtu edhe aspekti profetik i tij?

2 Hz. Pejgamberi si shembull për të kuptuar Islamin

Siç e përmendëm edhe më sipër, njëra prej veçorive dalluese të profetësisë së Hz. Pejgamberit është të jetë shembull me jetesën e tij. Jetesën e Hz. Pejgamberit, Allahu i Lartmadhëruar ua ka paraqitur njerëzve si një tërësi dhe e tregon atë si shembull për ta. Ky kriter është shpjeguar disa herë në Kur'anin Famëlartë dhe është theksuar rëndësia e respektimit dhe e marrjes shembull të tij:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun." *(Ahzab, 33/21)*

Përveç kësaj, bindja ndaj Hz. Pejgamberit, dashuria e shprehur ndaj tij dhe marrja e tij si shembull është konsideruar si kushti paraprak i bindjes ndaj Allahut dhe shenjë e kësaj bindjeje:

"Thuaju (o Muhammed): 'Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.'" *(Al-i Imran, 3/31)*

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre." *(Nisa, 4/80)*

Shembulli i Hz. Pejgamberit në kryerjen e adhurimeve

Le të mendojmë

Cilat lloje sjelljesh mund të cilësojmë si adhurime?

Adhurimi, në kuptimin e gjerë të fjalës, mund të shpjegohet si nënshtrimi i njeriut ndaj Tij kundrejt mirësive të pafund që Allahu u jep njerëzve, njohja e autoritetit të Tij dhe plotësimi i të gjitha këshillave që jep. Pra, adhurimet janë veprime që realizohen për të fituar pëlqimin e Allahut.

Sipas këtij shpjegimi, çdo gjë që përfshihet në përmbledhjen e adhurimit, bart një vlerë vetëm dhe vetëm nëse realizohet duke pasur si synim pëlqimin e Allahut. Kjo bëhet e mundur me rregullimin e gjithë jetës sipas parimit të teuhidit. Gjithçka duhet ta bëjmë duke marrë për bazë njëjësinë e Allahut. Dikush që e ndien nga thellë këtë, mundohet të fitojë kënaqësinë e Allahut në marrëdhëniet me njerëzit dhe me qeniet e tjera.

Në ajetet e mëposhtme aludohet ky kriter në lidhje me kryerjen e adhurimeve për të fituar kënaqësinë e Allahut:

"Njëmend, Ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën. Andaj adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të. Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: 'Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu', Allahu me siguri që do t'i gjykojë për mospajtimet që kanë pasur. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar e mohues." *(Zumer, 39/2-3)*

"Thuaj: 'Unë jam urdhëruar që ta adhuroj Allahun me përkushtim të sinqertë. Unë jam urdhëruar të jem i pari nga ata që i nënshtrohen Atij.' Thuaj: 'Unë i trembem vërtet dënimit të Ditës së Madhe, nëse nuk i bindem Zotit tim.' Thuaj: 'Vetëm Allahun e adhuroj me besimin tim të plotë e të sinqertë."' *(Zumer, 39/11-14)*

A e dini?

Sa i përket rrugës së ndjekur, mënyrës dhe kriterit të plotësimit të adhurimeve në Kur'anin Famëlartë, është vënë theksi mbi shembullin e Pejgamberit tonë. Duke iu veshur këto kritere Pejgamberit tonë, këshillohet që të bëjë udhërrëfim në këto çështje.

Koncepti i adhurimit, së pari është njësuar me adhurime si namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi dhe, kur thuhet adhurim, fillimisht na vijnë në mendje pikërisht këto. Nuk duhet të harrojmë se feja jonë e lartë, Islami, pranon si adhurim çdo sjellje të bukur që bëhet duke u pranuar si adhurim dhe ibadet. Adhurimet që kërkohen të kryhen në mënyrë të vazhdueshme forcojnë lidhjen shpirtërore mes Allahut dhe njeriut; e orientojnë njeriun të jetë gjithmonë i vetëdijshëm dhe të ketë parasysh kuptimin e jetës së tij. Edhe në realizimin e këtyre adhurimeve Kur'ani Famëlartë thekson shembullin dhe udhërrëfimin e Hz. Pejgamberit:

"Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut." *(Ta-ha, 20/132)*

"Lexo (o Muhammed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kur'anit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni." *(Ankebut, 29/45)*

Shembulli i Hz. Pejgamberit në marrëdhënie me njerëzit

Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.), sillej me shumë kujdes me njerëzit. Ishte i mirësjellshëm, i mirëkuptueshëm dhe delikat ndaj njerëzve me të cilët jetonte. Kur njerëzit që kishte përreth nuk silleshin në përputhje me rregullat e mirësjelljes, kërkonte

rrugët e përshtatshme për t'i rregulluar këto sjellje të tyre. Me qëllim që njerëzit që do të kritikonte të mos lëndoheshin, kritikat nuk i bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë, por tërthorazi.

Nuk i vlerësonte njerëzit sipas nivelit social apo ekonomik në të cilin gjendeshin, por si robër të barabartë që ka krijuar Allahu. Kërkesat e ardhura nga krerët e Kurejshit, sipas të cilave ai duhej të bënte dallime ndërmjet njerëzve, si dhe mënyra e tij e sjelljes janë shpjeguar në ajetin e mëposhtëm:

"Thuaj: 'Unë kam provë të qartë nga Zoti im, por ju e përgënjeshtroni atë. Ajo që ju kërkoni me nxitim, nuk është në pushtetin tim. Vendimi i takon vetëm Allahut. Ai e shpall të vërtetën dhe Ai është Gjykatësi më i mirë". *(En'am, 6/52)*

Hz. Pejgamberi, në qëndrimet dhe sjelljet që paraqiti në marrëdhëniet ndërnjerëzore, ka vepruar në kuadër të parimeve të përcaktuara në Kur'an.

Për Pejgamberin, drejtësia ishte një parim i pazëvendësueshëm në jetesën paraprofetike, gjë që paralajmërohet nëpërmjet urdhëresës në suren Hud: "...Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar" *(Hud, 11/12)*. Nëpërmjet fjalisë: "Jini të drejtë, orientojini njerëzit drejt së drejtës!" *(Ibn Hanbel, IV, 231)*, shprehet se nuk është e mjaftueshme që ata të jenë të drejtë, por se janë përgjegjës për të mbështetur njëri-tjetrin. "Ngjituni pas së drejtës (mos u largoni nga ajo), sepse drejtësia të çon në mirësi; sa më shumë personi të flasë drejt, aq më shumë edhe shënohet si i drejtë tek Allahu. Ndërsa fjalëdrejtët dhe vepërmirët janë në xhennet. Duke urdhëruar: "(Shmanguni nga gënjeshtra) Gënjeshtra të çon tek e keqja, ndërsa e keqja në xhehennem..." *(Buhari, Edeb, 69; Muslim, Bir, 103)*, ka dhënë sinjalet në lidhje me burimet e sjelljeve të mira dhe të këqija, si dhe ka paralajmëruar njerëzit mbi këtë çështje. Vetë ai, gjatë gjithë jetës ka qenë i drejtë dhe në këtë aspekt është bërë shembull për njerëzit.

Një kriter tjetër që aludohet në Kur'an dhe që tregon se Pejgamberi ynë është shembull ndaj njerëzve, qoftë me fjalë, ashtu edhe me sjellje, është të qenët me karakter të butë. Me fjalët: "Dikush që zemërohet (por nuk nxehet), që tregon butësi dhe duron, fiton dashurinë e Allahut." *(Ali Nasif, et-Taxh, V, 177)*, i ka ftuar njerëzit të jenë të butë.

Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.) ka urdhëruar: "Allahu është i butë dhe do butësinë e mirësinë në çdo punë" *(Muslim, Bir, 77)*. Përveç kësaj, edhe kur thotë: "I fuqishëm nuk quhet ai që mund të tjerët, por ai që përmbahet kur është i zemëruar" *(Buhari, Edeb, 76; Muslim, Bir, 107)*, shpreh vështirësinë e të qenit me karakter të butë; por, njëkohësisht tregon se kjo ia vlen dhe se njerëzit duhet të luftojnë ndaj nefsit të tyre për ta përfituar këtë. Madje, u ka treguar udhën njerëzve edhe në çështjen e ballafaqimit me zemërimin dhe ka urdhëruar: "Kur dikush të nxehet, nëse është më këmbë, menjëherë të ulet; nëse i kalon zemërimi, mirë, përndryshe duhet të shtrihet" *(Ebu Dau'ud, Edeb, 4)*.

Modestia është një pikë tjetër themelore e sjelljeve të Pejgamberit tonë. Sipas kësaj: "Dikush që mburret qoftë edhe sa një thërrime, nuk do të hyjë në xhennet. Një burrë tha: "O Rasulullah, njeriu kërkon që të ketë veshje dhe këpucë të bukura." (Rasulullahu) urdhëroi: "Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Ndërsa mburrje do të thotë të mohosh të vërtetën dhe të përçmosh njerëzit" *(Muslim, Iman, 147)*. Pra, mirësitë që Allahu u ka dhuruar, nuk duhen konsideruar nga njerëzit si mjet madhështie ndaj njëri-tjetrit, por me modesti dhe në një mënyrë që do t'i pëlqejë Allahut. Hz. Pejgamberi, i cili sillej mjaft modest, qoftë ndaj të rriturve, ashtu edhe ndaj të vegjëlve, si ndaj të pasurve, ashtu edhe ndaj të varfërve, me këshillën e tij: "Allahu më urdhëroi që të jeni modestë! Aman, askush të mos i mburret askujt, askush të mos bëjë mizori ndaj askujt!" *(Muslim, Xhennet, 64)*, ka shpjeguar se sa gabim është të lëvdohesh dhe të mburresh.

Me fjalët e tij: "Nuk tregohet mëshirë dhe dhembshuri ndaj atij që nuk tregon mëshirë dhe dhembshuri!" *(Buhari, Edeb, 18)*, e ka vënë theksin mbi parimin e mëshirës e dhembshurisë dhe na ka kujtuar se duhet të sillemi në mënyrë të mirëkuptueshme në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Një sjellje tjetër që rekomandon Kur'ani është të qenët i drejtë:

"O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe dëshmoni me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që bëni ju." *(Maide, 5/8)*

Edhe Pejgamberi ynë, me sjelljet që ka paraqitur në jetën e tij, është bërë shembull ndaj besimtarëve sa i përket kësaj çështjeje.

Pejgamberi ynë, duke vepruar me masën dhe kriterin që sjell ajeti: "Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë! Pa dyshim, Allahu llogarit çdo gjë" *(Nisa, 4/86)*, ka përshëndetur me selam të gjithë, të vegjël apo të rritur; ka theksuar të qenët mikpritës, nëpërmjet parimit të mirësjelljes, si themeli i marrëdhënieve shoqërore dhe është bërë shembull në këtë çështje.

Në çdo çështje merret për bazë masa dhe kriteri i caktuar. Hz. Pejgamberi, si domosdoshmëri e ajetit: "Mos ji dorështrënguar, por mos ji as krejtësisht dorëshpuar. Më pas qortohesh dhe mbetesh krejt i pashpresë" *(Isra, 17/29)*, e ka vënë theksin mbi sjelljen e tij dhe është bërë shembull për këtë.

Parimet e sjelljeve të moralshme që kërkohen të nxirren në pah në kuadër të ajeteve dhe haditheve nuk janë të kufizuar vetëm me kaq. Një pjesë e tyre është trajtuar në çështjen "Morali shembullor i Hz. Muhammedit".

Të studiojmë - Të mësojmë

Duke u nisur nga përmbajtja e haditheve, zbuloni se në cilat pika tregonte kujdes Hz. Pejgamberi sa u përket marrëdhënieve ndërnjerëzore.

Si duhet ta marrim shembull Pejgamberin tonë (Të imitojmë apo të marrim shembull)

Le të mendojmë

Cili është dallimi ndërmjet imitimit dhe marrjes shembull?

Njëri prej kritereve më të rëndësishme të të nxënit është shembulli dhe marrja e shembullit. Në mënyrë që njerëzit të mësojnë mbi një sjellje të caktuar, është e nevojshme që të shohin se si kryhet ajo sjellje

A e dini?

Shembulli është një kriter i rëndësishëm në formimin dhe forcimin e sjelljes së dëshiruar, si dhe në eliminimin e sjelljes së padëshiruar.

Mesxhidi Nebevi

Edhe Pejgamberi ynë, qoftë në periudhën e tij, qoftë në periudhat pasuese, me personalitetin e tij është bërë shembull për ata që i besonin. Kur themi se duhet të merret shembull Hz. Pejgamberi, duhet të kemi parasysh modelimin e mënyrave të sjelljeve që ai mundohet të ndryshojë dhe të zhvillojë te njerëzit. Parashtrimi i sunnetit të tij në jetesën tonë do të thotë ta modelosh atë. Të respektosh sunnetin e tij nuk do të thotë të bartësh veçoritë karakteristike të periudhës së tij për t'i zbatuar në ditët tona. Kur merret si shembull, përveç mënyrave që

karakterizojnë rrethanat e asaj periudhe, gjithashtu duhet të mbahen parasysh shkaqet dhe objektivat që qëndrojnë në themel të këtyre sjelljeve. Duhet të merren si shembull drejtësia, dashuria, respekti, paqja, toleranca, butësia, të qenët punëtor dhe i zellshëm, pastërtia etj.

Në çdo vend të botës, drejtësia dhe paqja janë vlera dominuese. Duhet të mos jemi indiferentë ndaj kësaj situate në marrjen shembull të Pejgamberit. Pra, me qëllim që fjalët që ka thënë dhe sjelljet që ka kryer të kuptohen e të zbatohen drejt, duhet të mbahen parasysh shkaqet dhe kushtet e thënies ose të zbatimit të atyre fjalëve a sjelljeve. Për shembull, kujdesi ndaj higjienës së gojës mund të jepet si një shembull që këshillohet të kryhet bashkë me namazin *(Buhari, Xhum'a, 8; Muslim, Taharet, 42)*. Kriteri që mundohet të formojë ai në këtë kontekst është një pjesë e shprehisë së pastrimit të përgjithshëm. Sepse sipas tij, pastërtia buron nga besimi. Vallë a ka dhënë një informacion kushtëzues në lidhje me rrugët dhe metodat se si mund ta fitojmë këtë shprehi ose në lidhje me mjetet që duhen përdorur? Jo! Atëherë mjetet dhe përbërësit që përdoren për marrjen e kësaj shprehie (zakoni) duhet të jenë plotësisht të lidhura me strukturën kulturore dhe ekonomike të shoqërisë. Ndërkohë që mjeti më i përshtatshëm në atë periudhë ishin degët e pemës së "misvakut", në ditët e sotme, krahas misvakut ka furça dhe pasta dhëmbësh, që mund të dizajnohen në forma të ndryshme dhe që mund të përdoren në bazë të këshillave të dentistëve. Pra, nuk duhet të marrim si shembull përdorimin e misvakut nga Hz. Pejgamberi, por faktin që ai i ka kushtuar rëndësi pastërtisë së dhëmbëve.

Përveç kësaj, nuk duhet të harrojmë se, qoftë në adhurime e qoftë në fushat e tjera të jetës, ai është munduar të jetë sa më i thjeshtë. Si një Pejgamber që thotë se Allahu kërkon nga robërit e tij të lehtën dhe të thjeshtën e jo vështirësinë *(Maide, 5/6; Haxh, 22/78; Ahzab, 33/38)*, ka këshilluar që të parapëlqejmë të lehtën nga dy rrugë që hasim. Në lidhje me të ka një transmetim të tillë: Në çlirimin e Mekës, te Pejgamberi erdhi një burrë dhe i tha: "Unë kam vënë si kusht vetes që të fal namaz në Bejtu'l-Makdis, nëse Allahu të mundëson ty çlirimin e Mekës." Pejgamberi ynë iu përgjigj: "Është më e virtytshme të falësh namaz këtu." Po ashtu, bashkëshortja e Hz. Pejgamberit, Mejmune, i tha: "O Rasulullah! Unë kam vënë si kusht vetes të fal namaz në Bejtu'l-Makdis, nëse Allahu të mundëson ty çlirimin e Mekës." Pejgamberi ynë ia ktheu: "Ty nuk të mjafton forca për këtë." Pas kësaj, kur Mejmuneja i tha: "Shkoj me roje para dhe pas meje," ky ia ktheu: "Ty nuk të mjafton forca për këtë. Dërgo vaj që të ndizet në Bejtu'l-Makdis. Kështu është njësoj sikur të kesh vajtur atje." Pas kësaj transmetohet se Mejmune ka dërguar çdo vit para vaji në Kudus për ndezjen e kandilave *(Uakidi, II, 866)*. Pejgamberi ynë, edhe me fjalën: "Kudo ku ka lehtësi, atje ka bukuri. Çdo vend ku nuk ka lehtësi është i shëmtuar" *(Muslim, Bir, 77)* e vë theksin mbi parimin e lehtësisë.

Është radha juaj

Tregoni se cilat sjellje të Hz. Pejgamberit merrni ju si shembull.

3 Morali shembullor i Hz. Pejgamberit

Në kuadër të kësaj çështjeje, duke u trajtuar disa shembuj nga jeta e Hz. Pejgamberit, janë dhënë kritere në lidhje me moralin e tij dhe janë bërë komente se si duhet të pasqyrohen këta shembuj në jetën tonë.

Le të mendojmë

Kujt dhe përse i besoni? Përse i është dhënë Hz. Pejgamberit nofka e "të besuarit"?

Të qenët i besueshëm

Hz. Pejgamberi, para së gjithash, ishte një person që bartte cilësimin "Emin". Ishte një njeri, të cilit i besonin dhe një person i sigurt në vetvete *(Ibn Sa'd, I, 156)*.

Kur erdhi ajeti: "... Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm!" *(Shuara, 26/214)*, ai u ngjit në kodrën Safa dhe pyeti: "O bashkësia e Kurejshit! Nëse unë ju them se pas kësaj kodre ka ardhur dhe ka ngritur garnizon një ushtri armike, e cila dëshiron të pushtojë qytetin, a do më besonit?", ata që gjendeshin atje iu përgjigjën: "Po, ne nuk dimë të na kesh gënjyer ndonjëherë." *(Ibn Sa'd, I, 200)*.

A e dini?

Pika ku bashkohen të gjithë, besimtarët dhe jobesimtarët, lidhet me faktin që Hz. Pejgamberi ishte person i drejtë dhe i besueshëm, pra "emin". Ai ishte më i besueshmi në shoqërinë brenda së cilës jetonte. Ngaqë kjo veçori e tij dihej nga të gjithë, personat që shkonin në udhëtime të gjata, ia dorëzonin atij sendet me vlerë.

Po ashtu, dikush që dëshironte të kishte fitime të mbara në tregti, drejtohej pikërisht tek ai. Ngaqë ai ishte i drejtë, nuk humbiste asgjë nga të ardhurat e karvanit, të ardhurat e fituara ia bënte të ditur pronarit të karvanit në mënyrën më të bukur *(Sarıçam, 2003, 78)*.

Të qenët e Pejgamberit i besueshëm ka pasur një rol të madh edhe në përhapjen e Islamit dhe në dominimin e tij. Është e pamundur që rreth një njeriu, i cili nuk është i besueshëm, të mblidhen kaq shumë përkrahës. Me këtë veçori të tij, Hz. Pejgamberi është bërë model ndaj njerëzve. Në çdo shtresë të shoqërisë dhe në çdo fushë të jetës, ndjenja e besimit zë një vend të rëndësishëm. Njerëzimi mund të arrijë në rezultate të suksesshme vetëm nga forca e besimit dhe e ndjenjës, nga marrëdhëniet ndërnjerëzore e deri tek marrëdhëniet ndërshtetërore, nga arsimi e deri tek ekonomia. Ndjenja e besimit është një ndjenjë që përfitohet me vështirësi dhe që humbet me lehtësi. Prandaj, përpjekja për të fituar besimin e njerëzve është një përpjekje e vyer. Mirëpo kjo duhet të jetë e vazhdueshme. Sepse imani që humbet për shkak të neglizhimeve të ndryshme, nuk mund të fitohet më lehtësisht. Në këtë çështje duhet të marrim si shembull Pejgamberin tonë dhe në çdo situatë dhe kusht të kryejmë veprime që do të sjellin si rezultat besimin e njerëzve ndaj nesh.

Është radha juaj

Ç'lidhje ka mes faktit që Hz. Pejgamberi ishte i besueshëm dhe përhapjes së Islamit? Jepni shembuj.

Të qenët i durueshëm

Hz. Pejgamberi ka parashtruar një model të rëndësishëm sjelljeje, duke e bërë jetën të jetueshme, pasi u jepte kuptim ngjarjeve me të cilat përballej dhe merrte vendime të drejta. Ky model është durimi. Durimi ose sabri është një lloj sjelljeje që përjetohet në raport të drejtë me reagimin që jepet në çastin e parë kur përballemi me diçka. Ngjarja e mëposhtme dhe fjala e Pejgamberit tonë në lidhje me "durimin" do t'ju ndihmojë ta kuptoni më mirë këtë:

Kur Hz. Pejgamberi urdhëroi një grua që qante pranë një varri: "Ki frikë nga Allahu dhe duro!", ajo i tha: "Më lër të qetë, ajo që më ka ndodhur mua nuk të ka ndodhur ty." Më pas, kur kësaj gruaje i thanë se ky person ishte Hz. Pejgamberi, ajo vajti pranë tij dhe i kërkoi falje, ngaqë nuk e kishte njohur kush ishte. Hz. Pejgamberi urdhëroi: "Durimi është vetëm në çastin kur përballesh me një fatkeqësi." *(Buhari, Xhenaiz, 32, 43)*

Sjelljet e padurueshme në përgjithësi janë sjellje, mbi të cilat nuk mendojmë shumë, që realizohen në mënyrë të papritur dhe që në shumicën e rasteve lidhen me ndjeshmërinë: si për shembull, të shprehësh zemërimin duke bërtitur dhe duke klithur, duke goditur a duke thyer diçka. Këto sjellje mërzisin jo vetëm atë që i kryen, por edhe atë ndaj të cilit ushtrohen. Ndërkohë, në sjelljet që shfaqen duke shprehur durim, në përgjithësi nuk përfshihen reagimet e çastit, por masa të matura dhe të logjikshme: Njeriu që kontrollon zemërimin mundohet që të mos thotë një fjalë, për të cilën më pas do të pendohet, të mos shprehë një sjellje, për të cilën do të dëshpërohet. Ja, pra, durimi fillon që në këtë pikë.

Zemërimi dhe të nxehurit bëhet pengesë që njeriu të mendojë drejt dhe ndikon te aftësia e vendimmarrjes. Duke u nisur nga kjo, kur njeriu mendon për reagimin e parë që ka shprehur, pendohet, por e di se shumicën e rasteve kjo nuk ka më kthim pas, edhe nëse ka, kurrë nuk do të jetë si më parë. Si rrjedhojë, Hz. Pejgamberi ka bërë të ditur se personi që kontrollon nefsin në çastin kur është i mërzitur, është pehlivan në kuptimin e plotë të fjalës *(Buhari, Edeb, 76; Muslim, Bir, 107)*.

Përveç kësaj, Pejgamberi ynë, krahas vështirësive që lidheshin me detyrën e tij, ka përjetuar edhe shumë dhimbje si njeri. Përveç Hz. Fatimesë, të gjithë fëmijët i ka humbur sa ishte gjallë. Hz. Pejgamberi është pikëlluar shumë në të tilla raste, madje ka derdhur dhe lot. Çështjen e durimit ndaj një dhimbjeje të tillë, siç është vdekja, e shpreh edhe Hz. Ibrahimi, i cili, duke u kthyer nga mali përballë tha: "O mal! Po të të kishte ndodhur ty ajo që më ndodhi mua, do të shembeshe dhe do të zhdukeshe. Mirëpo ne, ashtu siç urdhëron Allahu, 'jemi robërit e Allahut dhe tek Ai do të kthehemi, falënderimi i përket Allahut!'" *(Belazuri, I, 452)*.

Po ashtu, Hz. Pejgamberi ka treguar durim ndaj gjitha mundimeve dhe vuajtjeve që i janë bërë gjatë realizimit të detyrës së shpalljes hyjnore dhe kurrë nuk ka mallkuar. Madje, edhe pas vizitës së Taifit, e cila ishte një përvojë mjaft e dhimbshme për të, është sjellë në përputhje me realitetin se Allahu e ka dërguar atë si mëshirë ndaj botëve *(Enbija, 21/107)* dhe kurrë nuk ka mallkuar.

A e dini?

Hz. Pejgamberi ka treguar nga përvoja personale se të durosh nuk është sjellja e pritjes ose e këmbënguljes pa bërë gjë, por është një proces i vyer, që nevojit një përpjekje të sinqertë për përmirësimin e kushteve dhe për rregullimin e situatës.

Hz. Pejgamberi nuk është dorëzuar kurrë përballë situatave të ndryshme, duke na mësuar se, të durosh është diçka e vështirë, por se rezultatet e të duruarit të çojnë drejt qetësisë dhe se është një mësim që zhvillon dhe afirmon shpirtin. Ndër parimet kryesore që sugjeron për formimin dhe forcimin e kësaj sjelljeje është të qenët vazhdimisht i gatshëm për të mësuar. Sepse padituria e hedh njeriun në kthetrat e zemërimit, e shtyn atë drejt kompleksiteteve, e bën që të kuptojë anën e brendshme të ngjarjeve, në vend që të interesohet në mënyrë sipërfaqësore për mënyrat e realizimit të tyre dhe, si përfundim, të mos marrë vendime të rëndësishme. Prandaj, ne, që kemi mundësinë të marrim si shembull Pejgamberin tonë (s.a.s.), jemi në gjendje edhe të mësojmë se si ai i ka pritur me durim të madh vështirësitë me të cilat është përballur dhe se kur ka vepruar kështu, cilat parime ka marrë për bazë.

Të studiojmë - Të mësojmë

Shqyrtoni shembujt që lidhen me durimin e Hz. Pejgamberit dhe tregoni mendimet që lindin prej tyre.

Përdorimi i duhur i kohës

Edhe sa i përket përdorimit të duhur të kohës duhet të kemi parasysh Hz. Pejgamberin, i cili ka aplikuar në jetën e tij parimet e Kur'anit. Së pari, të shohim se ç'thotë Kur'ani sa i përket kësaj çështjeje. Në Kur'an, "Koha" është diçka e vyer, mbi të cilën ia vlen të betohesh:

"Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje." *(Asr, 103/1-2)*

Koha është një burim shumë i rëndësishëm, i paçmueshëm dhe që nuk kthehet pas. Çdokush prej nesh ka shtatë ditë në javë dhe njëzet e katër orë në ditë. Koha ka vetëm një drejtim: ecën pa pushim. Nuk mund të mblidhet, nuk mund të depozitohet, nuk mund të përsëritet, por harxhohet. Prandaj, sa i përket kohës, këshilla për Pejgamberin dhe në përgjithësi për të gjithë besimtarët, është e veçantë:

"Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!" *(Inshirah, 94/5-8)*

Sipas kësaj këshille, kalimi i kohës me vepra të dobishme, të qenët në mënyrë të vazhdueshme i angazhuar dhe fillimi i një pune tjetër sapo ke mbaruar të parën, na shfaqet si sjellje e rëndësishme. Pejgamberi ynë thekson rëndësinë e përjetimit të kohës në një mënyrë më produktive, duke e planifikuar çdo ditë më mirë se një ditë përpara.

Është radha juaj

Çfarë parimesh mund të nxjerrim nga hadithet që lidhen me përdorimin e duhur të kohës?

Konsultimi

Pejgamberi ynë, Muhammedi (s.a.s.), i ka vlerësuar njerëzit dhe ka zbatuar parimin: "Punët e muslimanëve bëhen në bazë të konsultimeve mes tyre." *(Shura, 42/38)*.

Ai ka treguar respekt sidomos ndaj mendimeve të njerëzve mbi çështje profesionale dhe ka vepruar sipas parimit që jepet në ajetin: "Andaj pyetni (dijetarët e Librit), nëse nuk e dini (këtë)" *(Nahl, 16/43)*. Në këtë pikë është e dobishme të shpjegojmë se ç'duhet të kuptojmë me të qenët i respektueshëm: Të tregosh respekt nuk realizohet vetëm duke e shprehur me fjalë ose thjesht formalisht. Po ashtu, respekti nuk është shprehja e një qëndrimi. Domethënë, nëse tregoni respekt me fjalë ndaj mendimeve të njerëzve, por në të vërtetë mendoni ndryshe, kjo nuk mund të jetë plotësisht një sjellje respekti. Brenda respektit ka edhe kritere si konsultimi, bashkëpunimi dhe solidariteti.

Në jetën sociale të Hz. Pejgamberit, parimi i konsultimit gjatë kryerjes së ndonjë pune zë një vend të rëndësishëm. Kjo është një sjellje e rëndësishme, si në vendosjen e rregullit të jetës, ashtu edhe në të qenët shembull ndaj njerëzve.

A e dini?

Pas Luftës së Bedrit, Hz. Pejgamberi është konsultuar në lidhje me masat që duhet të merren ndaj robërve dhe në fund ka zgjedhur një rrugë që do të ishte në dobi të të gjithëve. Siç dihet, robërit kanë arritur të shpëtojnë ose duke dhënë shpagimin e shpëtimit, ose duke u mësuar shkrim dhe lexim dhjetë fëmijëve muslimanë. Në Luftën e Hendekut, mendimi për të gërmuar një hendek lindi si rezultat i konsultimit. Edhe kjo situatë është e rëndësishme për të treguar se çfarë funksioni ka konsultimi, i cili jo vetëm hap horizonte, por edhe zhvillon mentalitetin.

Përveç kësaj, Hz. Pejgamberi vlen të merret si shembull edhe në lidhje me faktin se çfarë qëndrimi duhet të mbajmë gjatë konsultimit. Kur ai konsultonte ishte i butë dhe plot dashuri ndaj njerëzve, ashtu siç përcaktohet në ajetin e mëposhtëm:

"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai" *(Al-u Imran, 3/159)*. Sigurisht, sjellje të tilla duhet të merren shembull edhe nga ana jonë.

Vartësia ndaj kauzës së tij

Muhammedi (s.a.s.), që nga çasti kur u ngarkua me detyrën e profetësisë, ia ka kushtuar veten plotësisht kësaj detyre të madhe. Sinqeriteti i Hz. Pejgamberit, vetëdija e detyrës që kishte, kufijtë që përcaktonin kompetencën e tij dhe qëndrimi aty ku duhej të qëndronte, janë pasqyrime të dukshme të besimit të madh në kauzën e tij.

Te Hz. Pejgamberi besimi ishte krejtësisht i qartë dhe ai nuk është nënshtruar ndaj asnjë kushti. Edhe në kohët kur gjendej në vështirësi të mëdha, kur idhujtarët i dërguan xhaxhanë e tij dhe i thanë se do t'i jepnin çfarëdo që të dëshironte nëse hiqte dorë nga kjo punë, ai u përgjigj:

"Betohem tek Allahu që ka jetën time në dorë, se, nëse do të më japin diellin në dorën e djathtë dhe hënën në dorën e majtë në këmbim të braktisjes së detyrës sime hyjnore, nuk bëj atë që thonë ata. Mua më mjafton Zoti im..." *(Ibn Hisham, I, 265-266)*. Kështu, ai ka shprehur vartësinë ndaj kauzës së tij.

Qëndrimi që e çoi atë deri në vetëflijim ishte besimi që kishte ndaj kauzës së tij. Ai i merrte parasysh të gjitha rreziqet dhe për këtë nuk ngurronte në asgjë. Suksesi i madh që arriti sa i përket këtij kriteri mund të shpjegohet kryesisht me sinqeritetin e tij. Për shkak se ka besuar me sinqeritet në fenë drejt së cilës bënte thirrje, gjatë paralajmërimit të njerëzve dhe gjatë kohës kur i mësonte ata, ka arritur në sukses. Nga ana tjetër, ai zbatonte ato që thoshte. Sa mund të ishte efektiv nëse nuk do të zbatonte ato që kishte thënë? Ky qëndrim është një shembull i rëndësishëm për njerëzit: njeriu, së pari duhet të lidhet me besim dhe sinqeritet të madh ndaj punës që kryen vetë ai. Përveç kësaj, Pejgamberi ynë ka vepruar gjithmonë me durim, plot besim dhe me vendosmëri, nuk ka rënë asnjëherë në gjendje të pashpresë dhe s'ka qenë asnjëherë i pavendosur. Edhe njerëzit që e marrin atë shembull, kurrë nuk duhet të bien në mungesë shprese, nuk duhet të bien në zhgënjim.

Është radha juaj

Diskutoni mbi rëndësinë e vendosmërisë së njeriut për të fituar pëlqimin e Allahut.

Trajtimi i njerëzve si të barabartë

Le të mendojmë

Çfarë ndikimi ka mbi shoqërinë trajtimi i të gjithë njerëzve si të barabartë?

Pejgamberi Muhammed (s.a.s.), siç theksohet në ajetin: "Ne të kemi dërguar ty (o Muhammed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin" *(Sebe, 34/28)* dhe në mjaft ajete të ngjashme, është dërguar si Pejgamber ndaj të gjithë njerëzimit. Detyra e tij ishte t'u transmetonte njerëzve shpalljet hyjnore që merrte nga Allahu. Ai ka organizuar mbledhje të ndryshme për t'iu përçuar njerëzve thirrjen e tij. Përveç kësaj, ka vijuar shpalljen në çdo vend dhe në çdo rrethanë. Në kohën që u përçonte njerëzve këtë thirrje, nuk ka bërë kurrë dallim ndërmjet tyre. Dallimi mes të pasurve dhe të varfërve, njerëzve me ngjyrë dhe të bardhëve, grave dhe burrave, të lirëve dhe robërve, nuk ka qenë kriter pengues në përçimin dhe transmetimin e ftesës së tij.

Ai ka vendosur njeriun në qendër. Kurrë nuk e ka miratuar përçmimin e njerëzve. Bilali, i cili ishte një njeri me ngjyrë nga Etiopia, është bërë muezini i Hz. Pejgamberit. Zejd b. Harithe, që vinte nga shtresa e skllevërve është lartësuar aq sa ka marrë kryekomandën e ushtrisë islame.

Në Hutbenë e Lamtumirës ka thënë këto fjalë domethënëse, që kundërshtonin dallimin mes njerëzve:

"... O njerëz! Zoti juaj është një, edhe babai juaj është një; të gjithë ju jeni fëmijët e Ademit, ndërsa Ademi është nga dheu. Tek Allahu, më i vyeri është ai që është i respektuar ndaj urdhëresave të Tij, që ka frikë nga kundërshtimi i tyre..." *(Hutbeja e Lamtumirës, Ibn Hisham, II, 601 etj.)*. Kjo situatë duhet të jetë shembull për të gjithë njerëzimin.

Edhe ajeti: "O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra..." *(Nisa, 4/1)* aludon pikërisht mbi këtë çështje. Krijimi vjen nga i njëjti thelb, prandaj, të bësh dallime duke u sjellë ndryshe ndërmjet njerëzve të ndryshëm, është një qëndrim që nuk mund të mirëpritet në emër të njerëzimit. Rrugët e një qëndrimi të shëndetshëm mbi këtë çështje duhet të gjenden që në moshë të vogël.

Të studiojmë - Të mësojmë

Mendojeni nga pikëpamja e thelbit të Islamit faktin që Hz. Pejgamberi nuk bënte dallim ndërmjet njerëzve.

Të qenët i drejtë

Hz. Pejgamberi është ngarkuar me përgjegjësi për të qenë i drejtë mes njerëzve:

"Andaj, ti thirri dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar, mos i ndiq epshet e tyre dhe thuaj: 'Unë besoj çdo libër që e ka shpallur Allahu dhe jam urdhëruar që të gjykoj drejt midis jush...'" *(Shura, 42/15)*

Drejtësia është shumë e rëndësishme në aspektin e qetësisë, paqes dhe lumturisë së njeriut. Pejgamberi ynë i dashur ka pasur drejtësinë si parim të veprave të tij, duke mos bërë dallim ndërmjet të pasurve dhe të varfërve. Hz. Muhammedi e sheh drejtësinë si një kriter themelor në aspekt të paqes dhe qetësisë së njerëzimit.

Ngjarja që transmetohet më poshtë është një ndër shembujt e sjelljes me përkujdesje të Pejgamberit tonë sa i përket demonstrimit të drejtësisë: Një grua, që i përkiste fisit Mahzum, bëri një vjedhje. Pasi u gjykua, rezultoi se ishte fajtore. Disa prej sahabeve kërkuan që ajo të mos dënohej dhe si ndërmjetës të idesë së tyre çuan Usame b. Zejdin, të cilin e dinin se Hz. Pejgamberi e donte shumë dhe kërkesën e të cilit do ta merrte parasysh. Usame vajti te Hz. Pejgamberi dhe i kërkoi të mos e dënonte. Hz. Pejgamberi reagoi shumë ashpër, duke i thënë: "Mos po bëhesh ndërmjetës që unë të mos plotësoj urdhrin e Allahut?" Pas këtyre fjalëve, vajti në mesxhid dhe bëri këtë paralajmërim ndaj popullit:

"Mos harroni, ata që ishin para jush nuk dënonin të pasurit dhe të fuqishmit mes tyre, kur këta kryenin faj. Përkundrazi, kur të varfrit dhe të pafuqishmit kryenin ndonjë faj, u jepnin atyre dënimet më të rënda. Ja, pra, ata prandaj u zhdukën" *(Buhari, Hudud, 12; Muslim, Hudud, 8-9)*.

Shoqëritë qëndrojnë më këmbë vetëm mbi bazën e drejtësisë. Edhe Pejgamberi ynë, si parim të punëve të tij ka pasur pikërisht drejtësinë. Është sjellë me përkushtim në çështjen e së drejtës, nuk ka cenuar jetën dhe pasurinë e askujt, si dhe nuk ka dashur që t'i mbesë mbi vete e drejta e robit. Nëse ka pasur nga ata që i ka lënduar pa dashje, e ka kompensuar këtë. Për shembull: Në luftën e Hunejnit, Hz. Pejgamberi kishte hipur në devenë e tij dhe po ecte. Ndërkohë, këmba e një sahabiu që po ecte ngjitur tij, u afrua aq sa i prekte kofshën Pejgamberit dhe po e lëndonte atë. Pejgamberi e paralajmëroi atë duke e gjuajtur edhe me kamxhik këmbën e sahabiut. Ditën tjetër e kishte thirrur sahabiun që të diskutonin. Sahabiu ishte bërë kureshtar të dinte se ç'kishte ndodhur, ndërsa Hz. Pejgamberi i kishte thënë: "Dje më lëndove këmbën dhe më dogje shpirtin. Edhe unë të godita me kamxhik. Të thirra për të të dhënë shpërblimin e kësaj" dhe i kishte dhënë atij tetëdhjetë dele *(Taberi, III, 93)*.

Në çdo rast Hz. Pejgamberi ka përçmuar mizorinë, të kundërtën e drejtësisë dhe vetë ai gjithmonë ka mbajtur anën e të shtypurve. Me fjalën: "Muslimani është vëllai i muslimanit dhe nuk bën mizori ndaj tij..." *(Ibn Hanbel, II, 91)*, ka aluduar ndaj një kriteri të rëndësishëm, sipas të cilit vëllezërit nuk duhet të bëjnë padrejtësi ndaj njëri-tjetrit. Duke përjetësuar kështillat në ajetin: "O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat

e Allahut dhe bëhuni dëshmues të drejtë! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë..." *(Maide, 5/8)*, është bërë shembull për njerëzit dhe ka theksuar se asgjë nuk duhet kryer me mizori, përndryshe, mizorët do të ndikohen nga mizoritë e tyre.

Është radha juaj

Vlerësojini ngjarjet dhe fjalët shembullore të Hz. Pejgamberit në lidhje me drejtësinë, duke marrë për bazë sjelljet tuaja.

Toleranca e Hz. Pejgamberit

Jeta e Pejgamberit tonë të dashur, i cili është dërguar si "Mëshirë ndaj botëve" *(Enbija, 21/107)*, në të vërtetë ka kaluar me mëshirë, dhembshuri dhe tolerancë ndaj njerëzve. Ai, që në fillim të transmetimit të shpalljes hyjnore, është tallur, por nuk ka ushqyer ndjenjën e mllefit, madje ka falur edhe personat që planifikuan ta vrisnin. Ai ka falur edhe Hindin që urdhëroi vrasjen e xhaxhait të tij në Uhud dhe Uahshiun që e vrau atë, e gjitha kjo në kuadër të "durimit" që vjen nëpërmjet këshillës së shprehur në ajetin: "Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është më e mira (rrugë) për të durueshmit." *(Nahl, 16/126)*

Ai nuk është sjellë tolerant vetëm ndaj rrethit të afërm, por edhe ndaj pjesëtarëve të feve të tjera. Një grup i krishterë që mbërriti nga Nexhrani në Medine, në vitin e 9-të, Vitin e Delegatëve, erdhi në el-Mesxhidu'n-Nebeui gjatë kohës së ikindisë. Hz. Pejgamberi sapo kishte falur namazin e ikindisë. Edhe për delegacionin e krishterë ishte koha e adhurimit. Ata u drejtuan nga lindja dhe u përgatitën për adhurim, por disa nga shokët e Pejgamberit u përpoqën t'i pengonin ata në kryerjen e adhurimit. Hz. Pejgamberi (s.a.s.) kërkoi që ata t'i kryenin adhurimet e tyre lirisht dhe kështu u bë *(Sarıçam, 2003, 278)*.

A e dini?

Në jetën e Pejgamberit tonë dhe në personalitetin e tij shembullor, toleranca nuk ka kuptimin e të qenit indiferent, të përçmimit apo të mos kushtimit rëndësi ndaj diçkaje.

Sjellja që ka si synim tolerancën, përfshin në të njëjtën kohë edhe mundësinë për t'u arsimuar. Me këtë rast, Hz. Pejgamberi, ua mëson të tjerëve me metoda të përshtatshme atë që duhet t'ua mësojë. Duke ndërhyrë ndaj atyre që dëshironin të dënonin beduinin, i cili defekoi në mesxhid, pasi u kërkoi atyre të pastronin me ujë vendin e ndotur, u tha: "Ju nuk u dërguat si vështirësues, por si lehtësues" *(Buhari, Vudu, 58; Edeb, 80)* dhe e mësoi beduinin se si duhej të vepronte.

Hz. Pejgamberi, duke këshilluar: "Sillu tolerant, që edhe ndaj teje të sillen me tolerancë" *(Ibn Hanbel, I, 248)*, e vë theksin te parimi i reciprocitetit. Pra, personave që dëshirojnë të jenë të toleruar, së pari u sugjeron që ta zhvillojnë vetë një sjellje të tillë. Kjo situatë është një këshillë ndaj atyre që abuzojnë me tolerancën. Kur tolerimi perceptohet gjithmonë sikur është detyra e njërës prej palëve, pas një kohe, në marrëdhënie mund të përjetohen qëndrime të papëlqyeshme. Në këtë rast, të tolerosh tregon veprimin e njëanshëm.

Mund të themi se Hz. Pejgamberi ka treguar veçanërisht kujdes në shprehjen e tolerancës kur kishte si qëllim formimin e një shoqërie të qetë dhe në paqe. Pra, Hz. Pejgamberi, kur shfaqej një situatë në të cilën duhet të tregonte tolerancë, krahas ballafaqimit në një mënyrë të bukur, është përpjekur edhe të rregullojë palën që duhej të rregullohej.

Është radha juaj

Cilat janë ngjashmëritë ndërmjet sjelljeve toleruese ndaj njerëzve të tjerë dhe sjelljeve toleruese të Hz. Pejgamberit? Shqyrtojini.

Përmbledhja e kapitullit

Kur'ani Famëlartë e vë theksin mbi faktin se Pejgamberi ynë i dashur, Hz. Muhammedi, është njeri. Ndërsa veçoria më e rëndësishme që e dallon atë nga njerëzit e tjerë, është të marrë shpallje hyjnore nga Allahu.

Hz. Muhammedi është Pejgamberi i fundit i dërguar ndaj njerëzimit. Ai e ka shpallur Islamin në një periudhë prej njëzet e tre vjetësh të profetësisë dhe njëkohësisht është bërë shembull ndaj njerëzve. Gjatë realizimit të kësaj detyre ka ditur t'u rezistojë kushteve të vështira dhe të rënda, si dhe ka vepruar me vendosmëri e durim të madh.

Hz. Pejgamberi është bërë shembull qoftë në të kuptuarit e Islamit, ashtu edhe në të treguarit e tij te njerëzit. Është bërë personalisht shembull qoftë në kryerjen e adhurimeve, ashtu edhe në rregullimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, madje ka këshilluar që njerëzit të marrin atë si shembull.

Është bërë shembull me besueshmërinë, drejtësinë e tij, si dhe duke mos bërë dallim mes njerëzve. E ka mirëpërdorur kohën dhe ka paralajmëruar njerëzit mbi këtë çështje. U ka dhënë vlerë mendimeve të të gjithëve, i ka mësuar ata dhe i ka këshilluar që të besojnë tek Allahu.

Të rishikojmë kapitullin

1. Radhisni ajetet e Kur'anit që e cilësojnë Hz. Pejgamberin si njeri.
2. Radhisni ajetet e Kur'anit që e cilësojnë Hz. Pejgamberin si pejgamber.
3. Cilat parime ka marrë për bazë Hz. Pejgamberi në sjelljet e tij? Shpjegojini.
4. Përse Hz. Pejgamberi u quajt "el-Emin"?
5. Ndaj cilave situatave Hz. Pejgamberi është sjellë me durim gjatë plotësimit të detyrës së shpalljes hyjnore?
6. Shpjegoni një fjalë të Hz. Pejgamberit që tregon për vlerën e kohës.
7. Shpjegoni një ngjarje, në të cilën Hz. Pejgamberi është konsultuar.
8. Shpjegoni me një shembull vartësinë e Hz. Pejgamberit ndaj kauzës së tij.
9. Si e ka shpjeguar Hz. Pejgamberi barazinë ndërmjet njerëzve?
10. Shpjegoni sjelljen e drejtë të Hz. Pejgamberit duke dhënë shembuj.
11. Përse Hz. Pejgamberi ka këshilluar që të sillemi me tolerancë? Shpjegojeni.

Pyetje vlerësuese

1. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është ndër parimet që qënd-ron në themel të sjelljeve shembullore të Hz. Pejgamberit?

A) Modestia
B) Krenaria
C) Drejtësia
D) Mirësjellja

2. Cili është shkaku i cilësimit "el-Emin" të Hz. Pejgamberit?

A) Të jesh i durueshëm
B) T'i kushtojë rëndësi konsultimit
C) Mirëpërdorimi i kohës
D) Të jesh i besueshëm

3. Në cilën prej sureve të mëposhtme bëhet betimi mbi "kohën"?

A) Isra
B) Keuther
C) Asr
D) Ihlas

4. Cili nga veprimet e mëposhtme është pengesë në mirëpërdorimin e kohës?

A) Kryerja e punëve me planifikim
B) Ta fokusosh të gjithë energjinë te puna që ke në dorë
C) Të mos dish të thuash "Jo"
D) T'i bësh punët duke filluar nga e lehta e të vazhdosh drejt së vështirës

5. Cili është kuptimi i fjalës "konsultim"?

A) Ta kryesh çdo gjë vetë
B) Të marrësh përsipër një punë në mënyrë të guximshme
C) Të jesh i vendosur
D) Të këshillohesh

6. Cili është kuptimi i "tolerancës" në doktrinën e Hz. Pejgamberit?

A) Të jesh indiferent
B) Të mos i kushtosh rëndësi
C) Të qeshësh dhe të neglizhosh
D) Të gjesh mundësi për të mësuar sjelljen e drejtë

pejgamberi im

KAPITULLI

5

Sjellje shembullore nga Hz. Pejgamberi

1. Hz. Pejgamberi si bashkëshort
2. Hz. Pejgamberi si baba
3. Hz. Pejgamberi si gjysh
4. Hz. Pejgamberi si fqinj
5. Hz. Pejgamberi si i afërm
6. Hz. Pejgamberi si shok

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Në këtë kapitull trajtohet rëndësia dhe përkujdesja që Hz. Pejgamberi u kushton marrëdhënieve ndërnjerëzore. Po ashtu, janë dhënë shembuj nga jeta e tij, por janë parashtruar edhe shembuj nga ajetet që e orientojnë atë të sillet kështu.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Nxënësi që plotëson këtë kapitull:

1. Kupton se çfarë njeriu ishte Hz. Pejgamberi brenda shoqërisë.
2. Shpjegon se cilat ishin pikat kryesore, të cilave ai u kushtonte rëndësi në marrëdhëniet ndërnjerëzore.
3. Tregon se cilave pika duhet t'u kushtojmë rëndësi kur marrim si shembull Hz. Pejgamberin.
4. Me shembuj nga jeta e përditshme kontrollon nëse i ka modeluar apo jo sjelljet e Pejgamberit.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Mendoni vazhdimisht nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të kapitullit. Rilexoni çështjet që lidhen me ato synime, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Në fund të tekstit është ofruar një bibliografi e gjerë. Shqyrtoni burimet që mund të siguroni nga kjo listë.
3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe diskutojini ato në mjedisin mësimor.

1 Hz. Pejgamberi si bashkëshort

Le të mendojmë

Cili është vendi dhe rëndësia e gruas në ndërtimin e një jetese që bie në përputhje me pëlqimin e Allahut, apo në formimin dhe në zhvillimin e një shoqërie të lumtur?

Sipas Hz. Pejgamberit, familja përbën themelin e një shoqërie të varur nga vlerat fetare, një shoqërie të shëndetshme. Ndërsa ka inkurajuar martesën, në të njëjtën kohë edhe e ka lehtësuar atë dhe ka ofruar sanksione mbrojtëse, në mënyrë që bashkëshorti dhe bashkëshortja të mos bien pre e padrejtësive. Edhe ai vetë, si bashkëshort, është sjellë shumë mirë me bashkëshortet e tij, ka respektuar të drejtën e tyre dhe kurrë nuk është sjellë vrazhdë me ta. Nëse marrim parasysh se në çfarë pozite ishte femra në periudhën e injorancës në krahasim me mashkullin, do të kuptohet më mirë vlera e këtyre parimeve që ka zbatuar personalisht Pejgamberi ynë, i cili edhe i ka këshilluar njerëzit:

"Më i hairit ndër ju është ai që është më i hairit për familjen e tij. Për sa më përket mua, unë jam më i hairit në mesin tuaj ndaj familjes së tij." *(Ibn Maxhe, Nikah, 50).*

Hz. Pejgamberi, martesën e parë e ka bërë me Hz. Hatixhenë. Deri në vdekjen e Hz. Hatixhesë nuk është martuar me asnjë femër tjetër. Hz. Pejgamberi ynë ka pasur një martesë shumë të lumtur me Hz. Hatixhenë. Hz. Hatixheja ishte personi i parë që i besoi dhe një personalitet i përzgjedhur që e mbështeti atë në çdo pikëpamje. Edhe Hz. Pejgamberi gjithmonë e ka kënaqur atë dhe ka ofruar gosti ndaj saj.

Hz. Pejgamberi, rëndësinë që i ka kushtuar jetesës familjare e ka parë si pjesë të parimeve të besimit e të moralit, gjë që e shpreh si më poshtë:

"Më i përsosuri i besimtarëve në pikëpamje të besimit është personi më i bukur në aspektin moral dhe më i buti ndaj pjesëtarëve të familjes" *(Ibn Hanbel, VI, 47).*

Sipas kësaj thënieje, është vlerësuar sjellja me butësi në marrëdhënie me anëtarët e familjes.

Bashkëshorti dhe bashkëshortja janë njerëzit më të afërt, me të cilët ndahet gëzimi dhe hidhërimi. Edhe Hz. Pejgamberi ka ndarë dëshpërimet dhe gëzimet si bashkëshort dhe në këtë pikë u ka kushtuar shumë rëndësi atyre. Me raste të ndryshme është shprehur se femrat kanë të drejta mbi meshkujt, po ashtu edhe meshkujt mbi femrat, ashtu siç thuhet edhe në ajetin: "... Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato..." *(Bakara, 2/187),* që tregon se gruaja dhe burri kanë përgjegjësi ta mbrojnë dhe ta ruajnë njëri-tjetrin. Në

veçanti ka qortuar sjelljet e shëmtuara dhe të vrazhda të treguara ndaj grave, ka qortuar burrat që rrihnin gratë duke u thënë: "Si i rrihni gratë e në mbrëmje shkoni dhe flini bashkë me ta?" *(Ibn Hanbel, IV, 17)* dhe i ka paralajmëruar ata.

Pejgamberi ynë ka treguar interes edhe ndaj të afërmve të bashkëshorteve të tij dhe ka shprehur komplimente ndaj tyre. Po ashtu, ka marrë masat e duhura për të plotësuar nevojat e tyre për dëfrim, po ashtu edhe për të pushuar, jo vetëm ndaj grave, por edhe ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes *(Muslim, Salatu'l-Idejn, 18-19)*.

Hz. Pejgamberi (s.a.s.) i ka kushtuar mjaft rëndësi edhe konsultimit me bashkëshortet e tyre. Për shembull, pas Marrëveshjes së Hudejbijes i këshilloi sahabet të presin kurbanët e tyre dhe të qethin flokët. Ndërsa ata nuk e realizuan fjalën e tij, duke u shprehur se kushtet e marrëveshjes ishin në disfavor të muslimanëve. Hz. Pejgamberi, i prekur nga kjo, vajti te bashkëshortja e tij, Ummu Selemeja dhe i tregoi se ç'kishte ndodhur. Ajo i tha: "Ja Rasulullah! Ti dil dhe prite kurbanin, qethi flokët. Të gjithë ata do të të binden ty." Pas këtyre fjalëve, Hz. Pejgamberi e plotësoi këshillën e saj dhe në të vërtetë sahabet kishin vepruar si ai (Uakidi, II, 613). Shihet se Hz. Pejgamberi, ashtu siç thuhet në një transmetim të trilluar, "nuk i ka pyetur bashkëshortet thjesht formalisht, që më pas të bëjë të kundërtën e asaj që ato i kanë thënë" *(Axhluni, II, 3)*, përkundrazi i ka vlerësuar fjalët e bashkëshortes dhe i ka zbatuar ato. Përveç kësaj, Hz. Pejgamberi i ka edukuar bashkëshortet dhe gratë e tjera kanë mundur të mësojnë prej tyre në mënyrë të shëndetshme urdhëresat e fesë, ka nxitur interesin dhe kureshtjen e tyre mbi këtë çështje. Siç dihet, Hz. Aishe ka transmetuar mjaft hadithe nga Hz. Pejgamberi dhe ka lëvduar gratë ensare ndër gratë që edukonte, ngaqë ishin shumë kureshtare për të mësuar dhe që pyesnin pa pasur ndrojtje *(Muslim, Hajd, 13)*.

2 Hz. Pejgamberi si baba

Pejgamberi ynë, i cili në përgjithësi u kushtonte shumë rëndësi fëmijëve, ishte shumë i dashur edhe si baba, plot mëshirë dhe dhembshuri ndaj fëmijëve të tij. Pejgamberi ynë (s.a.s.) ka pasur nga Hz. Hatixheja dy djem dhe katër vajza. Emri i fëmijës së tij të parë është Kasim. Përveç kësaj, ka pasur edhe një fëmijë në emrin Abdullah. Ndërsa emrat e vajzave ishin Zejneb, Rukije, Ummu Kulthum dhe Fatima. Përveç Fatimas, të gjithë fëmijët kanë ndërruar jetë përpara Pejgamberit, disa prej tyre në moshë të vogël e disa në moshë të rritur. Ndërsa Fatima, e cila ishte e martuar me Aliun, pas vdekjes së babait të saj qe pikëlluar shumë dhe rreth gjashtë muaj më vonë ndërroi jetë. Përveç kësaj,

nga martesa me Marijen në periudhën e Medines, Pejgamberi ynë ka pasur një djalë me emrin Ibrahim. Si baba ai është gëzuar shumë për lindjen e Ibrahimit dhe është angazhuar shumë me të. Mirëpo edhe ai, ende pa mbushur dy vjeç, ndërroi jetë. Kur ndërroi jetë Ibrahimi, për lindjen e të cilit u gëzua shumë, Hz. Pejgamberi u pikëllua aq sa i rrodhën lot nga sytë. Një sahabi, i cili u habit me këtë situatë, e pyeti: "Edhe ti po qan, o Rasulullah?", ndërsa Hz. Pejgamberi ia ktheu: "Syri qan, zemra pikëllohet. Qarja ime është për shkak të dashurisë që ndiej ndaj fëmijës tim. Nuk shprehet mëshirë e dhembshuri ndaj atij që nuk mëshiron dhe nuk ndien dhembshuri ndaj askujt." Me këto fjalë ai ka treguar se po qante nga dhembshuria, se mënyra e të qarit që ai e kishte ndaluar më parë ishte të qarit duke bërtitur dhe duke klithur, një e qarë pa kriter *(Buhari, Xhenaiz, 44)*.

Pa dyshim, Hz. Pejgamberi i ka dashur shumë fëmijët e tij dhe i ka vlerësuar ata. Kur vajza e tij, Fatima, shkonte tek Hz. Pejgamberi, ai ngrihej më këmbë, e puthte atë në faqe dhe e ulte në vendin e tij. Përveç kësaj, para se të nisej për udhëtim, e fundit që përshëndeste ishte Fatima, ndërsa kur kthehej, së pari takonte atë *(Ebu Dau'ud, Terexh-xhul, 21)*. Mirëpo kjo dashuri kurrë nuk është bërë shkak që të bënte dallim ndaj saj dhe ta pozicononte në një vend ndryshe nga ummeti i tij, ndaj të cilit ishte përgjegjës. Për shembull, një ditë i kishte ardhur në dorë një sasi lekësh. Vjen Fatima, vajza e tij e dashur, dhe i kërkoi atij të blinte një skllav që të punonte për ta, pasi burri i saj kishte shumë vështirësi kur nxirrte ujë nga pusi dhe se nuk kishte forca të mjaftueshme për të bluar drithëra që të bënte miell. Pas këtyre fjalëve, Hz. Pejgamberi i tha: "Nuk mund të plotësoj kërkesat tuaja dhe të lë bosh stomakun e atyre që gjenden në Suffa; të gjithë paranë do ta ndaj për ta." Siç shihet, privilegje të tilla nuk i përdorte as për vajzën e tij që e donte shumë *(Ibn Hanbel, 838; përveç kësaj shih Fedailu As'habi'n-Nebi, 9)*.

Si baba, parimet që ka zbatuar në jetën e tij, Hz. Pejgamberi ia ka këshilluar edhe ummetit:

"Asnjë baba nuk mund t'i dhurojë diçka më të vyer fëmijës së tij se sa edukata e bukur" *(Hakim, IV, 26)*.

Me këtë fjalë u ka kujtuar baballarëve përgjegjësitë më të rëndësishme ndaj fëmijëve të tyre. Sepse njëra prej të drejtave më të rëndësishme e prindërve mbi fëmijën është edukata e mirë.

Një kriter që Pejgamberi ynë (s.a.s.) e zbaton në metodën e tij të mësimdhënies është përcaktimi i niveleve të veprimeve, duke bërë krahasim mes veprave dhe duke treguar kështu udhërrëfim ndaj zgjedhjeve të njerëzve. Fjala e tij: "Është më e vyer që personi ta edukojë mirë fëmijën se sa të japë si sadaka një masë gruri" *(Tirmidhi, Bir, 33)*, tregon për një krahasim të tillë dhe përcakton se detyra më e rëndësishme e nënës dhe babait është edukimin në formën sa më të mirë i fëmijës.

Është radha juaj

Gjeni shembuj të mënyrave të sjelljes që Hz. Pejgamberi ka zbatuar ndaj fëmijëve të tij.

3 Hz. Pejgamberi si gjysh

Hz. Pejgamberi, disa prej fëmijëve të të cilit ndërruan jetë që në moshë të vogël, ka treguar dashuri edhe ndaj nipërve dhe mbesave: Umame, Hasan dhe Hysejin. Ka ndier dashuri, mëshirë e dhembshuri të thellë ndaj të gjithë fëmijëve dhe e ka treguar vazhdimisht atë, madje është bërë edhe shembull për të gjithë në këtë pikë. Një beduin, pasi pa që ai i donte kaq shumë fëmijët dhe i puthte ata, i tha me habi: "I puthni ju fëmijët? Sepse ne nuk i puthim." Hz. Pejgamberi iu përgjigj: "Ç'mund të bëj unë nëse Allahu e ka nxjerrë dhembshurinë nga zemra juaj?" *(Buhari, Edeb, 18)*.

Hz. Pejgamberi ka treguar kujdes që të plotësojë kërkesat e fëmijëve, është dëfryer me ta, ka ardhur në Mesxhid bashkë me nipërit në prehër, madje është angazhuar me ta edhe gjatë faljes së namazit, siç është rasti me mbesën e tij, vajzën e Zejnebit, Umame. Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë, duke qenë se në shoqërinë ku kishte drejtuar thirrjen Pejgamberi, vajzat e vogla nuk kishin thuajse fare vlerë. Njëri prej keqkuptimeve që Hz. Pejgamberi u bë shembull me gjithë jetesën e tij dhe që u mundua ta rregullonte ishte pikërisht kjo çështje. Pra, nuk duhet të bëhet asnjë dallim mes vajzave dhe djemve. Madje vetë ai ka thënë: "Nëse do të më duhej të mbaja si më të epërt njërin prej tyre, kjo do të ishte vajza" *(Hakim, II, 284)*. Pra, ka tërhequr vëmendjen në faktin se vajzat duhet të edukohen me kujdes.

Edhe në ditët e sotme, kur flitet për nipërit dhe mbesat e Hz. Pejgamberit, na vjen në mendje Hasani dhe Hysejni. Por Hz. Pejgamberi ka vlerësuar po njësoj edhe mbesën

me emrin Umame dhe është bërë shembull ndaj shoqërisë duke treguar të njëjtin interes dhe dashuri për ta. Kur përqafonte nipërit dhe mbesat, lutej për ta duke thënë: "Allahu im, mëshiroji ti ata. Edhe unë tregoj dhembshuri ndaj tyre!" *(Buhari, Edeb, 21)*. Hz. Pejgamberi ka treguar haptazi dashurinë ndaj nipërve dhe mbesave, i ka puthur dhe përkëdhelur ata, i ka mbajtur në kraharor.

Aq shumë dominojnë doket dhe zakonet te disa shoqëri, sa fëmijët nuk puthen dhe përkëdhelen në sy të të tjerëve, dashuria ndaj tyre nuk shprehet qartësisht. Kjo është një mangësi e madhe në aspekt të zhvillimit të fëmijëve, të cilët duhet të mësojnë nga të rriturit që të duan dhe të duhen. Me këto sjellje të tij, Hz. Pejgamberi është bërë model edhe në çështjen e shprehjes qartazi të interesit dhe të dashurisë ndaj fëmijëve dhe ka këshilluar ummetin që të sillen pikërisht në këtë mënyrë. Përveç kësaj, Hz. Pejgamberi, duke qenë se fliste me fëmijët ashtu siç fliste me të rriturit, po ashtu, duke qenë se edhe bënte shaka me ta, është bërë shembull ndaj ummetit se ai kishte pranuar edhe personalitetin e tyre.

4 Hz. Pejgamberi si fqinj

Le të mendojmë

Cilat mund të jenë arsyet që Hz. Pejgamberi u kushton rëndësi marrëdhënieve fqinjësore?

Si fqinj, Pejgamberi ynë ka vepruar në kuadër të rregullave të mirësjelljes. Ka këshilluar që në marrëdhëniet fqinjësore, fqinjët të respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit, të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të ofrojnë paqe e qetësi ndaj njëri-tjetrit.

Nga hadithi i tij i mëposhtëm kuptojmë edhe domosdoshmërinë e zhvillimit të marrëdhënieve, duke filluar nga fqinji më i afërm:

"Kur Hz. Aishe e pyeti: 'Unë kam dy fqinje, cilës prej tyre duhet t'i bëj dhuratë?", Pejgamberi ynë ka urdhëruar: "Asaj që e ka më afër portën me tënden" *(Buhari, Edeb, 32)*.

Shohim se në kulturën islame "fqinjësia e afërt" (derë më derë) është shumë e rëndësishme. Me hadithin e mësipërm, Hz. Pejgamberi ka theksuar kuptimin dhe rëndësinë e fqinjësisë. Po ashtu, duke thënë: "Personi, nga mizoria e të cilit fqinji nuk është i sigurt", pasi kishte përsëritur tri herë: "Uallahi nuk mund të jetë besimtar!", tregon sërish për rëndësinë e marrëdhënies së mirë fqinjësore *(Buhari, Edeb, 29)*. Në këtë mënyrë ai ka treguar seriozitetin dhe rëndësinë e kësaj çështjeje. Duhet të mendojmë mbi fjalinë: "Nuk mund të jetë besimtar". Kjo do të thotë se çështja në fjalë është e lidhur drejtpërdrejt me

besimin dhe rruga e të qenit një besimtar i mirë kalon nga të qenët fqinj dhe komshi i mirë. Është e nevojshme që personat, të cilët e cilësojnë veten si besimtar, të rishikojnë marrëdhëniet e tyre fqinjësore.

Po ashtu, ndërsa e përshkruante personin si "Muflis", Hz. Pejgamberi është shprehur: "Dikush që në ditën e kiametit vjen me adhurime si namazi, agjërimi dhe zekati, por njëkohësisht vjen tek Allahu duke i thënë dikujt një fjalë të keqe, duke ngrënë pasurinë e dikujt, duke derdhur gjakun e dikujt, duke rrahur dikë, sevapi i adhurimeve të kryera të të cilit shpërndahet mes këtyre njerëzve, nëse i përfundojnë sevapet pa mbaruar ato që do të marrin hak nga ai, merr gjynahet e tyre dhe i ngarkon mbi vete dhe kështu, për shkak të gjynaheve të të tjerëve, hidhet në xhehennem" *(Muslim, Bir, 59)*. Ndërsa sa i përket fqinjësisë, këtë ndjeshmëri e ka shprehur duke thënë: "Ai që beson në Allah dhe në ditën e ahiretit nuk duhet ta torturojë fqinjin!" *(Buhari, Edeb, 31)*.

Të studiojmë - Të mësojmë

Çfarë parimesh të tjera mund të nxirren nga hadithet, sa u përket marrëdhënieve fqinjësore?

5 Hz. Pejgamberi si i afërm

Hz. Pejgamberi u ka kushtuar shumë rëndësi edhe marrëdhënieve ndërfisnore. Siç dihet, ai vetë mbeti pa nënë e pa baba që në moshë të vogël dhe ishin pikërisht të afërmit e tij, gjyshi dhe xhaxhai, të cilët e rritën dhe nuk bënë kurrë dallim ndërmjet tij dhe fëmijëve të tyre, me qëllim që të mos ndihej i distancuar. Edhe ai ka qenë gjatë gjithë jetës mirënjohës dhe i vetëdijshëm ndaj kësaj sjelljeje. Gjithmonë ka qenë i mbushur me dashuri ndaj tyre dhe nuk ua ka privuar respektin.

A e dini?

Hz. Aliun, djalin e Ebu Talibit, xhaxhait që mbrojti Hz. Pejgamberin, ky i fundit e ka marrë nën mbrojtje dhe është angazhuar personalisht me edukimin e tij. Po ashtu, ka forcuar edhe lidhjet farefisnore me të, pasi e martoi me vajzën e tij, Hz. Fatimenë.

Në Kur'an urdhërohet: "Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin" *(Nahl, 16/90)*. Shihet se Hz. Pejgamberi vepron duke marrë për bazë këtë parim dhe se është bërë shembull ndaj njerëzve në këtë çështje.

Edhe nga hadithet e mëposhtme mund të kuptojmë rëndësinë që Pejgamberi ynë u jep rëndësi marrëdhënieve fqinjësore të cilësuara si "sila-i rahim":

"Kush dëshiron që t'i zgjerohet risku ose t'i zgjatet jeta, le të vijojë marrëdhëniet me të afërmit." *(Buhari, Edeb, 12).*

Në një hadith tjetër Pejgamberi ynë i dashur urdhëron: "Ai që e vijon marrëdhënien me të afërmit në mënyrë të ndërsjellë, në të vërtetë nuk quhet se e vijon këtë marrëdhënie. Ai që në të vërtetë quhet se e vazhdon këtë marrëdhënie, është ai, i cili e vijon një marrëdhënie, pavarësisht se ajo është shkëputur" *(Buhari, Edeb, 15)*. Kjo do të thotë të vizitosh atë që nuk të viziton, t'i japësh atij që nuk jep. Pra, të mos shkëpusësh marrëdhëniet, të bësh të pamundurën në shtimin dhe shumimin e mirësive. Në kulturën tonë, kjo situatë shprehet kështu:

"Çdokush duhet t'i përgjigjet së mirës me mirësi!"

"Ndërsa, ta shpërblesh të keqen me mirësi, kjo është vepër e njeriut që arrin të dallojë anën e padukshme të ngjarjeve."

Në përgjithësi, njerëzit e shpërblejnë me diçka të bukur mirësinë, por edhe zemërohen kundrejt të këqijave, mbajnë mëri dhe kalojnë në sulme, të cilat thuajse rrënjosin të keqen. Në thelb duhet që këtë marrëdhënie ta shpëtojmë nga reciprociteti dhe ta vijojmë duke menduar vetëm përgjegjësinë tonë ndaj Allahut. Sepse të gjithë janë përgjegjës për bëmat e tyre dhe për to do të gjykohen. Jeta dhe fjalët e Pejgamberit na orientojnë edhe në këtë çështje. Ai ka theksuar se thelbësore është që të vijojmë të bëjmë të mira në çdo situatë dhe kusht.

Ndërsa me hadithin: "Mësoni nga të parët se me çfarë (dhe si) do të vijoni marrëdhëniet e ndërsjella farefisnore. Sepse vijimi i marrëdhënieve ndërfisnore është dashuri mes të afërmve, është pasuri dhe begati në jetë" *(Tirmidhi, Bir, 49)*, Hz. Pejgamberi ka lëvduar marrëdhëniet ndërfisnore dhe i ka nxitur ato.

Është radha juaj

Ç'mendoni për dobësimin e marrëdhënieve ndërfisnore në ditët e sotme?

6 Hz. Pejgamberi si shok

Hz. Pejgamberi, me dashurinë dhe mëshirën e tij, ka krijuar raporte ndërmjet ndjenjave të miqësisë e të vartësisë dhe në jetën e tij i ka kushtuar rëndësi forcimit të këtyre lidhjeve. Kjo situatë është konstatuar nëpërmjet ajetit: "Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, dëshiron që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët" *(Teube, 9/128)*.

Edhe në jetesën e tij para profetësisë, sidomos ata që kishin marrëdhënie tregtare me të, kanë treguar se ai nuk toleronte në çështjen e së drejtës dhe se ishte një shok shumë i mirë *(Ibnu'l-Esir, Usdu'l-gabe, II, 317)*. Ndërsa më parë kemi thënë se nuk gënjente dhe se ishte një njeri shumë i besueshëm, kritere të cilat ndikojnë që nga themeli në marrëdhënien shoqërore.

Hz. Pejgamberi, i cili ishte shumë i sjellshëm, e ka zbatuar këtë parim edhe ndaj shoqërisë. Mbajtja e kontakteve me të gjithë shokët dhe interesimi për shëndetin e tyre, pranimi i ftesës së atyre që e ftonin në shtëpinë e tyre, pranimi i dhuratës, shkëmbimi i dhuratës me dhuratë, janë sjellje që duhet të merren si shembull nga ana jonë. Hz. Pejgamberi mundohej të mësonte mbi nevojat e shokëve dhe t'i plotësonte ata. Ndaj shokëve sillej mjaft i dashur dhe i përzemërt. Ai paraqiste një shembull të përsosur miqësie. Prandaj edhe shokët e tij i kanë qëndruar pranë në çdo situatë. Për shembull, a nuk ishte Hz. Ebubekri që e mbështeti atë me jetën dhe pasurinë e tij në çastet më të vështira?

Në mjaft çështje ai shkëmbente mendime me shokët e tij, merrte e jepte sugjerime dhe respektonte fjalën e shokëve të tij.

Në luftën e Hendekut kishte parë si të arsyeshëm sugjerimin e Selman el-Farisiut në lidhje me gërmimin e hendekut rreth qytetit dhe menjëherë filloi zbatimin. Ka mjaft shembuj të ngjashëm me këtë dhe, në veçanti, ai ka paraqitur një shembull miqësie të përzemërt ndaj shokëve të tij. Përveç kësaj, në lidhje me këtë çështje duhet të përmendim edhe shprehjen e mëposhtme mbi veçoritë që duhet të ketë dikush, me të cilin do të lidhim shoqëri e miqësi:

"Të bisedosh dhe të kalosh kohë me një person vepërmirë dhe salih, po ashtu edhe me një person të keq, ngjan me atë që bart misk dhe atë që i fryn zjarrit. Ai që bart misk, ose të jep një pjesë misk, ose ti blen një copë misk prej tij. Ndërsa ai që i fryn zjarrit, ose djeg rrobat e tua, ose prej frymës së tij vijnë aroma të këqija" *(Buhari, Buju', 38; Muslim, Bir, 146)*.

Ky hadith është shumë i rëndësishëm në pikëpamje të shpjegimit të situatës që është vendosur dhe rrënjosur në kulturën tonë, krahas shprehjes: "Më thuaj me kë rri, të të them se kush je." Me këdo që një person mban shoqëri, është e pamundur të mos ndikohet nga ai. Nëse llogarisim aspektet negative të këtij ndikimi, del në pah edhe se personi duhet të sillet mjaft i kujdesshëm dhe përzgjedhës kur vendos se me kë do të ketë marrëdhënie shoqërore.

Le të mendojmë

Të vlerësojmë rrethanat shoqërore të periudhës së Hz. Pejgamberit me ato të periudhës sonë.

Përmbledhja e kapitullit

Pejgamberi ynë i dashur, me pëlqimin e Allahut, e ka konsideruar familjen si themelin e një jetese të përshtatshme, themelin e formimit të një shoqërie të lumtur dhe të edukimit të një brezi të shëndetshëm. Ndërsa nxiste martesën, në të njëjtën kohë edhe e ka lehtësuar atë dhe ka përcaktuar disa parime, me qëllim që bashkëshorti a bashkëshortja të mos binin pre e padrejtësive të ndërsjella. Edhe ai vetë si bashkëshort është sjellë shumë mirë ndaj bashkëshorteve, ka respektuar të drejtën e tyre, kurrë nuk ka vepruar në mënyrë të vrazhdë e as i ka lënduar ato.

Hz. Pejgamberi ka pasur gjashtë fëmijë nga Hz. Hatixheja, dy djem dhe katër vajza. Emri i fëmijës së parë të tij është Kasim. Përveç kësaj, ka pasur edhe një djalë në emrin Abdullah. Ndërsa emrat e vajzave janë: Zejneb, Rukije, Ummu Kulthum dhe Fatime. Të gjithë fëmijët e tjerë, përveç Fatimesë, kanë ndërruar jetë përpara Hz. Pejgamberit, disa prej tyre në një moshë të vogël, ndërsa disa të tjerë në moshë që mund të konsiderohet rinore. Përveç këtyre, nga martesa me Marijan, me të cilën u martua në periudhën e Medines, atij i lindi një djalë me emrin Ibrahim, por edhe ai ndërroi jetë pa mbushur ende dy vjeç.

Hz. Pejgamberi i ka dashur shumë fëmijët e tij dhe i ka vlerësuar ato. Kur i vinte pranë vajza e tij, Fatimeja, ai ngrihej më këmbë, e puthte në faqe dhe i lironte vendin ku ishte ulur vetë. Por, kjo dashuri nuk është bërë kurrë shkak që të bëjë dallime ndërmjet fëmijëve apo t'i vendosë ata në një vend më të privilegjuar se ummeti, ndaj të cilit ishte përgjegjës.

Hz. Pejgamberi, disa prej fëmijëve të të cilit ndërruan jetë kur ishin në moshë shumë të vogël, më pas përjetoi dashurinë e nipërve dhe të mbesave: Umame, Hasan dhe Hysejin. Ai ka ushqyer një dashuri dhe mëshirë të madhe ndaj të gjithë fëmijëve dhe kurrë nuk ka përtuar që t'i puthë apo t'i përkëdhelë ata, përkundrazi, është bërë shembull në këtë çështje.

Edhe si fqinj, Hz. Pejgamberi ka treguar personalisht se si duhet të jenë rregullat e mirësjelljes. Ka kështilluar që në marrëdhëniet e fqinjëve të respektohen të drejtat e ndërsjella, fqinjët të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të bëjnë të mundur që secili prej tyre të ndihet rehat.

Pejgamberi ynë ka vlerësuar shumë edhe marrëdhëniet ndërfisnore. Siç dihet, ai vetë mbeti pa nënë e pa baba që në moshë të vogël, mirëpo të afërmit e tij, gjyshi dhe xhaxhai, të cilët e rritën, nuk kanë bërë dallime ndërmjet tij dhe fëmijëve të tyre, në mënyrë që ai të mos e ndiejë këtë situatë. Edhe Hz. Pejgamberi u ka qenë mirënjohës gjatë gjithë jetës për këtë. Gjithmonë ka shprehur mjaft dashuri dhe përzemërsi ndaj tyre dhe nuk e ka privuar respektin ndaj tyre.

Hz. Pejgamberi është munduar që të mësojë nevojat e shokëve të tij dhe t'i plotësojë ato. Duke qenë se Pejgamberi ynë ka qenë një shembull i përsosur miqësie edhe ndaj shokëve të tij, edhe shokët i kanë qëndruar pranë në çdo situatë.

Të rishikojmë kapitullin

1. Cilat janë cilësitë e Hz. Pejgamberit si bashkëshort? Shpjegojini me shembuj.
2. Tregoni se si sillej Hz. Pejgamberi ndaj vajzave dhe mbesave të tij.
3. Cilët prej të afërmve e kanë marrë nën mbrojtje Hz. Pejgamberin pas vdekjes së nënës dhe babait të tij?
4. Përse Hz. Pejgamberi u ka kushtuar rëndësi marrëdhënieve fqinjësore? Jepni shembuj në lidhje me këtë çështje duke u nisur nga ajetet dhe hadithet.
5. Kush ishte shoku më i afërt i Hz. Pejgamberit?

Pyetje vlerësuese

1. Cili nga emrat e mëposhtëm nuk ishte njëra ndër vajzat e Hz. Pejgamberit?

A) Rukije B) Ummu Kulthum

C) Marije D) Fatima

2. Cili nga emrat e mëposhtëm është nipi ose mbesa që Hz. Pejgamberi e mori me vete në mesxhid kur vajti të falte namaz dhe e mbajti në shpinë gjatë gjithë kohës së faljes së namazit?

A) Umame B) Hasan

C) Hysejin D) Zejneb

3. Cili është emri i shokut të Hz. Pejgamberit, me të cilin ka qenë edhe në hixhret dhe për të cilin flitet edhe në Kur'an?

A) Hz. Osman B) Hz. Ali

C) Hz. Omer D) Hz. Ebubekir

4. Cili është emri i nënës së Ibrahimit, djalit të Hz. Pejgamberit?

A) Hz. Hatixhe B) Marije

C) Hz. Aishe D) Ummu Seleme

KAPITULLI 6

Hz. Pejgamberi si arsimtar dhe edukues

1. Dërgimi i tij si mësues
2. Rëndësia që i kushtonte shkrimit dhe leximit
3. Rëndësia që i kushtonte arsimimit të femrave
4. Parimet e arsimimit dhe edukimit

NË LIDHJE ME KAPITULLIN

Në këtë kapitull trajtohet rëndësia që Pejgamberi ynë, i cili bën të ditur se është dërguar si "mësues e mësimdhënës", i kushtonte dijes, mësimdhënies, mësimnxënies dhe kritereve ndaj të cilave tregon kujdes gjatë realizimit të kësaj detyre.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull:

1. Do të kuptoni përse Hz. Pejgamberi cilësohet si "mësimdhënës".

2. Do të shprehni me shembuj dhe me fjalët tuaja rëndësinë që Hz. Pejgamberi i kushton dijes, mësimdhënies dhe mësimnxënies.

3. Do të kuptoni se disa praktika të gabuara që realizohen në ditët e sotme burojnë nga moskuptimi drejt dhe saktë i Hz. Pejgamberit.

4. Do të mund të radhitni parimet, ndaj të cilave tregonte kujdes Hz. Pejgamberi gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Mendoni vazhdimisht nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të kapitullit. Rilexoni çështjet që lidhen me ato synime, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.

2. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Në fund të tij paraqitet një listë e gjerë burimesh. Shfrytëzoni tekstet që mund të arrini nga kjo listë.

3. Ndiqni pamjet që lidhen me këto çështje dhe bartini ato në mjediset mësimore.

1 Dërgimi i tij si mësues

Le të mendojmë

Si e kuptoni hadithin e Hz. Pejgamberit, në të cilin thuhet: "Unë u dërgova si mësues" *(Ibn Hanbel, III, 328).*

"Mësuesi" është kriteri dhe elementi më i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ose i procesit arsimor-edukativ. Në këtë kuptim, Kur'ani Famëlartë e paraqet Pejgamberin si udhërrëfyesin, arsimtarin dhe edukuesin e njerëzimit:

"Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë..." *(Xhum'a, 62/2).*

Në thelb është me vend të themi se detyra e shpalljes hyjnore e Hz. Pejgamberit është tërësisht çështje arsimi dhe edukimi. Sepse ai është ngarkuar me detyrë të sjellë tek njerëzit këshillat e Allahut: Duke u bazuar te ajeti: "Ne të kemi dërguar ty (o Muhammed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin..." *(Sebe, 34/28)*, elementet që do të priten me sihariq dhe që do të paralajmërohen nga ana e tij janë elementet që lidhen me çështjet për mësimdhënien e Hz. Pejgamberit.

Ndërsa në ajete të tilla si: "Për të dërguarit s'ka tjetër detyrë, veç të shpallin qartë" *(Nahl, 16/35)* dhe "... Detyra jote është vetëm që të kumtosh..." *(Shura, 42/48)*, aludohet mbi përkufizimin e detyrës së Hz. Pejgamberit si Pejgamber.

Me ajetin: "Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij..." *(Al-u Imran, 3/164)* theksohet rëndësia e një mësuesi si Pejgamberi kundrejt mësimnxënësve.

Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi, e ka vlerësuar shumë dijen, arsimin dhe edukimin. Në doktrinën e tij, dija është një vlerë e rëndësishme. Në ajetet ku tregohet se pa qenë i pajisur me dije nuk është sjellje e drejtë që të shprehësh mendim dhe ide në lidhje me diçka, *(Bakara, 2/78; En'am, 6/11-148; Junus, 10/36; Huxhurat, 49/12; Dharijat, 51/10; Nexhm, 53/23)*, theksohet ndjeshmëria që ka kjo çështje. Në periudhën e tij, njerëzve u është shtuar interesi dhe kureshtja për të mësuar. Hz. Pejgamberi e ka nxitur njeriun që të jetë ose në pozitën e mësimdhënësit ose të mësimnxënësit dhe se qëndrimi jashtë këtyre dy pozitave nuk është një situatë për t'u admiruar. Aktiviteti më i rëndësishëm që ka realizuar Hz. Pejgamberi në Medine pas hixhretit ishte të ndërtonte Mesxhidin ku ushtrohej mësimdhënia dhe mësimnxënia. Ky vend u kthye në një institucion ku ofrohej arsim dhe edukim gjatë gjithë ditës.

Hz. Pejgamberi është bazuar në disa parime gjatë ushtrimit të arsim-edukimit dhe ka përdorur metoda të ndryshme mësimdhënieje, metoda të cilat janë shpjeguar edhe në çështjen në vijim.

Le të mendojmë

Përse Hz. Pejgamberi pati si përparësi ndërtimin e një mesxhidi për arsim dhe edukim në Medine?

2 Rëndësia që i kushtonte shkrimit dhe leximit

Aktivitetet e shkrimit dhe të leximit, Pejgamberi ynë i shihte si të tilla, që nuk duhet të neglizhoheshin dhe si një kriter shumë i rëndësishëm. Në një mjedis e shoqëri, ku ata që dinin shkrim dhe lexim ishin të paktë, kishte rëndësi themelore marrja nën mbrojtje e gjërave që ishin mësuar. Në Arabinë paraislame, shkrimi përdorej shumë pak. Ka të dhëna që tregojnë se, madje, edhe në Mekë, si njëra prej qendrave më të mëdha të vendbanimit, vetëm pesëmbëdhjetë persona dinin shkrim dhe lexim. Po ashtu, ka të dhëna që situata nuk ishte kaq keq. Madje, në atë kohë flitet për gra që dinin shkrim dhe lexim, ndërsa si shembull tregohet se Shifaja, ndër të afërmit e Hz. Omerit, i ka mësuar vajzës së Hz. Omerit, Hafsasë, shkrimin dhe leximin *(Ibn Hanbel, VI, 372)*. Siç dihet, Hafsa, njëra prej bashkëshorteve të Pejgamberit, u angazhua më pas me arsimimin dhe edukimin e grave të tjera. Hafsa ka transmetuar mjaft hadithe që kanë ardhur deri më ditët e sotme.

Të studiojmë - Të mësojmë

Përmendni emrat e disa grave që janë angazhuar me arsim dhe edukim në periudhën e Hz. Pejgamberit. Studioni!

Në Mekë, Hz. Pejgamberi ka përdorur shtëpinë e Erkamit si qendër për arsim dhe edukim. Atje janë lexuar ajetet, janë shkruar, është realizuar mësimdhënia dhe mësimnxënia e të dhënave në lidhje me Islamin dhe janë përjetësuar këto të dhëna. Hz. Pejgamberi ka bërë çdo përpjekje në këtë çështje. Pas hixhretit, veprimi i parë i Hz. Pejgamberit, i cili para hixhretit mori përsipër veprimtaritë e arsimit dhe të edukimit të medinasve, qoftë duke i takuar ata, qoftë duke u dërguar një mësues në Medine, ishte të krijonte mundësinë e realizimit të veprimtarive të arsimit dhe të edukimit nga sahabet, në vendin e quajtur "Suffe". Me shprehjen e Hamidullahut, "Suffe" ka qenë "universiteti" i parë islam *(Hamidullah, 1993, 768)*. Pejgamberi ynë i dashur ka dhënë mësim këtu personalisht. Ata që u edukuan në Suffe u shpërndanë në Gadishullin Arabik, jo vetëm për të shpallur fenë, por edhe për t'ua mësuar atë të tjerëve.

A e dini?

Sa i përket mësimdhënies, Pejgamberi ynë ka përfituar edhe nga idhujtarët dhe nuk e ka parë si pengesë që ata të ishin mësimdhënës në çështje të drejtshkrimit, përkundrazi, i ka nxitur ata që të mësojnë. Dijes dhe mësimit u kushtonte shumë rëndësi, aq sa atyre që u zunë robër në betejën e Bedrit, u premtoi lirinë në këmbim që t'u mësonin shkrim e lexim dhjetë fëmijëve *(Ibn Sa'd, 14-17)*.

Nga këtu mund të nxirret edhe një rezultat tjetër: fakti që Pejgamberi ynë e ka marrë këtë shërbim edhe nga idhujtarët, tregon për rëndësinë e madhe që i kushtonte kësaj çështjeje. Madje, burime të ndryshme bëjnë të ditur se mësuesit idhujtarë silleshin ashpër ndaj fëmijëve dhe se babai i njërit prej kishte thënë: "Po marrin hakun e Bedrit" *(Ibn Hanbel, I, 247)*.Nga të gjitha këto mësojmë dhe kuptojmë se shkrimi është një element, të cilit Hz. Pejgamberi i kushtonte shumë rëndësi. Janë shkruar ajetet e Kur'anit, është dokumentuar me shkrim numërimi i parë i popullsisë në qytetin e Medines, po ashtu, janë shkruar Marrëveshja e Medines dhe të gjitha besëlidhjet apo marrëveshjet e tjera. Po ashtu edhe të ardhurat e shtetit janë dokumentuar me shkrim, por edhe numri i ushtarëve në kohë lufte. Pejgamberi ynë e ka drejtuar thirrjen ndaj një shoqërie që e kishte ndërtuar jetën mbi zakonet dhe traditat e injorancës. Ka edukuar individët e një shoqërie të tillë dhe ka formuar nga ata një shoqëri krejt të re. Gjatë realizimit të një pune kaq të vështirë, me në qendër orientimin e njerëzve drejt dijes, arsimit dhe edukimit, gjithmonë ka qenë e pranishme doktrina Kur'anore. Sepse Kur'ani Famëlartë e ka dalluar të diturin nga i padituri.

Disa ajete në Kur'anin Famëlartë në lidhje me këtë çështje janë:

"... Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?!'" *(Zumer, 39/9).*

"... O Zoti im, shtoma dijeninë!" *(Ta-ha, 20/114).*

"... Andaj pyetini dijetarët e Librit, nëse nuk e dini (këtë)" *(Nahl, 16/43).*

Edhe pejgamberët që janë dërguar, gjatë gjithë historisë kanë bërë të njëjtën gjë. Pejgamberët janë edhe persona, të cilët do të përçojnë njerëzit në udhën e drejtë, do të bëjnë të mundur që të jenë njerëz, të cilët kanë arritur të fitojnë pëlqimin e Allahut dhe që, me jetën e tyre shembullore janë shndërruar në udhërrëfyes.

Dijetarët, Hz. Pejgamberi i ka cilësuar si "trashëgimtarët e pejgamberëve": Duke thënë, "Dijetarët janë si yjet në qiell. Ashtu siç yjet na tregojnë udhën në errësirë, edhe ata janë udhërrëfyes në sipërfaqen e tokës" *(Buhari, 3/30; Tirmidhi, 3/19),* ka theksuar se ata marrin shembull pejgamberët sa i përket udhërrëfimit.

Xhennetu'l-Baki

3 Rëndësia që i kushtonte arsimit dhe edukimit të femrës

Hz. Pejgamberi ka theksuar se nxënia e dijes dhe mësimi pa dallime gjinore, është domosdoshmëri e të qenit njeri: "Nxënia e dijes është farz, qoftë për mashkullin, qoftë për femrën" *(Ibn Maxhe, Mukaddime, 17).*

Familja është struktura e parë themelore ku realizohet arsimi dhe edukimi. Rëndësia e edukatës që merr personi në familje del në pah në mjediset shkollore, ku fëmija fillon të socializohet dhe të bëhet pjesë e shoqërisë. Fëmija, me fjalët dhe me sjelljet e tij, tregon se çfarë edukate ka marrë në familje. Përgjithësisht, duke qenë se të ardhurat jetësore sigurohen nga baballarët, çështja e edukimit bie më shumë mbi nënën. Sa më shumë të arsimuara e të edukuara të jenë nënat, po aq të arsimuar e të edukuar do të jenë brezat e rinj, djem apo vajza qofshin.

Megjithatë, ka disa elemente, ndaj të cilave qoftë nëna, qoftë babai, duhet të tregojnë kujdes. Prindërit duhet t'i edukojnë në atë mënyrë fëmijët e tyre, që këto të jenë të lumtur qoftë në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në atë të botës tjetër. Prindërit duhet t'i edukojnë fëmijët e tyre me dije dhe informacione, që t'u mundësojnë atyre një personalitet dhe identitet të respektueshëm.

A e dini?

Pejgamberi është bërë shembull personalisht edhe sa i përket çështjes së femrave. Ai i ka arsimuar ato duke i takuar herë pas here sipas kushteve që ka pasur në dispozicion; u është drejtuar drejtpërdrejt atyre dhe i ka edukuar personalisht; herë pas here ka mundësuar që mësimet dhe dijet t'i marrin nga bashkëshortet e tij, si dhe, sipas situatës, burrat që kanë mësuar prej tij, i ka këshilluar që t'ua mësonin bashkëshorteve në shtëpi çfarë kishin mësuar.

Nga disa burime bëhet e ditur se në el-Mesxhidu'n-Nebeui gjendet një pjesë e posaçme për gratë. Këtu edhe bënin adhurimet, por edhe arsimoheshin nga bashkëshortet e Hz. Pejgamberit, kryesisht nga Hz. Aishe dhe Ummu Seleme. Siç bën të ditur Buhariu, Pejgamberi ynë, një ditë në javë e ka ndarë posaçërisht për gratë, duke u mësuar atyre gjëra të reja dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre *(Buhari, Ilim, 87)*. Edhe në atë periudhë gratë ishin shumë kureshtare për të mësuar. Kur kjo dëshirë e tyre nxitej edhe nga Hz. Pejgamberi, rezultatet ishin shumë të mira. Jo vetëm gratë edukonin gratë, por edhe sahabet, të cilët kishin vënë re rëndësinë që Hz. Pejgamberi i kushtonte kësaj çështjeje, luanin rol efektiv në arsimin e vajzave. Ndërkohë që Hz. Pejgamberi (s.a.s.) po ushtronte detyrën në një vend ku femrat nuk vlerësoheshin fare, u bënë të mundura rryma të tilla të reja. Prandaj, duke marrë atë si shembull sa i përket kësaj çështjeje, duhet të punojmë bashkërisht që të mos mbetet asnjë shenjë nga zakonet e injorancës.

Është radha juaj

Ç'lloj ndikimesh mendoni se kanë konceptimet mbi çështjen e arsimit të gruas në procesin historik? Sipas jush, ç'mund të bëhet në mënyrë që të lartësohet niveli arsimor i femrave?

4 Parimet e arsimit dhe të edukimit

Në personalitetin e Hz. Pejgamberit, i cili shprehet se është dërguar si "mësues", gjenden shembuj sa i përket rrugës që duhet ndjekur, sjelljes, mendimit, moralit, mënyrës se si duhet të sillemi apo të diskutojmë me bashkëbiseduesin. Faktin që ai është shembull mbi njerëzimin në çdo aspekt, Kur'ani e shpreh si më poshtë:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu e te Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun." *(Ahzab, 33/21)*

Le të mendojmë

Cilat veçori të Hz. Pejgamberit janë thelbësore sa i përket veprimtarisë së tij mbi arsimin dhe edukimin?

Hz. Pejgamberi, kur mësonte fenë, bëhej shembull për njerëzit duke i praktikuar vetë ato që u mësonte të tjerëve, gjë që ua kërkonte ta bënin edhe personave të tjerë që ishin ngarkuar me detyrën e mësimdhënies. Kjo kishte si bazë shprehjen: "O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!" *(Saf, 61/2-3)*.

Edhe sa i përket kësaj çështjeje, ka mënyra sjelljeje që i dedikohen Pejgamberit në Kur'an dhe kushtëzojnë të gjithë ata që i besojnë atij. Këto kanë përcaktuar qëndrimin e tij në çështjen e arsimit dhe të edukimit. Disa prej këtyre ajeteve janë:

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, i di më së miri ata që janë në rrugë të drejtë" *(Nahl, 16/125)*.

"Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata..." *(Al-i Imran, 3/159)*.

"Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë" *(Fussilet, 41/34)*.

Shumë këshilla, shembujt e të cilave i kemi dhënë më lart, përbëjnë themelin e parimeve të arsimit dhe të edukimit. Ndërsa parimet mund t'i radhisim si më poshtë:

Pejgamberi ynë (s.a.s.), ashtu si në çdo fushë të jetës, edhe në çështjen e arsimit dhe të edukimit ka treguar lehtësim dhe jo vështirësi. Ka bërë të ditur se veprimet e bëra me vështirësi çojnë në mundime, si rrjedhojë, këshillon që të zgjidhet lehtësimi në mënyrë që të mos krijohet një mundim i tillë.

Ka dhënë sihariq dhe nuk ka bërë që ta urrejnë. Ka mësuar me dashuri, u ka mësuar të tjerëve dashurinë. Duke thënë: "Betohem në Allahun që ka shpirtin në dorë, se pa besuar nuk mund të hyni në xhennet; pa dashur njëri-tjetrin nuk mund të jeni besimtarë të afirmuar" *(Muslim, Iman, 71-72)*, e ka paraqitur dashurinë si demonstrim të besimit.

Ka kritikuar me gjuhë të ashpër zemërimin dhe dhunën në lidhje me arsimin dhe edukimin; ata që zemëroheshin i ka paralajmëruar me thirrjen: "Kur të zemëroheni, heshtni!" *(Ibn Hanbel, I, 239)* dhe në saje të kësaj ka theksuar se duhet të shmangemi nga të qenët

shkak i lëndimeve të njerëzve. Spikat, po ashtu, edhe një fjalë e thënë nga një sahabi: "Unë nuk kam parë mësues që të japë mësim më bukur se Rasulullahu. As më qortoi, as më rrahu dhe as më ofendoi" *(Ibn Hanbel, V, 447-448).*

Hz. Pejgamberi ka pasur parasysh dallimet personale, i ka mësuar njerëzit duke gjetur mënyrën më të përshtatshme dhe anën më thelbësore. Të njëjtën çështje e ka treguar ndaj njerëzve të ndryshëm, me theksime të ndryshme dhe me metoda të ndryshme, ka theksuar domosdoshmërinë që të gjithë të përfitojnë dobi në kuadër të forcës dhe kapacitetit të të gjithëve, si rrjedhojë, edhe sipas kësaj ka bërë rregullime.

Herë pas here ka shpjeguar në mënyrë të gjatë, e herë të tjera ka mësuar duke e praktikuar dhe zbatuar konkretisht çështjen.

Ka nxitur që të bëjmë pyetje, i ka lëvduar ata që bënin pyetje, ata që u përgjigjeshin këtyre pyetjeve dhe ata që kanë përhapur përgjigjet.

Me pyetje spikatëse ka mundësuar që të zgjohet interesi dhe kureshtja ndaj mësimit dhe më pas u ka mësuar njerëzve atë që ka dashur të mësojë.

Ka parapëlqyer që, pa u realizuar mësimi i plotë mbi një çështje, të mos kalohet në një çështje tjetër.

Kur jepte mësim ndiqte si metodë të drejtë kalimin nga e lehta tek e vështira dhe nga e thjeshta tek më e ngatërruara.

Janë bërë përsëritje, me kusht që ato të mos ishin të panevojshme.

Shohim se Pejgamberi ynë është shembull për ne në këtë çështje, meqë i ka zbatuar në jetën e tij këto parime, ku tërheq vëmendjen mbi sistemet e arsimit në përgjithësi.

Të studiojmë - Të mësojmë

Ç'mund të shtojmë ndaj parimeve të arsimit dhe edukimit të Hz. Pejgamberit?

Përmbledhja e kapitullit

Pejgamberi ynë i dashur i ka kushtuar shumë rëndësi dijes, arsimit dhe edukimit. Në doktrinën e tij, dija është një vlerë shumë e rëndësishme. Ai, veprimtarinë e shkrimit dhe të leximit, si pjesë e veprimtarive të arsimit dhe edukimit, e ka konsideruar si një kriter shumë të rëndësishëm, që nuk duhet të neglizhohet, duke pasur parasysh situatën e periudhës së tij dhe të nevojave të posaçme. Pejgamberi ynë, duke urdhëruar: "Të nxësh dije është farz për çdo musliman, qoftë mashkull, qoftë femër", ka theksuar se nxënia e dijes pa bërë dallim gjinie është domosdoshmëri e të qenit njeri dhe ka treguar objektivitet në këtë çështje. Hz. Pejgamberi është bërë shembull personalisht në arsim-edukimin e grave. Sipas kushteve të periudhës së tij, i ka edukuar ata duke iu drejtuar personalisht herë pas here, ndërsa herë të tjera ka mundësuar që të mësojnë me anë të

bashkëshorteve të tij; sipas situatës ka këshilluar burrat që mësonin nga ai, me qëllim që gjërat e mësuara, t'ua mësonin edhe bashkëshorteve.

Në personalitetin e Hz. Pejgamberit, për të cilin bëhet e ditur se është dërguar si "mësues", gjenden shembuj në çështjen e rrugës që duhet të ndjekë një udhërrëfyes, në mendimin, moralin, sjelljen a mënyrën e të folurit.

Të rishikojmë kapitullin

1. Në cilin ajet të Kur'anit Hz. Pejgamberi cilësohet si "mësues"?
2. Cili është vendi i parë ku u ushtruan veprimtaritë e arsimit dhe të edukimit?
3. Tregoni një ngjarje që tregon se sa vlerë u kushtonte Hz. Pejgamberi shkrimit dhe leximit.
4. Si e ka ushtruar Hz. Pejgamberi veprimtarinë e arsimit dhe të edukimit ndaj grave?
5. Cilat parime ka theksuar Hz. Pejgamberi kur ushtronte veprimtaritë e arsimit dhe të edukimit?

Pyetje vlerësuese

1. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon për rëndësinë që Hz. Pejgamberi i kushtonte arsimit dhe edukimit?

A) Dokumenti i Medines
B) Numërimi i popullsisë
C) Shkrimi i Kur'anit Famëlartë
D) Dërgimi i delegatëve në vende të ndryshme

2) Cilin nga parimet e mëposhtme nuk e zbatonte Hz. Pejgamberi gjatë veprimtarive të tij të arsimit dhe edukimit?

A) Tërheqja e vëmendjes ndaj dallimeve personale
B) Mospërsëritja kur nuk është e nevojshme
C) Të fillojë të japë mësim nga çështjet më të vështira
D) T'u kushtojë rëndësi pyetjeve

3) Bëni një lidhje logjike ndërmjet alternativave A-D dhe haditheve që gjenden përkrah tyre:

A) Dija është e vyer për të gjithë, qofshin ato meshkuj apo femra	1. "Nxënia e dijes është farz për çdo musliman, mashkull apo femër qoftë."
B) Të bësh pyetje nuk është diçka e mirë	2. "Dija është thesar dhe çelësi i atij thesari është të bësh pyetje. Mëshira e Allahut qoftë mbi ju; bëni pyetje. Sepse kur është fjala për pyetjet, ka shpërblim për katër persona: ndaj atij që pyet, që mëson të tjerët, që dëgjon dhe që i do e i pëlqen këta."
C) Duhet të bëjmë dua që dija të na falë dobi	3. "Askush nuk mund të japë një sadaka më të madhe se sa të për-hapë dije."
D) Dija e udhëzon njeriun te pasuria e vërtetë	4. "Allahu im, mbështetem te ti nga dija e padobishme."
	5. "Allahu im, më pasuro me dijen tënde; më zbukuro me mendje dhe me butësi; më lartëso me shmangien nga e keqja; më zbu-kuro me moskryerjen e punëve të këqija."

Çelësi i përgjigjeve

KAPITULLI 1

1. A, 2. B, 3. C, 4. D, 5. C, 6. D

KAPITULLI 2

1. A, 2. C, 3. B, 4. A, 5. D, 6. C, 7. D, 8. D, 9. A, 10. C

KAPITULLI 3

1. C, 2. A, 3. D, 4. D, 5. C, 6. D, 7. D

KAPITULLI 4

1. B, 2. D, 3. C, 4. C, 5. D, 6. D

KAPITULLI 5

1. C, 2. A, 3. D, 4. B

KAPITULLI 6

1. D, 2. C, 3. B

Literatura

Algül, Hüseyin, *Alemlere Rahmet Hz. Muhammed (Hz. Muhammedi, mëshira e botëve)*, Ankara 1994.

Algül, Hüseyin, *İslam Tarihi (Historia islame)*, I, Stamboll 1986.

Azam, Abdurrahman, *Rasul-i Ekrem'in Örnek Ahlakı (Morali shembullor i Rasulullahut)*, Përktheu Hayreddin Karaman, Stamboll 1971.

Belazuri, *Ensabu'l-Eshraf,* Kajro 1959.

Bilgin, Beyza, *İslam ve Çocuk (Islami dhe fëmija)*, TDV Yayınları, Ankara 1997.

Bozkurt, Nahide, *Siyer (Hz. Muhammed'in Hayatı) (Sijer (Jeta e Hz. Muhammedit)*, İmam Hatip Liseleri Ders Kitabı, MEB Devlet Kitapları, Ankara 2003.

Buhari, *Sahih,* Çağrı Yayınları, Stamboll 1992.

Çağatay, Neşet, *İslam Öncesi Arap Tarihi ve Cahiliye Çağı (Historia arabe paraislame dhe periudha e injorancës)*, Ankara 1982.

Derveze, İzzet, *Kur'an'a Göre Hz. Muhammed'in Hayatı (Jeta e Hz. Muhammedit sipas Kur'anit)*, I-III, Përktheu Mehmet Yolcu, Stamboll 1998.

Dikici, Recep, *İki Cihan Güneşi Hz. Muhammed Aleyhisselam (Hz. Muhammed Alejhisselam, dielli i dy botëve),* Stamboll 1984.

Diyanet İlmi Dergi – *(Peygamberimiz Hz. Muhammed (sav) (Pejgamberi ynë Hz. Muhammedi)*, Özel Sayı, Ankara 2000.

Doğuştan Günümüze Büyük İslam Tarihi (Historia e madhe islame nga lindja deri në ditët tona), Redaktor Hakkı Dursun Yıldız, Stamboll 1986.

Ebu Gudde, Abdulfettah, *Bir Eğitimci Olarak Hz. Muhammed ve Öğretim Metotları (Hz. Muhammedi si një arsimtar dhe metodat e mësimdhënies),* Përktheu Enbiya Yıldırım, Stamboll 1998.

Gelişim ve Öğrenme Psikolojisi (Psikologjia e Zhvillimit dhe e Mësimit), Edit. Binnur Yeşilyaprak, Pegema Yayınevi, Ankara 2003.

Güçlü, Nezahat, "Zaman Yönetimi (Menaxhimi i kohës)", *Eğitim Yönetimi Dergisi,* Yıl: 7, Sayı: 25, Kış 2001.

Günaltay, Şemsettin, *İslam Öncesi Araplar ve Dinleri (Arabët para Islamit dhe fetë e tyre),* Thjeshtësues: M. Mahfuz Söylemez-Mustafa Hizmetli, Ankara 1997.

Halil, İmadüddin, *Muhammed Aleyhisselam,* Konja 2003.

Hamidullah, Muhammed, *İslam Pejgamberi, (Pejgamberi islam) I-II,* Stamboll 1980.

Hasan, H. İbrahim, *Siyasî-Dinî-Kültürel-Sosyal İslam Tarihi (Historia islame politike-fetare-kulturore-sociale),* I, Përktheu İsmail Yiğit dhe shokët e tij, Stamboll 1985.

Heykel, Muhammed Hüseyin, *Hz. Muhammed'in Hayatı (Jeta e Hz. Muhammedit), I-II,* Përktheu Vahdettin İnce, Stamboll 2000.

Hizmetli, Sabri, *İslam Tarihi (Historia islame),* Ankara 1999.

Hz. Peygamberin Hayatından Davranış Modelleri (Modelet e sjelljes nga jeta e Hz. Pejgamberit), Përgatiti për botim Recep Kılıç, Ankara 1998.

İbn Abdirabbih, *el-Ikdu'l-Ferid,* v. IV, Bejrut, 1985.

Ibn Hanbel, *Musned, I-IV,* Çağrı Yayınları, Stamboll 1982.

Ibn Hisham, *es-Siretu'n-Nebevijje,* Kajro 1999, v. II.

Ibn Maxhe, *Sunen,* Çağrı Yayınları, Stamboll 1992.

Ibn Sa'd, *et-Tabakatu'l-Kubra,* v. I, Bejrut 1985.

Ibn-i Hisham, *Hz. Muhammed'in Hayatı (es-Siretu'n-nebeuijje),* Përktheu İzzet Hasan – Neşet Çağatay, Ankara 1971.

Ibnu'l-Arabi el-Maliki, *Sahihu't-Tirmidhi Sherhi,* Kajro 1931.

Ibnu'l-Esir, *el-Kamil fi't-Tarih,* Bejrut 1989, v. II.

Kur'an-ı Kerim ve Açıklamalı Meali (Kur'ani Famëlartë dhe meali shpjegues), Türkiye Diyanet Vakfı (Komision), Ankara 2000.

Muslim, *Sahih,* Çağrı Yayınları, Stamboll 1992.

Özaydı, Abdülkerim, "Arap", *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi,* III, 321-324.

Özaydın, Beyza – Mualla Selçuk, *Din Öğretimi (Mësimnxënia fetare),* Gün Yayıncılık, Ankara 1999.

Özbek, Abdullah, *Bir Eğitimci Olarak Hz. Muhammed (Hz. Muhammedi si një arsimtar),* Konja 1995.

Sarıçam, İbrahim, *Hz. Muhammed ve Evrensel Mesajı (Hz. Muhammedi dhe mesazhi i tij universal),* DİB Yayınları, Ankara 2001.

Sarıçam, İbrahim, *İlk Dönem İslam Tarihi (Historia islame e periudhës së parë),* Açık Öğretim Yayını 574, Eskişehir 1999.

Seçme Hadisler (Hadithe të përzgjedhura), DİB Yayınları, Ankara 2000.

Şarkavi, Abdurrahman, *Özgürlük Peygamberi Hz. Muhammed (Hz. Muhammedi, Pejgamberi i lirisë),* Përktheu Muharrem Tan, Stamboll 1993.

Taberi, *Tarihu'l-Umem ue'l-Muluk,* I-IV, Stamboll 1992.

Watt, W. Montgomery, *Hz. Muhammed Mekke'de (Hz. Muhammedi në Mekë),* Përktheu M. Rami Ayas-Azmi Yüksel, Ankara 1986.

Ja'kubi, *Tarihu'l Ja'kubi,* v. II, Bejrut, pa datë.

Yiğit, İsmail – Raşit Küçük, *İmam Hatip Liseleri için Siyer (Sijer për medresetë), 1-2,* Stamboll 1997.